MËSIME AKAIDI



teuhid
BASIM YAYIN



MËSIME AKAIDI

Halis BAYANCUK

teuhid
BASIM YAYIN

www.**tevhidmeali**.com
www.**tevhidkitap**.net
www.**tevhiddersleri**.org
www.**tevhiddergisi**.org
tevhiddergisi@gmail.com

MËSIME AKAIDI

Halis BAYANCUK

Përgatitja Teknike: **Përbërës**
Tevhid Basım Yayın, 42546
Korrigjime
Tevhid Basım Yayın, 42546

Botim: **Vendi i Botimit**
Step Matbaacılık
Göztepe Mh. Bosna Cd. No:11
Bağcılar/İSTANBUL
Sertifika No: 12266

ISBN: 978-605-68965-5-2

1. Botim, 2013

Komunikim: **Email**
tevhiddergisi@gmail.com

Telefonit
+90 545 762 15 15

Postë
P.K. 51 Güneşli Merkez PTT
Bağcılar/İstanbul

Qendër
Kirazlı Mah. Mahmutbey Cad.
No:120/A
Bağcılar/İstanbul

Shpërndarja e përgjithshme

İstanbul : Kirazlı Mah. Mahmutbey Cad. No: 120/A 34212 Bağcılar/İSTANBUL 0 545 762 15 15
Ankara : Piyade Mah. İstasyon Cad. No: 190 Etimesgut/ANKARA 0 543 225 50 48
Diyarbakır : Kaynartepe Mah. Gürsel Cad. No: 90/A 21090 Bağlar/DİYARBAKIR 0 543 225 50 43
Konya : Mengene Mah. Büyük Kumköprü Cad. No:78/A 42020 Karatay/KONYA 0 543 225 50 49
Van : Vali Mithatbey Mah. Gündüz 2. Sok. No:2 A İpekyolu/VAN 0 543 225 50 45

PËRBËRËSIT

Parathënia e Botimit të Pestë 5

Itıkadı 13

Teuhıdı 16

Teuhıdı Uluhıje 19

Ibadetı 21

La Ilahe Il-Lall-Llah Është Sımbolı I Teuhıdıt Uluhıje 24

Kushtet E Fjalës La Ilahe Il-Lall-Llah 27

Kuptımı I Tagutıt Në Kur'anı 29

Mohımı I Tagutıt Dhe Largımı Prej Tıj 33

Të Vazhdojmë Me Kushtet E Fjalës La İlahe İl-Lall-Llah: 36

Teuhıdı Rububıje 40

Teuhıdı El-Esma Ues-Sıfaat 44

Hadıthı Ahad Dhe Hadıthı Muteuatır Në Akıde 54

Imanı 56

Kufrı Dhe Shırku 61

A Është Injoranca Arsyetım? 63

Të Qenurıt Dhe Të Mosqenurıt E Injorancës Arsyetım 65

Përhapja E Kufrıt Dhe Shırkut Tek Ky Ummet 71

Lıgjvënıa. 73
Gjendje Që Janë Kundër Teuhıdıt Të Lıgjvënıes. 75
Të Zgjedhurıt. 76
Ata Që Drejtohen 83
Mıqësıa Dhe Armıqësıa (Uela Dhe Berra). 94
Dyshime në lidhje me meselenë e ushtrisë 103
Dısa Mesele Në Lıdhje Me Teuhıdın. 119
Fikhu İ Duasë Në Kur'an. 144
Besımı Në Melaıke (Engjëjt). 147
Besımı Në Lıbra 151
Besımı Në Pejgamberë. 155
Besımı Në Dıtën E Ahıretıt (Botës Tjetër). 160
Shenjat e Kijametit 164
Kijameti, fryerja e Surit, Ringjallja dhe Tubimi 168
Dhënia e Librit 172
Xhenneti dhe Xhehennemi. 176
Besımı Në Kader. 180

Parathënia e Botimit të Pestë

Me emrin e Allahut...

Falënderimi i takon Allahut. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dërguarin e Tij.

Es-Selamu Alejkum ue Rrahmetull-llahi ue Berakatuhu.

Libri me emër *"Mësime Akaidi"* është vetëm njëra nga mirësitë që më dhuroi Allahu Teala gjatë sprovës së burgut. Ndërmjet viteve 2008-2009 qëndruam në burgun Kandëra, nr: 2, tip: F. Mësimet ditore të cilat i bënim së bashku me shokët tanë me të cilët ishim në të njëjtën dhomë, filluam t'i shkruanim në mënyrë të përmbledhur. Ne, kur po i shkruanim këto mësime, planifikuam vetëm gjendjen e një përmbledhjeje mësimesh në dorën e atyre që merrnin pjesë në mësim. Dëshira e Allahut u shfaq në drejtim tjetër. Ai dëshiroi që këto përmbledhje të bëheshin libër dhe të përfitonin shumë njerëz...

Falënderimi i takon Allahut në fillim dhe në fund.

Këto përmbledhje u bënë libër pasi dola nga burgu. Dhe deri në vitin 2013 u bënë katër botime. Në botimin e katërt, bëra nijet që të bëja disa rregullime në libër. Në këtë periudhë gjendesha në burgun e Edirnes dhe për shkak të disa pengesave dhe angazhimeve nuk e gjeta mundësinë.

Më thanë se në fillim të vitit 2016 libri do të botohej përsëri. Gjatë kësaj kohe (pra gjatë viteve 2008-2016) nuk e kisha lexuar asnjëherë librin nga fillimi deri në fund. Duke u nisur nga koha që kisha në dispozicion dhe nga këshillat e disa vëllezërve në lidhje me librin, e lexova librin përsëri duke i bërë disa rregullime me qëllim që ta përgatisja për botimin e pestë.

Nuk e preka metodën origjinale të librit. Besoj se kjo metodë e cila është prodhim burgu, e ka bërë librin të bereqetshëm dhe e ka shtuar përfitimin prej tij.

Rregullimet që kam bërë mund t'i përmbledh kështu:

- Shtova disa fjali në shumë vende të librit me qëllim që

tema ose paragrafi të kuptohen më mirë ose për të përforcuar lidhjen e paragrafit me paragrafin tjetër.

- Shtova paragrafe të gjata në shumë pjesë të librit. Këto paragrafe të cilat janë sqarim për ndonjë pikë ose ndonjë term brenda temës, i vendosa për arsye që të kuptohet tërësia e temës. Si shembull në lidhje me këtë mund të tregohet mësimi 1, 10, 34, 36, 41 dhe 53.

- Bëra shtesa në argumentat e disa çështjeve. Pranë argumentave ekzistues përmenda ajetet muhkeme në lidhje me çështjen.

- Një mësim e hoqa komplet nga libri dhe e shkruajta përsëri. Shembulli i vetëm i kësaj në libër, është mësimi 27: "*Të Qenurit Dhe Të Mos Qenurit e Injorancës Arsyetim*". Këtë pjesë e shkruajta përsëri për shkak që të kuptohet më mirë dhe për të mbyllur derën e keqkuptimit për arsye se në katër botimet e para kjo pjesë mund të keqkuptohej dhe kishte nevojë për sqarim.

- Një pjesë të një mësimi e hoqa dhe nuk e pashë të arsyeshme ta zëvendësoja. Shembulli i kësaj është mësimi 70: *"Xhenneti dhe Xhehennemi, Dita e Ahiretit". Në këtë mësim hoqa pjesën në të cilën thënia "Xhehennemi nuk është ebedi (i përjetshëm)"* i atribuohet Ibn Tejmijjes dhe Ibn Kajjimit. Shkaku i kësaj është ky:

Në hulumtimet që kam bërë pas vitit 2008, tek unë u formua mendimi se kjo temë ka nevojë për shqyrtim. Këta dy dijetarë siç kanë thënë fjalë që mund të komentohen në këtë mënyrë (pra që xhehennemi nuk është i përjetshëm, shënim i përkthyesit), po ashtu kanë thënë edhe fjalë të kundërta me këtë mendim...

Në çështjen se xhenneti dhe banorët e tij janë të përjetshëm, edhe këta dy dijetarë janë në një mendim me Ehli Sunnetin. Dhe i kundërpërgjigjen Xhehm ibn Safvanit dhe Ebu Huzejl

el-Al-labit prej Mu'tezilive të cilët kanë thënë se xhenneti nuk është i përjetshëm. [1]

Ndërsa përsa i përket xhehennemit, Ibn Tejmijje dhe Ibn Kajjimi kanë theksuar se në lidhje me përjetshmërinë e xhehennemit tek selefët ekzistojnë dy mendime dhe këta dy dijetarë kanë mbrojtur tezën se në këtë çështje ka ihtilaf (kontradiktë mes dijetarëve).

Ibn Kajjimi transmeton prej hoxhës së tij kështu: *"Shejhul Islam (Ibn Tejmijje) thotë: Në këtë çështje ka dy mendime që dihen ndërmjet selefëve (dijetarëve të hershëm) dhe halefëve (dijetarëve të mëvonshëm). Edhe ihtilafi i tabiinëve në këtë çështje është i njohur."* [2]

Dijetarët të cilët kanë jetuar përpara Ibn Tejmijjes dhe Ibn Kajjimit, në lidhje me këtë mendim që transmetohet nga selefët ndahen në këtë mënyrë.

- Dijetarë të cilët nuk e kanë përmendur fare këtë mendim.

- Dijetarë të cilët mbështesin tezën se të gjitha transmetimet që kanë ardhur në lidhje me këtë çështje janë të dobëta.

- Dijetarët të cilët i bëjnë te'uil (interpretim) këtyre transmetimeve.

- Dijetarë të cilët nuk janë në dijeni rreth një ekzistence ihtilafi të këtillë.

Ibn Tejmijje dhe nxënësi i tij, Ibn Kajjimi, transmetimet e këtilla i kanë pranuar si të sakta dhe kanë mbrojtur tezën se në këtë çështje ka ihtilaf ndërmjet selefëve.

Po këta dijetarë, cilin mendim kanë zgjedhur?

Për shkak se këta dijetarë e kanë trajtuar çështjen shumë gjerë në librat e tyre, shumë njerëz kanë menduar se ata mbështesin mendimin se xhehennemi nuk është i përjetshëm. Ky mendim i tillë është shumë i përhapur në mexhliset e dijes dhe u është atribuar këtyre dijetarëve pa bërë asnjë shqyrtim të thellë.

1. *Shih; Mexhmuul Fetava 8/154; Hadi'l Ervah, f: 728*
2. *Hadi'l Ervah, f:730*

Sipas mendimit tonë, për t'ia atribuar këtë mendim këtyre dy dijetarëve, nuk kemi në dorë argumente të prera. Përshembull, Ibn Kajjimi i cili e trajton më gjerë këtë çështje, ai në librin e tij me emër Hadi'l Ervah e ka shqyrtuar afërsisht 70 faqe (nga faqja 723 deri tek faqja 791), ka përcjellë tefsiret e sahabëve dhe tabiinëve të cilat mbështesin këtë mendim dhe ka përmendur 25 ndryshime të cilat theksojnë se xhenneti dhe xhehennemi nuk janë të njëjtë dhe se të qenurit e xhennetit i përjetshëm nuk e bën të domosdoshme të qenurit e xhehennemit të tillë (pra të përjetshëm). Një person i cili e lexon këtë pjesë, me patjetër që do të mendojë se Ibn Kajjimi ka zgjedhur këtë mendim. Mirëpo në fund thotë: *"Nëse thuhet se po ju në ç'konkluzion mbërritët; i themi se mbërritëm në mendimin se "S'ka dyshim se Zoti yt bën çka të dëshirojë."* [3] *Kjo është zgjedhja e Aliut. Ai pasi përmend hyrjen e banorëve të xhennetit në xhennet dhe hyrjen e banorëve të xhehennemit në xhehennem dhe gjërat me të cilat ata do të përballen atje, thotë –Më pas Allahu bën ç'ka të dëshirojë-"* [4]

Nëse shihet me kujdes, ai nuk ka zgjedhur ndonjë mendim, por e ka lënë në dëshirën e Allahut Teala.

Sakaq nxënësi i tij Ibn Rexheb el-Hanbeliu në fundin e jetës i lexoi hoxhës së tij Ibn Kajjimit librin el-Kafije esh-Shefijje, dhe Ibn Kajjimi e dëgjoi. Ibn Rexhebi i lexoi atij pjesët në të cilat thuhet se xhenneti dhe xhehennemi janë të përjetshëm, se vdekja do të sillet në formën e dashit dhe do të theret, ndërsa hoxha i tij nuk i bëri ndonjë kundërshtim apo rregullim.

Për këtë shkak si dhe për shkaqe të ngjashme me këtë, jam i mendimit se nuk është e saktë që t'ia atribuojmë në mënyrë të prerë këtë mendim dy dijetarëve të lartpërmendur.

Në këtë pjesë të cilën e hoqëm nga libri, patëm sqaruar se mendimi i këtyre dy dijetarëve është në kundërshti me mendimin e shumicës së dijetarëve, se nuk ia kanë qëlluar dhe

3. *11/ Hud, 107*
4. *Hadi'l Ervah, f:791*

se argumentat që ata kanë nxjerrë, duhet të shqyrtohen nën dritën e teksteve të qarta dhe të prera.

Një shkak tjetër për të cilin e hoqëm këtë pjesë është ky: Ky libër nuk është shkruar për të treguar kontradiktat (e dijetarëve), por për të treguar çështjet të cilat janë bazë dhe për të mësuar themelet e itikadit (besimit). Duke qenë se një pjesë e lexuesve janë muvahhidë (njësues) të ri, kjo pjesë është vlerësuar më tepër e dëmshme sesa e dobishme.

Ndërsa kur vijmë tek shkaku më i rëndësishëm: Mospërdorimi i mendimeve të dijetarëve, mospërzjerja e kontradiktave të kaluara në davetin tonë dhe drejtimi nga tekstet e qarta kur i bëjmë thirrje njerëzve në teuhid dhe sunnet, është vendimi i përbashkët i Xhematit të Teuhidit dhe Sunnetit.

Kontradiktat e kaluara dhe fetvatë e dijetarëve janë pengesë për zgjerimin e davetit, bëhen shkak për grupacione dhe si iman dhe si vepër të mirë, nuk i shtojnë asgjë thirrësave dhe personave ndaj të cilëve bëhet thirrja...

Burimi i vetëm për të cilin jemi përgjegjës në dynja dhe burimi i vetëm për të cilin do të merremi në llogari në ahiret, është Kur'ani dhe Sunneti. Ndërsa për fetvatë dhe ixhtihadet e dijetarëve, nuk do të merremi në pyetje as në varr e as në ahiret. Kështu që duhet t'i kushtojmë rëndësi asaj e cila është kryesore, duhet të mendojmë dhe të meditojmë mbi atë, duhet të përpiqemi me të gjithë mundin tonë për ta shtuar imanin dhe për të bërë vepra të mira dhe për të kërkuar rrugë të cilat janë shkak për këtë.

E lus Zotin tim që ta bëjë këtë libër një shkak për përhapjen dhe zënien e rrënjës së davës së teuhidit dhe sunnetit.

Ebu Hanzala/Halis Bayanxhuk

Burgu Silivri, nr: 4

3 Rebiu'l Ahir 1437

13 Janar 2016

بسم الله الرحمن الرحيم

Parathënie

Hamdi (falënderimi) i takon Allahut, Zotit të botërave. Salati dhe Selami qofshin mbi të dërguarin e Allahut, njeriun fjalë drejtë dhe të besueshëm, pejgamberin tonë Muhammed (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij.

Për shkak se shkenca e itikadit përmban temat kryesore të fesë siç është imani dhe kufri, çdo person që thotë "unë jam besimtar" është i detyruar të dijë/të mësojë shkencën e itikadit. Sot në gjeografinë ku ne jetojmë, bëhet fjalë për degjenerimin -si në çdo gjë- po ashtu edhe në meselet që kanë të bëjnë me itikadin, largimin nga e vërteta, tregimin e hakut si batil (të kotë) dhe batilin si hak (të vërtetë). Ndërsa pengimi i mosrënies së njerëzve në këto gabime, s'ka dyshim që është nga detyrat më të rëndësishme për ne të cilët jemi përgjegjës për përhapjen e hakut.

Sot gjenden shumë libra në lidhje me temat e akides (Allahu ia pranoftë veprën vepërmirësve). Megjithatë, gjenden shumë shkaqe që ne po e botojmë këtë libër që keni në duar. Një pjesë prej këtyre shkaqeve mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë:

- Sepse një pjesë e librave që gjenden në treg, nuk janë përmbledhës (në vend që të përfshijnë shumë tema, qëndrojnë vetëm mbi disa tema të caktuara),
- Sepse një pjesë e tyre, përmbajnë njohuri devijuese kundër teuhidit,
- Sepse temat e disave prej tyre shpjegohen në imtësi, nuk janë aq të qarta sa të kuptohen nga të gjithë,
- Për shkak se një pjesë e dijetarëve të teuhidit që kanë shk-

ruar në lidhje me këtë temë, nuk jetojnë në gjeografinë tonë dhe ngaqë nuk i dinë disa probleme të itikadit në lidhje me kushtet tona, japin fetva të gabuara,

▪ Në vitet e fundit, sidomos në gjeografinë tonë, gjendja që duket me përhapjen e xhemateve të teuhidit ndërmjet njerëzve është kështu: *"Problemi i vetëm i neve muvahhidëve (njësuesëve) që jetojmë me bashkësinë xhahile, është meseleja e demokracisë/ligjvënies"*. Ndërkohë që ne –pranë rëndësisë që i japim kësaj meseleje- edhe shumë meseleve të tjera nga bashkësia xhahile, nga zakonet, adetet e tyre pikëpamja jonë është sipas kornizës së itikadit Islam, edhe ky është një tjetër shkak.

Ja pra, nga këto dhe për shkak të shkaqeve të ngjashme me këto, lindi nevoja që të shkruhej libri që keni në duar.

Një çështje shumë e rëndësishme, që lexuesit nga vëllezërit tanë duhet ta kenë parasysh në lidhje me librin është kjo: Ky libër është shkruar në burg, në një mjedis në të cilin autori nuk ka pasur mundësitë e kërkimit nëpër librat e burimeve. Kështu që burimet nuk janë realizuar në një mënyrë shkencore. Për këtë shkak, librin që keni në duar, duhet ta vlerësoni jo si një vepër shkencore, por si një libër që ia mundëson të gjithëve që t'i kuptojnë meselet e përgjithshme të itikadit.

Libri është bërë nga ligjëratat e përditshme që ka mbajtur hoxha ynë. Në këtë mënyrë, në libër ka reflektuar qartësia dhe thjeshtësia e të folurit të gjuhës.

Veçanërisht edhe mësimet që shqyrtohen në libër, janë vendosur në mënyrë të ndara (si Mësimi 1. Mësimi 2. e me rradhë). Me këtë mënyrë, atyre të cilëve duan ta përdorin këtë libër për të bërë mësim, i ka mundësuar një lehtësim.

Duaja jonë është që Allahu na i përforcoftë këmbët tona në rrugën e hakut dhe na i pranoftë veprat tona si vepra të mira.

Itıkadı

Kuptimi gjuhësor i itikadit: Vjen nga rrënja A-ka-de. Kuptimi i saj është: Të lidhësh anët e një gjëje me njëra-tjetrën. Përdoret për sendet e ngurta siç është lidhja e litarit... Veçanërisht përdoret edhe për fjalë të cilat shprehin kuptim siç është akti i shit-blerjes, akti i martesës...

Kuptimi sheriatik: Itikadi është shkenca që shqyrton parimet e domosdoshme të fesë që personi është i deyruar t'i besojë, t'i pranojë dhe t'i refuzojë.

Emërtimi i besimit Islam si akide/itikad: Kjo është për shkak të lidhjes që bëhet ndërmjet Allahut dhe robit nëpërmjet një marrëveshje. Veçanërisht është e tillë për shkak se ato që duhen besuar dhe refuzuar, janë të prera dhe të sigurta si një lidhje e vetme.

Shënim: Shumë njerëz kur bëjnë përkufizimin e itikadit, e shpjegojnë sikur itikadi të ishte pranimi i disa bazave (si besimi në Allah, kader, libra etj.). Ndërsa itikadi Islam ndahet në dy pjesë, të cilat janë refuzimet dhe pranimet. Nëse njëra nga këto të dyja nuk do të ishte, itikadi i personit nuk është sahih (i saktë). Madje, baza e fesë fillon me Kelimetut-Teuhid, me refuzim.

Kur njeriu pranon itikadin e saktë, duhet që t'i refuzojë njerëzit dhe bashkësitë që nuk e pranojnë atë itikad. Argumenti i kësaj është fjala e Allahut: *"Ju e keni shembullin më të mirë te Ibrahimi dhe te ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne jemi larg jush dhe asaj që adhuroni, pos Allahut. Nuk ju njohim juve! Ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm Allahun, Një!"*[1]

Metoda Që Duhet Ndjekur Në Itıkad

Duke qenë se përfundimi i gabimit në meselet e itikadit është kufri, pra qëndrimi përgjithmonë në xhehennem, duhet të

1. *60/Mümtehine, 4*

kemi kujdesin në gradën më të lartë. Ndërsa metoda që duhet ndjekur për të mos rënë në gabim është:

▪ Duhet të mbështetet tek Libri (Kur'ani) i cili është udhërrëfyes për në hak dhe udhëzim.

▪ Duhet të mbështetet tek Sunneti i cili është sqarues i Kur'anit.

▪ Duhet të mbështetet mbi të kuptuarit e Selef-us-Salih (Tre gjeneratat për të cilat ka folur Profeti (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në hadith) duke qenë në krye sahabët, të cilët kanë merituar lavdërimin e Kur'anit dhe Sunnetit.

Të qenurit e itikadit Islam i saktë dhe të ndërtuarit e tij mbi themele të forta, janë të lidhura me dy mesele.

▪ Të zgjedhurit saktë të burimeve: Kur'ani dhe Sunneti të cilët janë burimet e dijes.

▪ Të poseduarit e përmasave të sakta në çështjen e mënyrës së të kuptuarit të këtyre burimeve.

"All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh."[2]

Allahu Teala rrugën e mbërritjes në kënaqësinë e Tij e ka përcaktuar si të qenurit muhaxhir, ensar ose si pasimi i tyre në punë të mira.

Ne dhe pse nuk e kemi nderin e të qenurit prej muhaxhirëve dhe ensarëve për të cilët flitet në ajet, gjithsesi ekziston nderi i pasimit të tyre në punë të mira deri në kijamet. Në çështjen e besimit dhe veprimit, përmasë duhet të jenë të kuptuarit dhe të jetuarit e tyre; burimet me atë përmasë duhet të kuptohen. Për shkak se veprimtaria e të kuptuarit është e lidhur me njeriun, ekzistojnë mënyra të kuptuari të ndryshme sa çësh-

2. *9/Teube, 100*

të numri i njerëzve. Çdo njeri i cili lexon një tekst të njëjtë, mund të kuptojë gjëra të ndryshme sipas nivelit dhe kulturës së tij dhe në përputhshmëri me natyrën dhe karakterin e tij. Është kusht përcaktimi i një përmase për parashtrimin e duhur të këtyre të kuptuarve. Islami këtë përmasë e ka përcaktuar me fjalën *"sahabët"*.

Të gjitha grupet në ditët e sotme, pretendojnë se si referencë marrin të njëjtat burime, ndërsa shkaku i daljes së një morie kontradiktash, është ngaqë posedojnë përmasa të ndryshme në të konceptuarit e po të njëjtave burimeve.

Grupi i cili merr si burim Kur'anin dhe Sunnetin, ndërsa si përmasë në të kuptuar merr përmasën e të kuptuarit të selefëve/sahabëve, emërtohet *"Ehli Sunnet ue'l Xhemat"*.

Përse Ehlı Sunnetıt I Është Thënë "Ehlı Sunnet"?

I dërguari i Allahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë në hadith që *"Ummeti im do të ndahet në 73 grupe. Të gjithë janë në zjarr, përveç një grupi"*. Sahabët e pyesin se *"Kush janë ata të shpëtuarit o dërguari i Allahut?"*. Ai i thotë *"Ata që janë në rrugën time dhe të shokëve të mi". Në një transmetim tjetër kalon "Ata që janë xhemat"*.

Ehl-i Sunneti duke u mbështetur në këto hadithe dhe hadithe të ngjashme me këto, e ka emërtuar veten me këtë emër. Po ashtu i kanë thënë vetes edhe *"Firkatun-Naxhije"* që vjen në kuptimin, grupi i shpëtuar. Thënia *"Ata që janë në rrugën time dhe të shokëve të mi"* e cila kalon në transmetimin e parë, është e barazvlefshme me sunnetin. Sunneti është rruga që pasohet. Ndërsa fjala xhemat që kalon në transmetimin e dytë, është për të shprehur tërësinë dhe të qenurit sëbashku.

Ardhja e këtyre dy fjalëve në një vend, përbën emrin *"Ehli Sunnet ue'l xhemat"*.

Gjithashtu këtij grupi i ka mbetur si llagap emri Firkatun-Naxhije / Grupi i Shpëtuar, për shkak se në hadith theksohet si grupi i cili shpëton prej zjarrit ndërmjet 73 grupeve.

Teuhıdı

Teuhidi është e kundërta e shirkut.

Kuptimi gjuhësor: Fjala Teuhid do të thotë *"njësim", "unifikim".*

Kuptimi sheriatik: Personi duhet ta njësojë Allahun në të gjitha çështjet dhe të mos i bëjë Atij shok.

Teuhidi është çështja më e ndjeshme e itikadit Islam. Kur nuk gjendet ai dhe moslargimi nga e kundërta e tij, veprat që bëhen nuk kanë dobi tek Allahu.

Allahu Teala ia ka urdhëruar teuhidin të dërguarit të Tij si krye të çdo pune.

"Përqëndro vetveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (përqëndrohuni në atë fé) Të kthyer sinqerisht tek Ai, kini frikë prej Atij dhe faleni namazin e mos u bëni nga idhujtarët."[1]

"Thuaj: "Namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!"[2]

Edhe i dërguari i Allahut kur dërgonte ndonjë mësues në ndonjë popull, e urdhëronte atë që më parë t'i mësonte atyre teuhidin, nëse ata do ta pranonin teuhidin, më pas do t'u mësonte atyre veprat e mira.

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) kur e dërgoi Muadhin në Jemen i tha atij kështu:

"S'ka dyshim se ti po shkon tek një popull i cili është ehli kitab. Thirri ata që të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i dërguari i Allahut. Nëse

1. *30/Rrum, 30-31*
2. *6/Enam, 162-163*

ata e pranojnë këtë, atëherë njoftoji ata se Allahu ua ka bërë farz atyre pesë kohët e namazit në një ditë dhe një natë. Nëse e pranojnë këtë, atëherë njoftoji ata se Allahu ua ka bërë farz zekatin që të merret nga pasuritë e tyre dhe t'i shpërndahet të varfërve."[3]

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) nuk i tha Muadhit që; në fillim shpjegoi atyre namazin dhe zekatin. Përkundrazi i tha atij që në fillim t'i shpjegonte teuhidin dhe nëse ata do ta pranonin këtë, më pas t'i shpjegonte namazin dhe zekatin, sepse pa u realizuar teuhidi; falja e namazit dhe dhënia e zekatit nuk i bëjnë dobi personit. Në lidhje me këtë, ky dialog që është bërë ndërmjet Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) dhe Muadhit, tregon se pa u realizuar teuhidi, veprat që bëhen nuk kanë asnjë vlerë.

Teuhidi është thelbi dhe koka e punës, ndërsa e domosdoshmja për vazhdimin e tij, është distancimi nga shirku dhe nga vepruesit e tij, mospërzjerja e imanit me zullum/shirk në asnjë mënyrë.

Në Kur'an thuhet: *"(O Muhammed) Nëse i bën shok Allahut, veprat e tua janë të asgjësuara dhe ti do të jesh prej të humburve."*[4]

Pra, edhe pejgamber të jetë personi -që veprat e pejgamberëve dihen- veprat asgjësohen në gjendje shirku. Përsëri në një ajet tjetër thuhet:

"Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e përzien me zullum, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë."[5]

Kur zbriti ky ajet, sahabëve u erdhi rëndë dhe thanë: *"Cili prej nesh nuk e përzien imanin e tij me zullum?"*. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) u tha: *"Kjo nuk është ashtu siç mendoni ju, por është ashtu siç i tha Lukmani djalit të vet" dhe lexoi ajetin "O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse shirku është zullumi më i madh."*[6] [7]

3. *Muslimi*
4. *39/Zumer, 65*
5. *6/En'am, 82*
6. *31/Lukman, 13*
7. *Buhari, Muslimi*

Në një ajet tjetër thuhet:

"Shembulli i veprave të atyre që nuk besuan është si hiri, të cilin me puhi e shkapërderdh era në ndonjë ditë të stuhishme, e ata nuk mund të realizojnë asgjë nga veprat që kanë bërë, e ky është ai dështimi i madh."[8]

Në këtë ajet shohim se veprat që bën qafiri në gjendje kufri, nuk bëjnë dobi.

Kur i shqyrtojmë ajetet në lidhje me Teuhidin dhe shirkun, shohim se çështja nuk është një çështje e lehtë, se lumturia e dynjasë dhe ahiretit ose palumturia është e lidhur me këtë çështje. Prandaj çdo pejgamber, për këtë çështje ka folur më shumë. Dhe çdo musliman, duhet ta kuptojë dhe ta dijë shumë mirë Teuhidin dhe shirkun me tre kategoritë e tyre.

Teuhidi i cili është thelbi dhe baza e Islamit në përgjithësi ndahet në tre pjesë:

1. Teuhidi Uluhije

2. Teuhidi Rububije

3. Teuhidi el-Esmaa ue Sifaat (Emrat dhe Cilësitë)

Edhe shirku i cili është zullumi më i madh dhe komplet i kundërt me realitetin e Islamit, po në të njëjtën mënyrë ndahet, në tre pjesë:

1. Bërja shok Allahut në Uluhije

2. Bërja shok Allahut në Rububije

3. Bërja shok Allahut në Emrat dhe Cilësitë e Tij.

8. 14/Ibrahim, 18

Teuhıdı Uluhıje

Është njësimi i Allahut në ibadete. Uluhije domethënë; teuhidi që ka të bëjë me cilësinë e adhurimit të Allahut. Po ta kuptonim kuptimin e fjalës ilah, gjithashtu do të kuptonim edhe teuhidin uluhije.

Kuptimi gjuhësor i fjalës ilah:

- I adhuruari i cili adhurohet
- *Zemrat për të cilin përmallohen*
- *Mendjet për të cilin admirohen*
- *Ai i cili adhurohet me dashuri*
- *Ai ndaj të cilit mbështeten në vështirësi*
- *Ai i cili është i lartë*

Për të kuptuar kuptimin e saj sheriatik, duhet të shqyrtojmë vendet e fjalës ilah se si është përdorur në Kur'an. Kur shohim Kur'anin, fjala ilah në përgjithësi përdoret në kuptimin: pronar i autoritetit, udhëheqës etj. Ndërsa përdorimi i përbashkët, është në kuptimin ai që adhurohet. Allahu i Lartësuar thotë: *"Dhe ata në vend të Allahut morën ilahë (të adhuruar) të tjerë për t'u krenuar me ta. Përkundrazi, ata ilahët do të tërhiqen prej adhurimit të atyre dhe do të bëhen armiq të tyre."*[1]

Në ajet thuhet se *"morën ilahë"* dhe më pas thuhet se *"ata ilahët do të tërhiqen prej adhurimit të atyre"*. Dhe kjo tregon se marrja e ilahut është t'i bësh ibadet atij.

"O populli im, adhuroni Allahun. Nuk keni ilah tjetër përveç Tij."[2]

1. *19/Merjem, 81-82*
2. *7/A'raf, 59*

Në këtë ajet, në vend të thënies *"Nuk keni ma'bud (të adhuruar) tjetër"* është thënë *"...ilah tjetër"*. Dhe kjo tregon se në terminologjinë e Kur'anit fjala ilah dhe ai që adhurohet, janë në kuptim të njëjtë.

Atëherë teuhidi uluhije shqyrton veprat e robit, dhe se këto vepra robi duhet t'i bëjë vetëm për Allahun dhe këto vepra të jenë vetëm për Të. Që teuhidi uluhije të kuptohet më qartë, duhet që të kuptohet termi i ibadetit. Sepse esenca e këtij teuhidi, është njësimi i Allahut në ibadet.

Ibadetı

Kuptimi gjuhësor i fjalës ibadet: vjen nga rrënja a-b-d. Fjala abede përdoret në kuptimin: të lidhesh, të nënshtrohesh, të shtypesh. Prandaj arabët i thonë skllavit abd.

Kuptimi sheriatik i fjalës ibadet: veprat që Allahu i pëlqen, i dëshiron, të cilat i duhen drejtuar vetëm Atij ose duhen bërë vetëm për Atë. Po ta mendojmë ibadetin me këtë përkufizim, shohim se shumica e urdhrave të fesë kanë të bëjnë me këtë.

Përdorımı I Ibadetıt Në Kur'an

Kur thuhet ibadet, në përgjithësi në mendje vijnë veprat si namazi, zekati, haxhi. Ndërsa termi i ibadetit është një term më i gjerë. Për shkak se njerëzit nuk e dinë përmbajtjen e kësaj fjale, i bëjnë Allahut shirk në teuhidin uluhije, adhurojnë dikë tjetër përveç Allahut pa qenë në dijeni. Nuk është e mundur që njeriu ta njësojë Allahun në një gjë që e di mangët, apo që e di gabim, ose që nuk e di hiç fare. Për këtë shkak, u dërguan të gjithë pejgamberët me teuhidin uluhije. Nëse dëshirojmë të kuptojmë se një gjë është ibadet, kjo ka tre rrugë:

1. Veprimet për të cilat Kur'ani ose Sunneti thonë se janë ibadet.

2. Veprimet për të cilat thuhet se janë shirk kur i drejtohen tjetërkujt përveç Allahut.

3. Veprimet për të cilat përdoren si fjali të tilla: *"Kjo është vetëm për Allahun."*

Shembuj Nga Kur'ani

Shembulli i parë:

Thuaj: *"Namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botërave. Ai nuk ka asnjë shok. Me këtë jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve."*[1]

1. *6/En'am, 162/163*

Tek ky ajet, kufijt e ibadetit janë shumë të gjëra. Është theksuar se termat si jeta dhe vdekja duhet të jenë vetëm për Allahun. Kështu që, personi për çfarëdo lloj gjëje që jeton, për çfarëdo lloj gjëje që vdes, i bën ibadet asaj.

Po ashtu kuptohet që urdhërat sheriatike si namazi dhe kurbani janë ibadet. Kështu që siç bëhet mushrik ai person që e fal namazin për dikë tjetër përveç Allahut, po ashtu edhe ai që bën kurban për tyrbet, idhujt dhe për gjëra të ngjashme si këto, bëhet mushrik.

Shembulli i dytë:

"Zoti juaj ka thënë: "Më bëni dua Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen ibadetit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehennem." [2]

Nëse shihet me kujdes, Allahu më parë në këtë ajet ka thënë dua, më pas atyre që i shmangen duasë i thotë i shmangen ibadetit. Pra ka sqaruar se duaja është ibadet. Pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) pasi e lexoi këtë ajet tha. *"Duaja është thelbi i ibadetit."* [3]

Personi i cili i bën dua dikujt tjetri përveç Allahut, nëse i kërkon dikujt tjetri disa gjëra nga ato gjëra që i posedon Allahu, [4] i ka bërë Allahut shirk.

Shembulli i tretë:

"Ata i konsideruan "ahbarët" (rabinët) e tyre, "ruhbanët" (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos Allahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për ibadet ndaj Alllahut një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë." [5]

"Kur Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) e lexoi këtë ajet, erdhi Adij ibn Hatemi me një kryq argjendi të varur në

2. *40/Gafir, 60*
3. *Tirmidhiu*
4. *Pra nëse kërkon strehim, mbrojtje nga të këqijat në vendet e mira, ose falje gjynahesh siç kërkojnë kristianët nga priftërinjtë e tyre. (shënim i përkthyesit)*
5. *9/Teube, 31*

qafë, i cili në periudhën e xhahilijes ishte i krishterë dhe tha: "ata nuk i adhuruan rabinët dhe murgjit e tyre". Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i tha: "Drejtuesit e tyre të fesë ia bënë atyre hallallin haram dhe haramin hallall, ndërsa ata i pasuan ata në këtë. Ky pra është adhurimi që i bënë ata atyre."[6]

Kur'ani i cili është udhëzim e mëshirë dhe Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i cili është sqaruesi i tij, e kanë emërtuar ibadet dhënien e kompetencës që ia dha ehli kitabi drejtuesve të tyre të fesë në çështjen e ndryshimit të harameve dhe hallalleve të Allahut. Dhe kanë thënë se me dhënien e kësaj të drejte atyre, i kanë marrë ata për zota pos Allahut.

6. *Tirmidhiu*

La Ilahe Il-Lall-Llah Është Sımbolı I Teuhıdıt Uluhıje

Kelimetu't-Teuhidi ngaqë vjen në kuptimin të pranosh Allahun si ilah të vetëm, është simboli i teuhidit uluhije. Të gjithë pejgamberët i kanë thirrur njerëzit në këtë fjalë, ndërsa këtë fjalë e kanë shpjeguar kështu: të njësosh Allahun në ibadet dhe të refuzosh të gjithë ata të cilëve u bëhet ibadet përveç Tij.

"Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: Nuk ka ilah tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!" [1]

Rëndësıa E Fjalës Së Teuhıdıt

1. Është thirrja e përbashkët e të gjithë pejgamberëve. [2]

2. E merr në mbrojtje pasurinë dhe jetën e njeriut në dynja. Në hadith është thënë se *"Kush thotë La ilahe il-lall-llah dhe i refuzon të gjithë ata që adhurohen përveç Allahut, pasuria dhe jeta e tij bëhen haram."* [3]

3. Për hir të kësaj fjale luftohet. Prandaj pejgamberët kanë vrarë dhe janë vrarë. Në hadith është thënë se *"Unë jam i urdhëruar të luftoj me njerëzit derisa ata të dëshmojnë se s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) është robi dhe i dërguari i Tij."* [4]

4. Është çelësi i Xhennetit. I është bërë haram Xhehennemi atij të cilit e thotë me të vërtetë këtë fjalë, atij të cilit vepron me domosdoshmëritë e saj. Në hadith është thënë *"Kush thotë La ilahe il-lall-llah, hyn në Xhennet"*. Ndërsa në një transmetim tjetër është thënë se *"Allahu ia ka bërë haram zjarrin atij."*

5. Allahu jep shembull për fjalën e mirë, që është si pema me rrënjët e saj që janë të thella në tokë dhe degët e saj janë

1. *21/Enbija, 25*
2. *21/Enbija, 25*
3. *Muslimi*
4. *Muttefekun alejhi*

lart. Përsëri Allahu i forcon në dynja dhe ahiret ata të cilët besuan në fjalën e fortë.

"A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart. E që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frutin e vet në çdo kohë. Allahu pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe është si një pemë e keqe që është shkulur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar. Allahu i forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët Allahu i bën të humbur. Allahu punon çka të dojë."[5]

6. Gjëja e cila do të peshojë më rëndë në peshore është fjala e Teuhidit:

Nuhu (alejhis-selam) kur po ndërronte jetë i tha të birit të tij kështu:

"Po të urdhëroj ty fjalën La ilahe il-lAll-llah. Nëse kjo fjalë vendoset në një anë të peshores, ndërsa në anën tjetër të peshores vendosen shtatë qiejt dhe toka, kjo fjalë peshon më rëndë."[6]

Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka thënë kështu:

"Allahu në ditën e kijametit do të nxjerrë një person nga ummeti im përpara të gjithëve. Do të hapë 99 regjistra kundër tij. Secili regjistër është i madh aq sa sheh syri në distancë. Më pas do ta pyesë se a refuzon ndonjë gjë prej këtyre? Ai do të përgjigjet "Jo o Zot". Zoti do ta pyesë: "A ke ndonjë arsyetim?" Ai do të thotë: "Jo o Zot". Mbi këtë Allahu do t'i thotë: "Ti tek ne ke një hasene (vepër të mirë) dhe sot ty nuk do të bëhet padrejtësi". Më pas do të nxirret një copë letër mbi të cilën është shkruar: "Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij". Personi do të thotë: "O Zot, çfarë është kjo letër përpara gjithë këtyre regjistrave?". Zoti do t'i thotë: "Ty nuk do të bëhet padrejtësi". Më pas

5. *14/Ibrahim, 24-27*
6. *Imam Ahmedi, Musned*

do të vendosen regjistrat në një anë të peshores, ndërsa në anën tjetër të peshores do të vendoset copa e letrës. Do të ngrihen regjistrat lart dhe copa e letrës (pra, ana në të cilën u vendos fjala La ilahe il-lAll-llah) do të peshojë rëndë."[7]

7. *Tirmidhiu 2639; Ibn Maxhe 4300*

Kushtet E Fjalës La Ilahe Il-Lall-Llah

Fjala e teuhidit që t'i bëjë dobi njeriut dhe që ta bëjë atë musliman, duhet që njeriu t'i sjellë kushtet e saj në vend dhe të largohet nga faktorët që e prishin atë fjalë. Ç'është kushti? Dijetarët e usulit kushtin e përkufizojnë kështu: *"Kur nuk ekziston kushti, nuk ekziston as e kushtëzuara"*. Përshembull: abdesi është kusht i namazit. Nëse personi fal namaz pa abdes, kur e sheh nga jashtë duket sikur ka falur namaz. Por tek Allahu ky namaz nuk ka asnjë dobi. Ndërsa në gjykimin e dynjasë, kur kuptohet që ky person fal namaz pa abdes, i jepet gjykimi si lënës namazi. Kështu është edhe fjala e teuhidit. Kjo fjalë që t'i bëjë dobi njeriut edhe në këtë dynja edhe në ahiret, duhet që t'i sjellë kushtet e saj në vend dhe të largohet nga faktorët që e prishin atë. Përndryshe, nëse kjo fjalë thuhet vetëm me gojë, atëherë nuk ka ndonjë ndryshim nga papagalli.

Kushti i parë: Ta thuash me gjuhë:

I gjithë ummeti ka rënë në ixhma se personi i cili ka mundësi të flasë dhe nuk e thotë këtë fjalë, është qafir. Sepse në hadithet në lidhje me fjalën e teuhidit, janë përdorur fjalë si *"Kush e thotë, kush e shpreh, kush e shqipton etj"* që tregojnë se duhet thënë me gojë.

Kushti i dytë: Ta refuzosh tagutin:

Në gjuhën arabe fjala tagut do të thotë ta teprosh, t'i kalosh kufijt.

Në kuptimin sheriatik përdoret si: Shejtan, fallxhor, magjistar, udhëheqës që nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu etj. Fjala tagut në Kur'an kalon në tetë vende të ndryshme. Çdo dijetar i ka dhënë kuptim të ndryshëm duke marrë parasysh vendin ku kalon dhe shkakun e zbritjes së ajetit. Ndërsa kuptimi më i përgjithshëm është ky: Në çdo gjë që personi i kalon kufijt e tij përkundrejt Allahut, është tagut. [1]

"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush

1. *Ibn Kajjim, I'lamu'l Muvakkin, V. I, f. 50*

e refuzon tagutin e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. Allahu është Dëgjues i Dijshëm."[2]

Fjala për lidhjen më të fortë që kalon në ajet, është komentuar si: La ilahe il-lall-llah, Islam dhe Iman. Këto të treja janë të domosdoshmet e fesë. Që njeriu të quhet i kapur pas këtyre të domosdoshmeve, në fillim të ajetit janë përmendur dy kushte: Refuzimi i tagutit dhe besimi në Allah.

Në fillim të temës thamë që: Kur nuk ekziston kushti, nuk ekziston as e kushtëzuara. Refuzimi i tagutit është fjala e teuhidit e cila është kapja për lidhjen më të fortë dhe është kushti i parë i fjalës së teuhidit. Nëse ky kusht nuk sillet në vend, kjo fjalë nuk i bën ndonjë dobi personit. Në hadith thuhet që *"Kush thotë La ilahe il-lall-llah dhe i refuzon të gjithë ata që adhurohen përveç Allahut, pasuria dhe jeta e tij bëhen haram*". Ky hadith vendos kushtin e refuzimit e të gjithë atyre të cilët adhurohen përveç Allahut, që pasuria dhe jeta e tij të bëhen haram, pra që kjo fjalë t'i bëjë dobi personit.

Shënim: Edhe tek ajeti 256 i sures Bakara, edhe tek fjala e teuhidit, mohimi, refuzimi, thënia e La-së -pra të thuash jo- është përmendur para besimit në Allah. Shkaku i kësaj është se njerëzit nuk kishin probleme në besimin në Allah, por në refuzimin e tagutit, sepse pa e refuzuar tagutin njerëzit nuk mund të hyjnë në fe.

2. *2/Bakara, 256*

Kuptımı I Tagutıt Në Kur'anı

Në mësimin tonë të mëparshëm, patëm dhënë argumentet se personi i cili nuk e refuzon tagutin, nuk mund të bëhet musliman. Po ashtu, përmendëm edhe sqarimet e dijetarëve që i kanë bërë rreth tagutit. Tani ajetet në të cilat kalon taguti, do t'i shqyrtojmë një e nga një dhe do të mësojmë veçoritë e tij. Kur e ngushton tagutin në një përkufizim të vetëm, shumë njerëz nuk dalin dot jashtë atij përkufizimi. Nëse do t'i mësonim veçoritë e tij, do ta kuptonim se çdo gjë që i mbart këto veçori është tagut dhe do ta mohonim.

Veçoria e parë e tagutit:

"Allahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë. E kujdestarë të atyre që nuk besuan, janë tagut(ërit) që i nxjerrin ata prej drite e i hedhin në errësira. Ata janë banorë të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë."[1]

Veçoria e parë: çdo gjë që i çon njerëzit nga drita e uahjit (shpalljes) në errësirat e kufrit, është tagut. Personi nuk mund të bëhet musliman pa e mohuar këtë. Përshembull: Gjykimi në dritën e uahjit i takon Allahut. Ndërsa gjykimi në demokraci dhe në parti të cilat janë errësirat e kufrit, i takon popullit. Për shkak se këto parti i nxjerrin njerëzit nga drita e uahjit dhe i çojnë në errësirat e kufrit, janë tagut. Njerëzit në dritën e uahjit qëndrojnë në kijam vetëm përpara Allahut, vetëm përpara Atij bëjnë qëndrim respekti. Ndërsa nëpër shkolla të cilat janë simbolet e errësirave të kufrit, njerëzit qëndrojnë në këmbë përpara putave. Në dritën e uahjit fëmijëve si fillim i stabilizohet teuhidi në mendjet e tyre të pastra, ndërsa në këto institucione të kufrit mendjet e tyre përzihen me kufrijate si demokracia, laiciteti, nacionalizmi. Dhe kjo tregon se këto institucione janë tagut.

Ata të cilët i thërrasin njerëzit që ta lënë Kur'anin dhe Sunnetin mënjanë dhe të pasojnë librat për të cilët ata pretendojnë se

1. *2/Bakara, 257*

i kanë shkruar nga goja e profetit duke e parë në ëndërr, janë tagut. Ata janë duke i thirrur njerëzit që ta lënë Kur'anin i cili është nuri (drita), mëshira dhe udhëzimi i Allahut dhe që të futen në vesveset e shejtanit dhe në errësirën e imagjinatave të tyre.

Veçoria e dytë e tagutit:

"A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë taguti, e duke qenë se janë të urdhëruar që ta mohojnë atë. E shejtani dëshiron t'i humbë në pafundësi." [2]

Shkaku i zbritjes së ajetit është ky: Ndërmjet një çifuti dhe një munafiku lind një mosmarrëveshje. Çifuti ngaqë e dinte pejgamberin (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) si emin (të besueshëm) thotë që të gjykohemi tek ai. Ndërsa munafiku e dinte që ai do të gjykonte kundër tij, kështu që kërkon që të gjykohen tek njeriu i ditur çifut, Kab bin Eshrefi (në disa transmetime të tjera thuhet se ai kërkon që të gjykohen tek ndonjë fallxhor) dhe për këtë arsye zbret ajeti i lartpërmendur.

Ky ajet në një mënyrë të hapur thotë që ata që gjykojnë me gjykim tjetër dhe ata që vendosin kanun tjetër përveç ligjeve të Allahut dhe të dërguarit të Tij, janë tagut. Kështu që qoftë individ, qoftë institucion (parlament, fis etj.) të gjitha ligjet jashtë ligjeve të Allahut dhe ata të cilët i bëjnë këto ligje, janë tagut.

Shënim: Allahu Teala në këtë ajet me shprehjen *"ata që mendojnë se besuan"* e përgënjeshtron imanin e atyre njerëzve që nuk e mohuan tagutin dhe që gjykohen tek ai. Dhe si për shkak të kësaj ka thënë se *"e duke qenë se janë të urdhëruar që ta mohojnë tagutin dëshirojnë që mes tyre të gjykojë ai"*. Domethënë që çështja e mohimit të tagutit, nuk është çështje si çështja e haramit dhe hallallit, por është një çështje e ndjeshme akideje që mund ta kthejë imanin në pretendim. [3]

2. *4/Nisa, 60*
3. *Pra, neglizhimi i mohimit të tagutit e kthen imanin në pretendim, pasi ai është kusht i imanit. (shënim i përkthyesit.).*

Veçoria e tretë e tagutit:

"Ata që besuan luftojnë në rrugë të Allahut, e ata që nuk besuan, luftojnë në rrugë të tagutit. Luftoni pra miqtë e shejtanit, s'ka dyshim se intriga e shejtanit është e dobët." [4]

Në këtë ajet Allahu azze ue xhel-le flet për dy rrugë dhe për dy ushtri. Ushtria e parë beson dhe lufton që fjala e Allahut të jetë më e larta. Ndërsa ushtria e dytë individët i ka qafirë dhe lufton për çdo shkak (si atdheu, flamuri etj.) përveç ngritjes së fjalës së Allahut.

Pas këtij sqarimi, çdo ushtri që është formuar përveç ngritjes së fesë dhe ngritjes së fjalës së Allahut, është tagut dhe individët e kësaj ushtrie janë qafirë.

Veçoria e katërt e tagutit:

"Ata që u larguan prej adhurimit të tagutit dhe iu drejtuan Allahut, ata kanë gëzim të madh." [5]

Nga ky ajet kuptohet se çdo gjë që adhurohet përveç Allahut, është tagut. Personi nuk mund të bëhet musliman pa i mohuar këto. Atyre që u drejtohet duaja përveç Allahut, ata prej të cilëve shpresohet ndihmë (dhe që janë të kënaqur me këtë) dhe parlamentarët të cilëve u jepet kompetenca e ligjvënies, janë tagut.

Veçoria e atyre të cilët i besojnë tagutit:

"A nuk u vure re atyre që u është dhënë pjesë nga libri? Besojnë xhibtin e tagutin, dhe për ata që nuk besuan thonë: Këta janë në rrugë më të drejtë se ata që besuan." [6]

Veçoria më e qartë e atyre që i besojnë tagutit, është zgjedhja e rrugës së qafirëve ndaj rrugës së besimtarëve dhe zgjedhja e qafirëve ndaj besimtarëve.

4. *4/Nisa, 76*
5. *39/Zumer, 17*
6. *4/Nisa, 51*

Një person ose i beson tagutit ose e mohon at. Nuk ka rrugë të mesme në këtë pikë.

Ata të cilët nuk bëjnë kufër mbi tagutët (pra ata të cilët nuk i mohojnë tagutët), të cilët nuk largohen / distancohen nga tagutët dhe nga institucionet që ata i kanë tagutëzuar, të cilët i bëjnë atyre ato ibadete që ata ia kërkojnë, (ata) i kanë besuar tagutëve dhe janë duke i adhuruar ata.

Nuk i bën dobi personit që të thotë me gojë që e refuzon tagutin, ndërkohë që i bën ato që u përmendën më lart.

Mohımı I Tagutıt Dhe Largımı Prej Tıj

Allahu Teala përgjegjësinë tonë në lidhje me tagutin e thekson në dy ajete:

"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush e mohon tagutin dhe i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. Allahu është dëgjues i dijshëm."[1]

"Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: Adhuroni vetëm Allahun e largohuni nga taguti."[2]

Mohimi i tagutit dhe largimi prej tij, dalin përpara nesh si dy terma. Është farz ajn mbi çdo musliman që t'i kuptojë kufijt dhe të domosdoshmet e këtyre dy termave.

Daveti i pejgamberëve, mënyra e sjelljes së tyre me tagutërit e kohës së tyre, përmbajnë rëndësi të madhe në këtë pikë. Ai i cili na i ka mësuar ne këto terma, gjithashtu do të na mësojë neve edhe përgjegjësitë që kemi ndaj tyre.

Kur braktiset metoda e pejgamberëve, jetën tonë e rrethojnë metoda individuale. Dhe termat e domosdoshme të Islamit i perceptojmë në një mënyrë të ngushtë dhe jo të sigurtë se a janë të sakta apo jo, pra i perceptojmë sipas perceptimit të shoqërisë në të cilën gjendemi dhe në atë mënyrë i jetojmë.

Ndërkohë që mendojmë se kemi mohuar tagutin dhe se jemi larguar prej tij, tek Allahu mund të jemi shkruar prej atyre të cilët i kanë besuar tagutit dhe të cilët janë robër të tij!

Duke u bazuar në ndjeshmërinë e çështjes, përmasa e vetme duhet të jenë të dërguarit të cilët e kanë futur këtë term në jetën tonë.

Shohim se përpjekja e tyre me tagutërit ka dy dimensione... Dimensioni itikadije dhe amelije:

1. *2/Bakara, 256*
2. *16/Nahl, 36*

Dimensioni itikadije: *"Ju e keni shembullin më të mirë tek Ibrahimi dhe tek ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne jemi larg jush dhe asaj që adhuroni, pos Allahut. Ne ju mohojmë juve! Ndërmjet nesh e jush, është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm Allahun, Një!"* [3]

Allahu në këtë ajet, ummetit Islam i ka treguar shembullin më të mirë që i pëlqen dhe e ka përmbledhur dimensionin itikadije në tri pika:

1. Qëndrimi larg tagutit dhe nga njerëzit që i bëjnë ibadet atij.

2. Mohimi i tagutit dhe i atyre që nuk qëndrojnë larg atij.

3. Mbajtja e një urrejtjeje dhe armiqësie të përhershme përkundrejt tagutit dhe robërve të tij.

Ajetet që do të japim më poshtë, nëse shqyrtohen me vëmendje do të shihet se kanë kuptim të njëjtë.

"Thuaj: "O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni! As ju nuk jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!" [4]

"Këta, populli ynë ka besuar zota të tjerë pos Atij, pse pra nuk sjellin ndonjë argument të qartë për ata? A ka më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut? Derisa jeni izoluar prej tyre dhe prej asaj që adhurojnë ata, pos All-llahut, atëherë strehohuni në shpellë, e Zoti juaj ju dhuron nga mëshira e tij e gjerë dhe ju lehtëson në çështjen tuaj atë që është në dobinë tuaj." [5]

"Ne nuk themi tjetër vetëm se dikush prej zotave tanë të ka goditur me çmendje! Ai tha: "Unë dëshmitar e kam All-llahun, e ju dëshmoni se unë jam larg nga ajo çka ju i shoqëroni. (larg adhurimit) Pos Tij. Ju pra, të gjithë përpiquni kundër meje e mos më jepni afat. Unë i jam mbështetur All-llahut, Zotit tim

3. *60/Mumtehine, 4*
4. *109/Kafirun, 1-6*
5. *18/Kehf, 15-16*

dhe Zotit tuaj, pse nuk ka asnjë nga gjallesat, e që Ai të mos e ketë nën sundim, vërtet Zoti im është i drejtë."[6]

"(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahimi babait të vet dhe populllit të tij i tha: "Unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju, përveç Atij që më krijoi, dhe që Ai do të më drejtojë!" Dhe ai (Ibrahimi) e la të përjetshme atë fjalë (besimin në një Zot) ndër pasardhësit e vet, me shpresë që ata të kthehen prej rrugës së gabuar në rrugën e drejtë."[7]

"Unë po largohem prej jush dhe prej çka adhuroni ju pos Alllahut, e shpresoj se me adhurimin ndaj Zotit tim nuk do të jem i humbur!"[8]

Dimensioni amelije: Pasi realizohet qëndrimi larg tagutit dhe miqve të tij si itikad, duke pasur parasysh disa grada përfshin realizimin e një muxhadeleje (përpjekje) veprash përkundrejt tagutit.

"E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre, e me të (pra me përgatitje), ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët."[9]

Kjo është gradë përgatitjeje. Muslimanët më parë bëhen xhemat me njerëzit që janë bashkuar mbi të njëjtat baza të itikadit. Në një mënyrë të përshtatshme me Sunnetin profetik plotësojnë përgatitjet imanije (besimore) dhe bedenije (trupore) nën parimin emir-itaat (i parë dhe bindja ndaj të parit).

"Luftoni me ata derisa të mos ketë më fitne (shirk) dhe të mbesë feja e Allahut". Muslimanët të cilët e mbarojnë gradën e përgatitjes, fillojnë xhihadin që është zhdukja me duar e tagutërve të cilët janë me shpirt dhe pa shpirt. Nëse mohimi i tagutit mbetet vetëm në teori dhe nuk kalon në praktikë, fillon tërheqja mbrasht tek individët muslimanë.

6. *11/Hud, 54-56*
7. *43/Zuhruf, 26-28*
8. *19/Merjem, 48*
9. *8/Enfal, 60*

Të Vazhdojmë Me Kushtet E Fjalës La İlahe İl-Lall-Llah:

Kushti i tretë:

"Dije se nuk ka zot tjetër pos Allahut."[1]

Muslimi transmeton hadithin se *"Kush vdes duke e ditur se s'ka zot tjetër përveç Allahut, hyn në Xhennet."* Allahu Teala në ajet do nga pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) që këtë fjalë ta thotë duke e ditur e jo thatë. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në hadith thekson se fjala e teuhidit që e çon njeriun në Xhennet, duhet të jetë e mbështetur mbi dije. Njëra nga kushtet më të qarta të kësaj fjale, është që ta thotë atë duke e ditur se ç'ka beson, se ç'ka pranon dhe se ç'ka refuzon. Dhe ky është argument që injoranca nuk është arsyetim në meselet që kanë lidhje me fjalën e teuhidit.

Po ashtu edhe kuptimi i fjalës së shehadetit, e përmban këtë kusht. *"Dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç Allahut"*.

Të gjithë e dimë se njeriu për të dëshmuar për ndonjë gjë, duhet që ta dijë realitetin e ndodhisë. Nuk mund të mendohet kurrë, që njeriu të dëshmojë për ndonjë ngjarje që nuk e di brendinë e saj. Njeriu i cili dëshmon në uluhijetin e Allahut, është kusht që të dijë termat ilah, ibadet, tagut dhe termat e ngjashëm. Njësoj si një person që nuk e di kuptimin e fjalës *"Të divorcova"*, edhe sikur ta thotë njëqind herë këtë, gruaja e tij nuk divorcohet. Kuptimi i një fjale që nuk dihet në Islam, nuk ka ndonjë kuptim as në dynja, as në ahiret. Kështu është edhe fjala e teuhidit.

Sot disa njerëz i quajnë të gjithë muslimanë ata të cilët e thonë fjalën e teuhidit me gojë, por që nuk ia dinë brendinë dhe të domosdoshmet e saj. Ky qëndrim, është fyerja më e madhe që i është bërë pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ue

1. *47/Muhammed, 19*

sel-lem) dhe shokëve të tij. Pejgamberi dhe shokët e tij nuk vuajtën vuajtje pas vuajtje që njerëzit ta shprehnin këtë fjalë vetëm me gojë, por që t'ia dinin kuptimin asaj, që ta adhuronin Allahun, ta mohonin tagutin, pra që ta praktikonin këtë fjalë në jetët e tyre. Nëse do të ishte i mjaftueshëm kuptimi i teuhidit siç e kuptojnë njerëzit e sotëm që (nuk ka Zot tjetër përveç Allahut), atëherë mushrikët e Mekës nuk do të quheshin mushrikë, por muslimanë.

Shënim: Dija gjithmonë është domosdoshmëria e teuhidit dhe hidajetit (udhëzimit), ndërsa injoranca gjithmonë është domosdoshmëria e shirkut dhe dalaletit (humbjes).

Kushti i katërt: Ta thuash këtë fjalë plotësisht i bindur pa pasur pikë dyshimi:

Dhe njëra nga kushtet e kësaj fjale, është të besosh plotësisht i bindur, të besosh në teuhid pa nderë asnjë pikë dyshimi. *"Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të dërguarit e Tij, e mandej nuk dyshuan."*[2] Transmetohet tek Buhariu dhe Muslimi se *"Kush dëshmon duke qenë i bindur (në një transmetim tjetër kalon "kush dëshmon duke mos pasur dyshim") se nuk ka zot tjetër i Cili meriton të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij, Allahu ia bën haram zjarrin atij."*

Siç kuptohet nga ajeti dhe hadithi që t'i bëjë dobi fjala e teuhidit personit, që ta fusë atë nën strehën e Islamit dhe që ta ruajë atë në ditën e Gjykimit nga zjarri, është kusht që të mos ketë pikë dyshimi.

Kushti i pestë: Ta thuash këtë fjalë me ihlas (sinqeritet):

Kësaj fjale duhet t'i besosh vetëm për Allah, vetëm sepse do Allahu. *"Ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij."*[3]

Transmetohet tek Buhariu dhe Muslimi se *"Kush thotë me ihlas (sinqeritet) nga zemra La ilahe il-lall-llah, hyn në Xhennet"*.

2. *49/Huxhurat, 15*
3. *98/Bejjine, 5*

Kushti i ihlasit, është kushti më kryesor që i ndan munafikët dhe besimtarët nga njëri-tjetri.

Kushti i gjashtë: Të veprosh me të domosdoshmet e kësaj fjale:

"(Disa nga njerëzit) thonë: "Ne i kemi besuar Allahut, të dërguarit të Tij, dhe u jemi bindur. Por pas asaj, një grup prej tyre u zbrapsën. Të tillët nuk janë besimtarë." [4]

Një njeri nëse zbrapset nga bindja pasi thotë besova, pra nëse ia kthen shpinën veprave, ai nuk është besimtar. Për ata që thuhet në ajet *"Por pas asaj, një grup prej tyre u zbrapsën"* bëhet fjalë për ata të cilët pasi thanë besuam dhe nuk iu afruan veprave. Dhe kjo na tregon neve se vepra është nga të domosdoshmet e fjalës së teuhidit. Ulemaja e selefëve, imanin e ka përkufizuar kështu: Ta thuash me gojë, ta besosh me zemër dhe ta veprosh me gjymtyrë. Në fakt, po të hyjë imani në zemrën e njeriut nga një rrugë e saktë, nuk është e mundur që gjymtyrët e tij të mos binden.

Kushti i shtatë: Të ndërrosh jetë mbi këtë fjalë:

Në Islam, sa e rëndësishme është të shtiesh në dorë diçka, po aq e rëndësishme është edhe të qëndrosh mbi të dhe ta vazhdosh vazhdimin e saj. Përse në çdo namaz në Fatihanë që lexojmë gjatë ditës, kërkojmë më së pakti 17 herë udhëzim nga Allahu? Në fakt a nuk e ka gjetur udhëzimin një besimtar që fal namaz? Shkaku i kësaj është se ajo që është e vlefshme në Islam, është se si do të jetë gjendja e fundit e njeriut. Në hadith thuhet: *"Njëri nga ju një jetë të tërë bën veprat e Ehli Xhennetit. Derisa ndërmjet tij dhe Xhennetit, ka një largësi sa një krahë. Libri (kaderi) i tij e mund atë dhe ai bën vepra të Ehli Xhehennemit dhe hyn në Xhehennem. Sepse ajo që është e vlefshme është ajo që bëhet në fund". Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në një hadith tjetër thotë: "Veprat vlerësohen sipas gjendjes së fundit". "O ju që besuat, kini frikë Allahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë!"* [5]

4. *24/Nur, 47*
5. *3/Ali Imran, 102*

Në një hadih të saktë pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë se *"Kush vdes duke e ditur se s'ka zot tjetër përveç Allahut, hyn në Xhennet", "Kush vdes duke thënë si fjalë të fundit La ilahe il-lAll-llah hyn, në Xhennet"*. Ndoshta mirësia më e madhe e Allahut ndaj njeriut, është që t'ia marrë shpirtin atij mbi këtë fjalë pa i rrëshkitur këmba atij. Kjo, në të njëjtën kohë është duaja e të gjithë pejgamberëve. Që njeriu të vdesë mbi këtë fjalë, duhet që të jetë i sinqertë dhe të veprojë me të domosdoshmet e kësaj fjale.

Shënim: Nga të gjitha këto që kemi shqyrtuar këtu, del ky rezultat: Hadithi *"Kush thotë La ilahe il-lall-llah, hyn në Xhennet"* është njëri nga hadithet që është keqkuptuar më së shumti. Njeriu kur hulumton një çështje, është i detyruar që t'i mbledhë të gjitha argumentet rreth asaj çështjeje. Përndryshe siç devijon vetë, po ashtu devijon edhe të tjerët. Kur mblidhen të gjitha hadithet në lidhje me fjalën e teuhidit, del një kuptim i tillë: *"Kush e mohon tagutin dhe e thotë fjalën e teuhidit duke e ditur, duke qenë plotësisht i bindur pa pasur pikë dyshimi, duke vepruar me të domosdoshmet e kësaj fjale pa gënjyer, duke vepruar deri në fund të frymës së tij me këtë fjalë dhe ndërron jetë mbi këtë fjalë, hyn në Xhennet"*. Përndryshe bëhemi si Batinitë, që duke e ndarë fillimin dhe fundin e ajetit *"Mos iu afroni namazit"* e marrin vetëm një pjesë të tij.

Teuhıdı Rububıje

Teuhidi rububije është njësimi i Allahut azze ue xhel-le në të qenurit e Tij Rab.

Fjala Rab vjen në kuptimin edukues, zotëri, sejjid etj.

Ndryshimi ndërmjet teuhidit rububije dhe uluhije:

Uluhije, do të thotë njësimi i Allahut në ibadet. Për shkak se ibadeti përbën veprat e njeriut, uluhijeti është që personi ta njësojë Allahun në veprat e tij.

Ndërsa rububijeti është që personi ta njësojë Allahun në veprat e Allahut (si krijimi, furnizimi, gjykimi etj).

Bazat e teuhidit rububije janë ajetet 54 të sures A'raf dhe 31 të sures Junus.

"Vërtet, Zoti juaj, All-llahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin, Ai e mbulon ditën me natën, që me të shpejtë e kërkon atë (mbulimin e dritës së ditës), edhe dielli, edhe hëna e edhe yjet i janë nënshtruar sundimit të Tij. Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe urdhërimi. I madhëruar është All-llahu, Zoti i botëve."[1]

"Thuaj: "Kush ju furnizon me ushqim nga qielli e toka, kush e ka në dorë të dëgjuarit e të pamët (tuaj), kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri e kush e nxjerr të vdekurin nga i gjalli, kush rregullon çdo çështje?" Ata do të thonë: "All-llahu". Ti thuaj: "A nuk i frikësoheni?" (dënimit)."[2]

a. Krijimi: Është baza më e qartë e teuhidit rububije. Në ajetin 54 të sures A'raf thuhet *"Atij i takon krijimi dhe e drejta e urdhërimit"*. Gjatë historisë, të pakët janë ata të cilët i kanë dalë kundër kësaj baze. Ateizmi asnjëherë nuk ka qenë ndonjë mendim që ka shfaqur vazhdimësi. Sepse nuk është e mundur që krijesa e cila është njeriu, mos ta pranojë krijuesin.

1. *7/Araf, 54*
2. *10/Junus, 31*

b. Furnizimi: Në ajetin 31 të sures Junus thuhet: *"Thuaj "Kush ju furnizon me ushqim nga qielli e toka".* Allahu azze ue xhel-le është rregulluesi i universit si Rrab. Edhe furnizimi është i përfshirë në këtë rregullim.

Rrisku me Exhelin janë të njëjtë. Që të dyja janë caktuar në barkun e nënës, para se njeriu të krijohej. Siç nuk bëhet fjalë që exheli të shtyhet apo të merret përpara, po ashtu edhe për rriskun nuk bëhet fjalë që të ndryshojë. Në hadith thuhet kështu: *"Çdo njeri pret në barkun e nënës së tij 40 ditë në formën e lëngut, 40 ditë në formën e gjakut të ngjizur, 40 ditë në formën e copës së mishit. Pastaj vjen meleku dhe i fryen atij dhe atij (melekut) i urdhërohet që ta shkruajë exhelin, riskun e tij, se do të bëhet shaki (i dëshpëruar) apo said (i lumtur)". Në një hadith tjetër nga Ibn Mes'udi transmetohet se "Rrisku juaj i pakët mos t'ju shtyjë juve ta kërkoni atë me haram. Njeriu edhe sikur të largohet nga rrisku, ai do ta kapë atë siç e kap exheli atë."*[3]

Për shkak se njerëzit nuk i japin shumë rëndësi teuhidit rububije, ose për shkak të konceptit të gabuar se *"shumica e njerëzve e pranon rububijetin",* shumë njerëz i bëjnë shirk Allahut në teuhidin rububije. Sado që shprehin me gjuhët e tyre se *"Rrisku vjen nga Allahu",* jetesa, mendimi, dynjaja që e kanë bërë dert (hall), vlerësimi ndaj njerëzve me rrizk (si i pasur, i varfër etj) tregojnë se njerëzit nuk e pranojnë Allahun si Rrezzak (Furnizues, rrisk dhënës), por pranojnë njeriun. Veçanërisht në sistemet kapitaliste mendimi kryesor, është se rrizku është në dorën e punëdhënësve.

c. Sundimi / Pronësimi: Qenia e Allahut Sundues absolut, është nga bazat e teuhidit Rububije. *"Thuaj: "O Allahu im, Sundues/Pronar i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do."*[4] Kur personi e di që Allahu është pronar absolut, kjo gjë i jep atij pasuri shpirtërore. Edhe malli i dynjasë, është pronësi e Allahut. Allahu ngaqë është pronari

3. *Buhari dhe Muslimi*
4. *3/Ali Imran, 26*

i çdo gjëje, atë që e do e përdor ku të dëshirojë dhe e përdor si të dëshirojë.

d. Tedbiri / Rregullimi: Edhe njëra nga bazat e teuhidit rububije, është rregullimi i punëve të universit nga ana e Allahut. Në suren Junus thuhet *"Kush rregullon çdo çështje?"* Ata do të thonë: *"Allahu"*. Ndërsa në suren A'raf thuhet *"Edhe dielli, edhe hëna e edhe yjet i janë nënshtruar urdhrit të Tij"*. Në kohët e fundit nëpër tarikate, janë të hapura mendimet se punët e universit i rregullojnë shejhlerët, gavslerët, njerëzit e mirë etj. Dhe kjo gjë është shirk në rububije.

e. Urdhërimi dhe Ndalimi (vendosja e ligjeve): Në ajetin 31 të sures Teube pamë se ata të cilët ia japin të drejtën e ligjvënies të tjerëve përveç Allahut, i kanë marrë ata për zota. Ndërsa në suren A'raf thuhet se *"Kujdes, Atij i takon krijimi dhe e drejta e urdhërimit. I madhëruar është Allahu, Rrabi i botëve"*. Në tefsiret e këtyre ajeteve, të gjithë mufessirët (komentatorët) për qëllimin e fjalës rrab, kanë thënë se është ai që vendos ligje, ai që përcakton haramin e hallallin.

Mësuam se fjala Rrab vjen në kuptimin edukues, rregullues. Në sistemin qiellor nuk ka asnjë problem. Çdo gjë është në mënyrë të përkryer. Po në të njëjtën mënyrë, Allahu Teala edhe në rruzullin tokësor ka dhënë sistemin e ligjeve (sheriatit) të Tij. Shkaku i përhapjes së shkatërrimit, prostitucionit dhe zullumit në rruzullin tokësor, është ngase njerëzit ia kanë kthyer shpinën ligjeve të Edukuesit më të mirë.

Shënim: Thuhet se mushrikët e dinin teuhidin rrububije, ndërsa problemi i tyre ishte në teuhidin uluhije. S'ka dyshim se rukni (shtylla) më e rëndësishme e teuhidit, është teuhidi uluhije. Njerëzit për atë (për teuhidin uluhije) janë krijuar. Është e saktë se të gjithë pejgamberët në këtë pjesë të teuhidit janë përqëndruar. Por kjo, nuk tregon se mushrikët e dinin teuhidin rrububije.

Kur mendojmë rreth teuhidit rrububije sipas mënyrës që e shpjeguam, mund të thuhet se as njerëzit e djeshëm, e as njerëzit e sotëm nuk e dinë rrububijetin. Prandaj ajeti i parë që është zbritur, ka tërhequr vëmendjen për teuhidin rrububije duke thënë *"Lexo me emrin e Rrabit (Zotit) tënd, i cili krijoi (çdo gjë)"*. Po ashtu edhe në fillimin e Kur'anit, në suren el-Fatiha fillon me teuhidin rrububije. Edhe surja e fundit që është en-Nasi, mbaron me rrububijetin.

Rububijeti është të pranosh rregullimin e Allahut. Është të pohosh se Allahu e rregullon (e edukon) jetën e njerëzve dhe të shoqërive me sheriatin e Tij ashtu siç rregullon universin.

Dhe kjo gjë e bën të domosdoshme nënshtrimin ndaj ligjeve të Edukuesit më të mirë në jetën e përditshme, në përmasat e sakta - të gabuara, në veshmbathje, në vlerësimin e njerëzve dhe shoqërive, në çështjen se kë duhet të duam dhe se kë duhet të urrejmë, pra duhet ta realizojmë këtë nënshtrim ndaj Tij ashtu siç e realizojnë krijesat e tjera në univers… Ndërsa për shumicën e njerëzve të cilët duan të jetojnë kot e më kot, sipas tekave dhe dëshirave të tyre, kjo është shumë e vështirë.

Teuhıdı El-Esma Ues-Sıfaat

Përkufizimi: Njësimi i Allahut në të gjitha emrat dhe cilësitë që kanë ardhur në lidhje me Allahun në Kur'an e Sunnet dhe pranimi i tyre në formën që janë.

Kur e shqyrtojmë Kur'anin, pothuajse në fundin e çdo ajeti përmendet një emër dhe cilësi e Allahut. Qëllimi i shkencës së teuhidit, është që njerëzit ta njohin Allahun. Rruga më e mirë për të njohur një gjë, bëhet duke ditur veçoritë e saj. Për shkak se ne po mundohemi të njohim Allahun azze ue xhel-le, nuk ka rrugë tjetër ku të referohemi përveç Kur'anit dhe Sunnetit. Të përdorësh mendjen për një ekzistencë që nuk shihet, që nuk ndjehet me shqisat, është zullumi më i madh që mund të bëhet. Sepse mendja mund të perceptojë vetëm gjërat që shikon në botën e saj.

Cilësitë E Allahut Ndahen Në Dy Pjesë:

1. Cilësitë Dhatije: Janë cilësitë që Allahu është muttasif (i cilësuar) me këto qysh para zanafillës dhe që nuk ndahen nga ekzistenca e Tij. Përshembull cilësitë si dora, fytyra, këmba, e foluara, dëgjimi, shikimi etj.

2. Cilësitë Fiilije (Vepruese): Janë cilësitë e cilësuara si jo të vazhdueshme. Janë cilësitë e cilësuara kur Ai dëshiron diçka me shkak apo pa shkak. Përshembull si dashuria e Allahut për bamirësit, kënaqja e Tij nga as'habët e Bedrit, qeshja e Tij me personin i cili pasi vret një musliman, bëhet musliman dhe bie shehid.

Në pikën e emrave të Allahut, nuk ka ihtilaf (kontradiktë). Ihtilafi është në cilësitë e Allahut. Shkaku i këtij ihtilafi, është ngase disa njerëz, disa ajete në lidhje me cilësitë e Allahut i kanë kuptuar gabim dhe cilësitë që përputhen me mendjen i kanë pranuar, ndërsa cilësitë që nuk përputhen me mendjen i kanë bërë te'uil. Ehli Sunneti është larg nga këto grupe të devijuara dhe të gjitha cilësitë që kalojnë në Kur'an e Sunnet

i ka pranuar siç janë pa i bërë te'uil (interpretim), pa i bërë tahrif (shtrembërim), pa ia prishur kuptimin, pa i ngjasuar me krijesat.

Rregulla Në Emrat Dhe Cilësitë E Allahut

1. Themeli i emrave dhe cilësive duhet të jetë plotësisht Kur'ani dhe Sunneti. Sepse

për Atë të cilin flitet, është Allahu azze ue xhel-le. Ai person i cili flet për Atë ose mohon një gjë nga Ai:

- Ose duhet ta ketë parë Atë.
- Ose duhet ta dëgjojë nga një person që e ka parë Atë.
- Ose duhet t'i dorëzohet asaj që Allahu ka lajmëruar.

Kush ndjek ndonjë rrugë tjetër përveç kësaj, ka folur në emër të Allahut pa ditur dhe ka trilluar gënjeshtër ndaj Allahut. *"A po thoni për Allahun çka nuk dini? Thuaj: "Ata që trillojnë gënjeshtër për Allahun, nuk kanë për të shpëtuar."*[1]

Nëse Allahu ia përshtat vetes së Tij një cilësi -si dora, fytyra- njeriu nuk ka rrugëdalje tjetër përveç tre pikave që theksuam më lart. Personi i cili nuk i pranon këto cilësi, është duke trilluar gënjeshtër ndaj Allahut. Nxjerrja e mendjes përballë një teksti sheriatik, nuk është rruga e besimtarëve, por është rruga e shejtanit.

"(Allahu) Tha: "Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova?" Ai (Iblisi) tha: "Unë jam më i vlefshëm se ai, mua më krijove nga zjarri, e atë e krijove nga balta!"[2]

Ky ajet është një rregull i përgjithshëm. Kushdo që del kundër urdhrave të Allahut me krahasime logjike, bie në gjendjen që ra shejtani.

2. Ngjashmëria në emra, nuk e bën të domosdoshme ngjashmërinë në kuptim dhe cilësi. Ata që nuk i pranojnë cilësitë e

1. *10/Junus, 68-69*
2. *7/A'raf, 12*

Allahut si dora, fytyra, istivaja etj., thonë se këto cilësi gjenden edhe tek njerëzit dhe nëse do t'i pranonim këto, i bie që ta ngjasonim Allahun me njerëzit.

Emrat e njëjtë, asnjëherë nuk i bëjnë të domosdoshme format të njëjta. Përshembull edhe njeriu ka këmbë, edhe elefanti, edhe milingona... Por nuk ka ndonjë ngjashmëri ndërmjet tyre. Kur kjo gjë është kështu ndërmjet krijesave, a mund të bëhet ndonjë krahasim ndërmjet Krijuesit dhe krijesave? Veçanërisht ata që nuk i pranojnë cilësitë e Allahut duke i bërë te'uil, le t'i mohojnë edhe cilësitë si dëgjimi, shikimi, të qenurit i gjallë etj! Sepse këto gjenden edhe tek krijesat.

3. Atyre të cilëve i bëjnë te'uil cilësive i sillet argument në tri drejtime:

- Kur'ani
- Sunneti
- Ixhmaja e Selefëve

Ixhmaja e selefëve: Kur shohim në librat e tefsirit ndërmjet selefëve, shihet se cilësitë e Allahut nuk janë në rend të ditës dhe se nuk ka ndonjë ihtilaf rreth kësaj teme. Kjo gjë është argument se ata i kanë pranuar këto ajete siç janë. Fatkeqësisht pas shekullit të tretë të hixhrit, ata që u ndikuan nga filozofia Greke, i kuptuan këto ajete sipas mendjeve të tyre dhe i bënë te'uil këtyre ajeteve.

4. Ç'është te'uili, a është i keq çdo te'uil?

Fjala te'uil në termin gjuhësor, vjen në kuptimin si kthimi i një gjëje në origjinë, të ndodhë ajo që lajmërohet. Ndërsa te'uili në akide, është 'Ndryshimi i kuptimit të fjalëve dhahirije (të jashtme) për shkak të një argumenti'. Te'uili që kuptohet këtu, është se nuk ka ndonjë problem nëse bëhet në moment nevoje duke u bazuar në ndonjë argument të saktë. Përshembull në ajet thuhet që *"Kur ta lexoni Kur'anin kërkoni mbrojtje Allahut nga shejtani"*. Nga dhahiri (nga ana e jashtme e) këtij ajeti,

kuptohet se pasi të lexojmë Kur'an duhet që të themi E'udhu Besmelenë. Por në hadithe shihet se pejgamberi thoshte Besmelenë para se të fillonte leximin e Kur'anit. Dhe ne i bëjmë te'uil këtij ajeti. Ky pra është një te'uil sahih (i saktë).

Si shembull për te'uilin e gabuar të marrim ajetin *"Rrahmani isteva (u ngrit lartë dhe qëndroi mbi) Arsh (Fronin e Tij Madhështor, vërtet ashtu siç i shkon Madhështisë së Tij)".* Thonë që qëllimi nga istivaja është istilaja, sundimi i gjithçkaje. Ndërsa në Kur'an kalon shtatë herë që Allahu Teala bëri istiva mbi arsh. Fjala istila nuk është përdorur fare. Edhe fjala, vepra dhe heshtja e sunnetit sahih të pejgamberit, tregon se Allahu është në qiell. Atëherë ky te'uil është te'uil batil (i kotë). Është plotësisht në kundërshti me ajetet dhe hadithet.

5. Te'uili nuk është ta pastrosh Allahun nga të metat, por të bësh shtrembërime në cilësitë e Tij.

"Allahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirreni me ata e hiqni nga ata që bëjnë shtrembërime me emrat e Tij. Ata kanë për t'u dënuar për veprimet e tyre."[3]

Shtrembërimi në emrat e Allahut është; të devijosh nga qëndrimi që duhet mbajtur në emrat dhe cilësitë e Allahut. Po të donte Allahu, nuk i atribuonte Vetes së Tij asnjë cilësi dhe e pastronte Veten e Tij nga çdo gjë. Por Allahu në Kur'an ka përmendur për Veten e Tij shumë cilësi dhe e ka parë si mangësi qenien pa cilësi. Në ajet thuhet që *"A nuk e shihnin ata se ai (viçi) nuk u fliste as nuk i udhëzonte ata në ndonjë rrugë të drejtë?"*[4] Allahu Teala në këtë ajet për të treguar që viçi nuk ishte ilah, si argument ka marrë mosfoljen dhe mos udhëzimin e tij. Kështu që kur ilahu përmendet me cilësitë, kjo gjë për të është përsosmëri. Mospranimi i cilësisë që Allahu e ka parë të përshtatshme për Veten e Tij duke pështpëritur që po pastroj Allahun nga të metat, është shtrembërim e nuk është te'uil.

3. *7/A'raf, 180*
4. *7/A'raf, 148*

Shënim: Më parë patëm thënë se te'uili është; ndryshimi i kuptimit të fjalëve dhahirije (të jashtme) për shkak të një argumenti. Ndërsa të ndryshosh kuptimin e fjalëve dhahirije tek emrat dhe cilësitë pa pasur ndonjë argument, është shtrembërim.

6. Nuk krahasohet krijesa me Krijuesin:

Për të krahasuar diçka me një gjë, kushti i parë dhe kryesor është gjendja e një pike të përbashkët ndërmjet tyre. Ta krahasosh Allahun me robërit në emrat dhe cilësitë, është të shtrembërosh cilësitë gjë e cila është në kundërshti me kushtin e parë të kijasit (krahasimit). Sepse ndërmjet Allahut dhe robit, nuk ka asnjë pikë të përbashkët. Përshembull cilësitë si dora, syri, istivaja të thuash që këto nuk gjenden tek Allahu duke i menduar këto si të njeriut, është një kijas batil. Ndonjëherë disa cilësi që janë veçori të përkryera tek njerëzit, nuk mund të jenë tek Allahu, ose ato veçori që janë të përkryera për Allahun, tek njeriu ato mund të jenë mangësi për të. Përshembull; ngrënia dhe pirja për njeriun janë veçori të përkryera. Kjo gjë tregon se njeriu është i shëndetshëm. Po kështu është edhe gjumi. Ndërsa kur i mendojmë këto cilësi për Allahun, kjo është mangësi. Ai që është Zot s'duhet të ketë nevojë të hajë dhe të pijë. Përshembull; cilësia e krenarisë dhe madhësisë për Allahun, është cilësi e përkryer. Ndërsa kur mendohen tek njerëzit, këto cilësi janë ulje dhe mangësi. Domethënë që njeriu nuk duhet t'i refuzojë emrat dhe cilësitë e Allahut duke i krahasuar tek bota e tij.

7. Ç'është Teshbihu?

Teshbihu është të ngjasosh diçka me një diçka tjetër. Teshbihu në emrat dhe cilësitë, është t'i ngjasosh cilësitë e Allahut me cilësitë e mahlukut (krijesës). Allahu Teala me shprehjet *"Me të nuk është askush i barabartë" "Asgjë nuk ngjason me Të"* ia ka mbyllur derën teshbihut.

Ne si Ehli Sunnet i pranojmë cilësitë e Allahut si istivanë,

zbritjen në qiell, por themi që *"Nuk ia dimë mënyrën. Këto cilësi janë në formën që i përshtaten madhështisë së Allahut"*. Nga një anë i pohojmë ajetet e cilësisë, ndërsa nga ana tjetër themi që asnjë gjë nuk është e barabartë me Allahun. Ehli Sunneti ka rënë në ittifak (unitet) se ta ngjasosh Allahun me robërit, është kufër.

Shënim: Në përgjithësi ata të cilët i bëjnë te'uil cilësive, Ehli Sunnetit i thonë mushebbihe. [5] Kështu që mundohen që t'i largojnë njerëzit nga ata. Ndërsa kur mendojmë mjaft mirë, shohim se ehli te'uili është më i përshtatshëm për të qenë mushebbihe. Sepse ata në të gjitha cilësitë e mendojnë Allahun si njeri, e ngjasojnë me të dhe ashtu pohojnë. [6]

Ndërsa Ehli Sunneti, si fillim pranon se çdo cilësi e Allahut i përshtatet madhështisë së Tij dhe se ato nuk ngjasojnë nga ndonjë anë me cilësitë e robërve.

Nëse ehli te'uili do ta kishte lënë të krahasuarit e Allahut me robin, te'uili i cili e ka përçarë ummetin me shekuj do të kishte mbaruar.

8. Fjala *"Rruga e selefit (e të parëve) është eslem (dorëzim). Ndërsa rruga e halefit (e të mëvonshmëve) është më e informuar dhe më e urtë"*:

Në përgjithësi, këtë fjalë e thonë kelamistët. Për shkak se selefët nuk janë marrë me kelam, nuk i kanë bërë te'uil cilësive. Ata që erdhën më pas duke u uzurpuar nga filozofia greke, i bënë te'uil cilësive nën emrin e kelamit. Ngaqë u bë shumë i qartë kundërshtimi ndaj selefëve, ata u detyruan të trillonin këtë fjalë. Ata thonë që *"Selefët zgjodhën rrugën më të mirë duke mos folur rreth meseles, ndërsa ne zgjodhëm rrugën e shqyrtimit të meseles me ilm (dije) dhe hikmet (urtësi)"*. Kjo fjalë është batil nga dy drejtime. Në ajete thuhet se *"Në qoftë se ata besojnë*

5. *Mushebbihe është një grup që e ngjason Allahun me njeriun. (shënim i përkthyesit).*
6. *Pra, autori thotë që ata janë mushebbihe. Sepse kur përmendet dora e Allahut në Kur'an ata e kujtojnë dorën e Allahut si dora e njeriut dhe kështu e refuzojnë atë cilësi. Pra, ata i refuzojnë cilësitë duke e menduar Allahun si njeri. Kështu që mushebbihe janë ata e jo Ehli Sunneti. (shënim i përkthyesit).*

ashtu siç besuat ju, ata vërtet kanë gjetur rrugën e drejtë, e nëse refuzojnë, atëherë ata janë kundërshtarë."[7]

"Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij."[8]

Këto dy ajete janë përmasa në itikad. Allahu ka vendosur si kusht që të besosh siç besuan ata dhe t'i pasosh ata me punë të mira. Për ata të cilët bëhet fjalë në ajet, janë sahabët. Kush i kundërshton ata në itikad, rruga e tij nuk është rruga e ilmit dhe hikmetit, por është rruga e devijimit dhe e humbjes.

Që një rrugë të jetë më e mira, personi duhet ta dijë atë rrugë. Përndryshe ajo rrugë nuk është një rrugë e sigurt. Kështu që rruga e cila është më e mira, edhe ilmi me hikmetin i përket poseduesve të asaj rruge. Ibn Tejmijje për ata të cilët e thonë këtë fjalë thotë që *"Disa budallenj thonë kështu"*.

Cilësitë e diskutueshme

1. Istivaja: Allahu azze ue xhel-le në shtatë vende në Kur'an thotë që *"Allahu (ose Rrahmani) isteva (u ngrit lartë dhe qëndroi mbi) arsh"*. *Istivaja nga ana gjuhësore do të thotë të ngrihesh, të qëndrosh. Ehli Sunneti istivanë e pranon siç është. Thotë që "Allahu mbi shtatë palë qiej bëri istiva mbi arsh, në një mënyrë që i përshtatet Atij"*.

Ndërsa te'uilxhinjtë, thonë se istivaja nuk pranohet logjikisht. Duke pretenduar se një gjë e tillë të bën ta mendosh Allahun si trup thonë se *"qëllimi te istivaja është istilaja"*. Pra Allahu mori gjithçka nën sundimin e Tij.

Këtij dyshimi i përgjigjemi kështu:

▪ Allahu Teala në shtatë vende në Kur'an ka përdorur fjalën istiva. Nëse qëllimi do të ishte *"istila"*, qoftë edhe një herë të vetme, kjo fjalë duhej të përdorej në Kur'an.

7. *2/Bakara, 137*
8. *9/Teube, 100*

▪ Të gjitha ajetet në Kur'an në të cilat kalon fjala "zbritëm" tregojnë se Allahu është lart. Sepse zbritja bëhet nga lart poshtë.

▪ Allahu në suren Mulk duke thënë se: *"A u garantuat ju prej Atij që është në qiell",* [9] shpreh në një mënyrë të hapur se Ai është në qiell.

▪ Veprimet e ngritjes dhe ngjitjes lart në Kur'an dhe Sunnet, tregojnë se Allahu është lart. (Përshembull ndodhia e Miraxhit).

▪ Në këtë temë kanë ardhur shumë hadithe nga pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) dhe kur është folur për këtë itikad pranë tij, ai nuk ka kundërshtuar. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në duanë e sëmundjes thoshte *"O Zoti ynë që je në qiell, emrat e Tu janë të shejntë."* [10] Kur e kundërshtuan në momentin që po ndante sadakanë, u tha atyre: *"A nuk më besoni mua, kur unë jam i besueshmi i Atij që është në qiell."* [11] Në haxhin e Lamtumirës duke bërë me shenjë nga qielli tha: *"O Zoti im, dëshmo..."*. Një herë pyeti një robëreshë se *"Ku është Allahu?",* ajo i thotë: *"në qiell"*. Pastaj e pyet se *"Kush jam unë?",* ajo i thotë se *"Ti je i dërguari i Allahut"*. Ai thotë që *"kjo grua është besimtare" dhe e urdhëron pronarin e saj që ta lirojë atë."* [12]

▪ **Ixhmaja e selefëve:** Selefët të cilët ishin gjuhëtarë dhe e njihnin Allahun dhe të dërguarin e Tij më mirë nga të gjithë, qoftë edhe sikur njëri prej tyre, nuk ka ardhur me ndonjë gjë që të jetë në kundërshti me këtë itikad.

2. Dora: Ulemaja e selefëve pa bërë te'uil dhe teshbih, ka thënë se Allahu ka dy duar. *"Çifutët thanë: "Dora e Allahut është e shtrënguar!" Qofshin të shtangura duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, për atë që thanë. Jo, dy duart e Tij janë të shlira."* [13] Në këtë ajet, Allahu i ka kundërshtuar çifutët. Metoda e përgjithshme e Kur'anit, është që ta hedhë poshtë mendimin e mush-

9. *67/Mulk, 16*
10. *Ebu Davudi*
11. *Muslimi*
12. *Muslimi*
13. *5/Maide, 64*

rikëve dhe çifutëve, kur thonë diçka gabim rreth Allahut. Ky ajet, është nga argumentet më të qarta të cilësisë së dorës.

Në një ajet tjetër thuhet kështu: *"O Iblis, çka të pengoi ty t'i bësh sexhde atij që Unë e krijova me duart e Mia?"*. Në hadithe pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) lajmëron se Allahu në ditën e Kijametit do t'i mbledh qiejt brenda pëllëmbës së Tij. Ehli te'uili ose Ehli tahrifi (shtrembërimi) duke e krahasuar Allahun me njerëzit, sipas atyre ata e kanë pastruar Allahun nga këto cilësi. Dhe dorës së Allahut i kanë bërë te'uil si nimet (mirësi) dhe kudret (fuqi). Tani t'i praktikojmë këto te'uile të devijuara tek ajetet;

a. *"Dy nimetet e Allahut janë të shlira"*. Ehli te'uili duke u larguar nga një gabim, ka rënë në një gabim më të madh. Nimetet e panumërta të Allahut, ata i kanë zbritur në dy me këtë te'uil të devijuar. Duke thënë se do ta pastrojmë Allahun nga të metat, i kanë vënë Atij mangësi.

b. *"Dy kudretet e Allahut janë të shlira"*. Edhe kjo është po aq e kotë sa e para. Zoti i cili është një, është një bashkë me cilësitë e Tij.

c. *"O Iblis, çka të pengoi ty t'i bësh sexhde atij që Unë e krijova me kudretin (fuqinë) time?"*. Allahu çdo gjë e ka krijuar me fuqinë e Tij. Nëse ajeti interpretohet në këtë mënyrë, Ademit (alejhis-selam) nuk i mbetet asnjë meritë. Dhe natyralisht është e kotë që Allahu ta përmendë këtë.

Çdo bidat si ky e çon njeriun në një bidat më të madh, çdo metodë e devijuar e çon njeriun në një devijim më të madh. Bashkë me këtë pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në hadithe thotë se edhe dy duart e Allahut janë të djathta. Dhe kjo na tregon neve se cilësia e *"dorës"* është larg perceptimit tonë dhe është nga meselet që kërkon dorëzim ndaj saj.

3. Zbritja e Allahut në qiellin e dynjasë: Në hadithe të sakta pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë kështu: *"Allahu në çdo natë në një të tretën e fundit të natës zbret në qiellin e dynjasë dhe thërret: "A nuk ka ndonjë që kërkon që t'ia jap atë që*

ai kërkon? A nuk ka ndonjë që lutet, që t'i përgjigjem lutjes së tij? A nuk ka ndonjë që kërkon falje, që t'ia fal gjynahet atij?"

Ehli Sunneti cilësinë e nuzulit (zbritjes) së Allahut, e besojnë ashtu siç është, duke ia lënë Allahut mënyrën e zbritjes. Ehli te'uili e ka mohuar edhe këtë cilësi duke thënë se kur zbret Allahu, arshi a rri bosh? A është Allahu një trup që lëviz? etj.

Shënim: Ehli te'uili cilësitë që nuk kanë ardhur në Kur'an nuk i pranojnë, ndërsa ato cilësi që kanë ardhur në Sunnet, duke thënë se janë hadithe ahad i refuzojnë. Dhe ky është një drejtim tjetër i devijimit të tyre. Cilësitë si istivaja, dora, syri në Kur'an kanë ardhur muteuatir. Por përsëri nuk i pranojnë.

Dhe kjo tregon se qëllimet e tyre nuk janë që të zhvillojnë një metodë të saktë, por ata përpiqen që metodat e filozofëve grek t'i bëjnë sunduese mbi Kur'anin dhe Sunnetin.

Hadıthı Ahad Dhe Hadıthı Muteuatır Në Akıde

Çështë muteuatiri?

Hadithi muteuatir: Transmetimi i një hadithi nga aq shumë njerëz, saqë nuk mund të mblidhen mbi një gënjeshtër. Dhe kjo shumicë duhet të jetë në çdo brez.

Dispozita: Të vepruarit me muteuatir qoftë në akide, qoftë në ahkam (në fikh) tek i gjithë ummeti është uaxhib. Ai që mohon një nass (ajet ose hadith) muteuatir, bëhet qafir.

Çështë hadithi ahad?

Hadithi ahad: Çdo hadith që nuk përmban cilësinë e muteuatirit quhet hadith ahad.

Dipozita: Të vepruarit me një hadith, që e ka isnadin (zinxhirin) sahih, tek ehli haku (pasuesit e të vërtetës) është i detyrueshëm. Nuk shihet se a është muteuatir apo ahad. Në Islam për të pranuar diçka nuk është e rëndësishme shumica, por saktësia e atij haberi (lajmi). Sahabët dhe selefët kurrsesi nuk i kanë veçuar hadithet si muteuatir dhe ahad, nuk kanë thënë se me këtë hadith veprohet e me këtë jo. Për ata, ishte e mjaftueshme saktësia e hadithit që të vepronin me të.

Shënim: Mospranimi i hadithit ahad në akide, si fillim ka dalë tek kelamistët. Këta shumë mesele të itikadit, në krye duke qenë Teuhidi Esmau ues-Sifat i komentojnë me mendjet e tyre. Dhe hadithet në lidhje me çështjen nuk i pranojnë, duke thënë se janë hadithe ahad. Në fakt kjo nuk është gjë tjetër, vetëm se mbulim i devijimeve të tyre me një formë sheriatike. Sepse siç e pamë edhe më parë që edhe cilësitë si istivaja, dora, syri etj., të cilat kalojnë në Kur'an, këta përsëri nuk i pranojnë. Dhe kjo tregon se përmasë për këta është mendja.

Argumentet që tregojnë se hadithi ahad pranohet në akide

1. Tek Buhariu dhe Muslimi Ibn Abbasi transmeton kështu:

"Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) kur po e dërgonte Muadh bin Xheb elin në Jemen i tha: O Muadh! Ti po shkon tek një popull që është Ehli Kitab. Gjëja e parë për të cilën do i thërrasësh ata të jetë fjala e shehadetit. Nëse ata e njësojnë Allahun, lajmëroi ata se Allahu i ka bërë atyre farz çdo ditë pesë kohët e namazit..."

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) e dërgoi Muadhin të vetëm në Jemen. Dëshiroi që t'i mësonte atyre akiden (fjalën e shehadetit) dhe ahkamin (pesë kohët e namazit). Lajmi i atij të cilit është i besueshëm, edhe i vetëm qoftë ai, është argument edhe në akide edhe në ahkam.

2. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) kur i thërriste njerëzit në Islam, në çdo zonë dërgonte një përfaqësues.

3. Allahu të gjithë pejgamberët i ka dërguar të vetëm.

Imanı

Kuptimi gjuhësor: Të besosh diçka ose ndonjë gjë.

Kuptimi sheriatik: Ta shprehësh me gjuhë, ta besosh me zemër dhe ta veprosh me gjymtyrë. Çdo njëra nga këto tre pika, është nga shtyllat e imanit. Nëse është njëra e nuk është tjetra, ajo nuk quhet iman. Përshembull, nëse personi e shpreh me gjuhë, por nuk e beson me zemër, nuk mund të quhet mu'min (besimtar). Shkurtimisht, për t'u bërë një person mu'min duhet që t'i posedojë të treja kushtet.

Shprehja me gjuhë dhe besimi me zemër në përgjithësi, janë gjëra që i pranojnë të gjithë. Shtylla për të cilën njerëzit janë në kontradiktë, është veprimi me gjymtyrë. Në këtë temë, është shumë i përhapur mendimi se vepra nuk është nga imani, ose vepra është e domosdoshme për plotësimin e imanit. Këto që të dyja janë të gabuara. Vepra është kusht i imanit. Një iman pa vepër, nuk është gjë tjetër vetëm se një pretendim i thatë.

Argumente që tregojnë se vepra është nga imani

1. Për të gjitha premtimet e mira që bëhen në ajete thuhet se *"Ata që besuan dhe bënë vepra të mira"*.

2. Shprehja *"Ky është shpërblimi i veprave që keni bërë"* përdoret shumë në Kur'an ndaj banorëve të Xhennetit dhe të Xhehennemit.

3. Edhe në ajetin 5 të sures Bejjine thuhet se *"E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë"*.

4. Tek Buhariu në kapitullin e imanit kalon se pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka thënë kështu: *"Ju urdhëroj juve imanin. A e dini ju se çka është imani? Imani është të besosh se s'ka ilah (të adhuruar) tjetër përveç Allahut, se Muhammedi është i dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin…"*

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në këtë hadith në një mënyrë të hapur e ka përkufizuar imanin me vepra.

5. Në një hadith tjetër thuhet se *"Imani është i ndarë në 70 e disa degë. Grada më e lartë është fjala e teuhidit, ndërsa grada më e ulët është të heqësh një pengesë nga rruga. Edhe turpi është nga imani"*. Edhe në këtë hadith tregohet se imani përbëhet nga degë dhe degët përbëhen nga veprat.

6. *"Allahu nuk ua humb juve imanin tuaj."*[1] Qëllimi i imanit këtu është namazi. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) pasi shkoi në Medine, u fal nga drejtimi i Bejtul Makdisit 16-17 muaj. Më vonë si kible u bë Qabja. Mu'minët pyetën se çka do të bëhet me namazin e atyre që vdiqën, pa e parë ndryshimn e kibles? Për këtë Allahu zbriti këtë ajet dhe namazin e tyre e cilësoi si iman.

Argumenti se vepra nuk është kusht i plotësimit të imanit, por është kusht i pranimit:

"Ata (hipokritët) thonë: "Ne i kemi besuar Allahut, të dërguarit të Tij, dhe u jemi bindur. Por pas asaj, një grup prej tyre u zbrapsën (prej asaj që thanë). Të tillët nuk janë besimtarë."[2]

Në këtë ajet Allahu Teala imanin e atyre të cilëve pasi thanë besuam dhe u bindëm e më pas ia kthyen shpinën bindjes, pra veprës, ia mohoi imanin duke thënë *"se ata nuk janë besimtarë"*. Domethënë që vepra nuk është kusht për plotësimin e imanit, por është kusht për pranimin e tij.

Munafikët në kohën e Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), edhe pse atyre i vinte rëndë, falnin namazin me xhemat, dilnin në luftë, jepnin zekatin, mbanin agjërimin etj. Ata e dinin shumë mirë që personi i cili braktiste veprën, nuk kishte vend në bashkësinë e Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Nëse do të ishte e mjaftueshme që personi të konsiderohej musliman vetëm me pranimin ose pohimin e

1. *2/Bakara, 143*
2. *24/Nur, 47*

shtyllave të besimit, atëherë munafikët do të braktisnin çdo lloj vepre dhe do të mjaftoheshin vetëm me thënien "besuam".

Shtimi Dhe Pakësimi İ İmanit, İstisnaja Në İman Dhe Degët E Tij

Tek Ehli Sunneti imani shtohet dhe pakësohet. Imani shtohet me veprat e llojit të bindjes dhe pakësohet me veprat e llojit të masijetit (mosbindjes).

Istisnaja në iman: Istisnaja në iman domethënë të thuash *"InshaAllah jam mu'min"*. Disa kanë thënë se *"imani është punë jakini (bindshmërie), kështu që thënia inshaAllah ngaqë është shenjë dyshimi nuk lejohet të thuhet"*. Ajo që është e saktë në këtë temë, është se lejohet istisnaja në iman. Mirëpo personi nuk duhet ta thotë këtë me dyshim, por duke ia lënë përfundimin e punës Allahut.

Degët e imanit: Imani përbëhet nga degët. Ka disa degë që kur braktisen e nxjerrin personin nga feja; siç është fjala La ilahe il-lall-llah. Dhe ka disa degë që kur braktisen, nuk e nxjerrin personin nga feja, por e bëjnë banor të Xhehennemit. Dhe ka edhe disa degë që kur i braktis personi këto, nuk bëhet banor Xhehennemi, por i bie grada e imanit.

1. Baza e imanit: është imani i cili është kusht që personi të qëndrojë në fe. Nëse braktisen veprat që janë nga baza e imanit, është kufër. Përshembull; mohimi i tagutit, falja e namazit. Bërja e këtyre është nga bazat e imanit, ndërsa braktisja e këtyre është kufër.

2. Uaxhibi i imanit: Janë ato vepra që kur veprohen, e bëjnë personin banor të Xhennetit, ndërsa kur braktisen edhe pse nuk e nxjerrin personin nga feja, janë vepra që e bëjnë banor të Xhehennemit. Siç është agjërimi i muajit të Ramazanit, mosbërja zina, mospirja e alkoolit etj…

3. Mustehabi i imanit: Përfshin veprat që janë të domosdoshme për plotësimin e Imanit, duke futur dy pjesët e para dhe ato vepra që janë më të vogla se ato.

Si Gjykohet Në Islamin Ose Imanin E Personit?

Përse ndiejmë nevojë për gjykimin e imanit të një personi?

Sepse në Islam shumë gjykime bazohen mbi iman dhe kufër.

- Muslimani duhet, ndërsa qafiri urrehet.
- Muslimani merret për mik, ndërsa qafiri jo.
- Ndaj udhëheqësit musliman ka bindje, ndërsa ndaj udhëheqësit qafir ka kundërshtim.
- Mbrapa muslimanit falet namazi, me të bëhet akti i martesës, gjykimet në lidhje me aktin e trashëgimisë janë të sakta. Ndërsa aktet që bëhen me qafirët janë batil (të pavlefshme).

Në bashkësitë Islame, ajo që është bazë, është se njerëzit janë muslimanë. Edhe personi të cilin nuk e njohim fare (nëse nuk ka ndonjë kufër të hapur), në bashkësinë Islame shihet si musliman. Ndërsa në bashkësitë e kufrit, njerëzit shihen si qafirë, përderisa të shohim tek ndonjë person shenja Islami.

Ç'është shenja Islame?

Shenja Islame; është fjala, vepra dhe itikadet që janë të posaçme vetëm për muslimanët, gjëra me të cilat muslimanët dallohen nga ithtarët e feve të tjera. Një vepër që është në Islam, nuk është e domosdoshme të quhet shenjë Islame. Që të quhet shenjë Islame, është kusht që të jetë e veçantë vetëm për muslimanët. Me ndryshimin e kohës, vendit dhe bashkësive, shenjat Islame mund të ndryshojnë. Përshembull në hadith thuhet se:

"Kush e fal namazin tonë, kush drejtohet nga kibla jonë, kush ha nga ajo që therim ne, ai është musliman." [3]

Pra, në Islamin e një personi është gjykuar me namaz. Nëse shikohet me kujdes, po në të njëjtën kohë ibadeti i haxhit nuk ishte një shenjë Islami, ndërkohë që haxhi është nga shtyllat

3. *Buhari dhe Muslimi*

e Islamit. Mirëpo haxhi në atë periudhë ishte një ibadet që e bënin edhe mushrikët edhe muslimanët, ndërsa namazi ishte një ibadet që e bënin vetëm muslimanët. Kështu që sot për të gjykuar për Islamin e një personi, mund të themi se shenjat Islame janë këto: Mos të votosh, të qëndrosh larg demokracisë, mos të shkosh në ushtri (të kufrit), të qëndrosh larg shirkut të varreve, të mos e dërgosh fëmijën në shkollat e sistemit të shirkut.

Kufrı Dhe Shırku

Kuptimi gjuhësor: Kufër do të thotë të mbulosh.

Kuptimi sheriatik: Kur personi mohon diçka që është e domosdoshme në fe, ose kur bën ato gjëra që Allahu i quan kufër, qofshin ato fjalë, vepra apo itikade.

Ndërsa shirku është kur personi nuk e njëson Allahun në çështjet që duhet njësuar Atë dhe kur i përshkruan Atij shok.

Llojet e kufrit:

1. Kufri i mohimit: Kur personi mohon të domosdoshmet e fesë. Përshembull; mohon besimin në ahiret.

2. Kufri i mendjemadhësisë: Kur personi nuk i bindet urdhrave të Allahut duke bërë mendjemadhësi. Përshembull; si shejtani i cili nuk i bëri sexhde Ademit (alejhis-selam).

3. Kufri i inatit: Personi i cili duke e ditur të vërtetën nuk e pranon duke bërë inat ndaj saj. Përshembull; si kufri i mushrikëve të Mekës.

4. Kufri i taklidit (imitimit): Kur personi baballarët, zakonin etj., i shikon si më të rëndësishme se feja dhe nga ajo që ka sjellë pejgamberi.

5. Kufri i xhehlit (injorancës): Personi i cili i ka mundësitë dhe nuk i mëson ato gjëra që i ka farz. Siç është gjendja e mushrikëve të sotëm.

6. Kufri i kthimit të shpinës: Kur personi nuk interesohet ndaj fesë.

7. Kufri i talljes: Kur personi nuk i jep rëndësi urdhrave të fesë dhe tallet me to.

8. Kufri i nifakut (hipokrizisë): Kur personi shpreh me gojë Islamin, ndërsa në zemër fsheh kufrin. [1]

1. *Pika e tetë është vendosur nga përkthyesi.*

Këto janë lloje të kufrit që dijetarët Islam i kanë nxjerrë duke parë Kur'anin dhe Sunnetin. Qëllimi nga kjo rradhitje është që meseleja të kuptohet më mirë, që çdo lloj i kufrit të shpjegohet nën tituj të veçantë.

Nuk është e detyrueshme që këto pjesë të dihen në mënyrë të detajuar. Ajo e cila është vaxhib mbi muslimanin është që ai të dijë besimet, veprat dhe fjalët të cilat Allahu Teala i pranon si kufër, që të largohet me patjetër prej tyre, ndërsa veprues-ve të tyre t'i japë emrin (qafir / mushrik / munafik) që ia ka dhënë Allahu Teala.

Nuk është kusht *"mohimi"* që personi të bjerë në kufër

Sipas mendimit të përhapur, një person për të rënë në kufër, duhet me patjetër që të mohojë. Ky mendim në ummetin Islam, ka dalë për shkak të përkufizimit të gabuar të imanit. Ata të cilët e kanë përkufizuar imanin vetëm si tasdik (të besosh), kufrin e kanë përkufizuar si përgënjeshtrim dhe mohim. Kështu që personi çfarëdo që të bëjë, nuk bëhet tekfir mbi të përderisa të mohojë. Ky mendim quhet mendim Xhehmijje ose mendim Murxhie gulatijje (Murxhiat ekstremistë). Imam Ahmedi, Hal-lali dhe shumë dijetarë nga selefët, i kanë bërë tekfirin këtyre.

Argumenti se personi bie në kufër edhe me fjalë dhe vepra pa përgënjeshtruar dhe mohuar:

"Ata betohen në Allahun se nuk kanë thënë (asgjë të keqe), e në të vërtetë kanë thënë fjalë kufri, dhe ata mohuan pasi patën besuar."[2] Në këtë ajet Allahu ia bëri tekfirin atyre vetëm për shkak të një fjale.

"Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi besuat, mohuat."[3] Edhe në këtë ajet, edhe pse ata dolën në xhihad bashkë me pejgamberin (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), Allahu ia bëri tekfirin disave prej tyre për shkak se u tallën me fenë.

2. *9/Teube, 74*
3. *9/Teube, 66*

A Është Injoranca Arsyetim?

Në mësimin e mëparshëm, sqaruam se personi del nga feja me cilëndo fjalë që Allahu e quan kufër. Kur shikojmë bashkësinë në të cilën jetojmë, njerëzit bëjnë çdo gjë që Allahu e quan kufër. Por shumica e njerëzve e bën këtë me injorancë (!). Prandaj del në rend të ditës se a është injoranca arsyetim apo jo. Para se të hyjmë në këtë temë, më parë ka një mesele të rëndësishme që duhet kuptuar dhe që do të jetë hyrje për këtë temë.

Allahu Teala në Kur'an me ajetet *"Dije se s'ka të adhuruar tjetër përveç Allahut", "A nuk mendojnë ata", "A nuk logjikojnë ata", "A nuk e meditojnë ata këtë Kur'an"* dhe me ajete të ngjashme me këto, vazhdimisht i bën thirrje njerëzve që të mësojnë, që të mendojnë, që të logjikojnë, që të meditojnë. Përsëri Allahu në Kur'an e ka kritikuar xhehlin dhe injorancën. E ka kritikuar me një gjuhë shumë të ashpër atë person të cilit i vjen Kur'ani dhe i kthen shpinën:

"Po çka kishin ata që largoheshin prej Kur'anit? Ata ishin si gomerë të egër."[1] Në një ajet tjetër thuhet që *"Kush është më zullumqar se ai që është këshilluar me argumentet e Zotit të vet, e ua kthen shpinën atyre"*. Në këto ajete ka një reagim të rëndë ndaj atyre që ia kthejnë shpinën Kur'anit dhe që janë të pa interesuar. Dijetarët Islam duke u mbështetur te kjo pikë, kanë thënë se çdo njeri e ka farz ta njohë Allahun, të mësojë teuhidin të posedojë aq dije sa të besojë në një mënyrë të paluhatshme. Dhe gjithashtu kanë thënë se kush ka mundësi dhe nuk i mëson këto, ose është i pa interesuar ndaj këtyre, ai është njësoj si ata që i dinë këto, por që nuk i praktikojnë dhe se ai person nuk arsyetohet. Personi që arsyetohet është ai që kur dëshiron nuk ia mbërrin dot, kur kërkon nuk gjen ndonjë që t'ia mësojë.

Mundësia është ekzistenca e Kur'anit dhe Sunnetit. Nëse një

1. *74/Muddeth-thir, 49-50*

person e arrin Kur'anin, por nuk e hulumton atë, ose nuk ka interes ndaj tij, këtij personi nuk i thuhet injorant, por person që i ka kthyer shpinën Kur'anit, ose i pa interesuar ndaj tij. Sepse Allahu Teala në Kur'an thotë kështu;

"E mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush deri në ditën e kijametit)."[2] Ky ajet tregon hapur se personit të cilit i mbërrin Kur'ani, atij i është tërhequr vërejtja. Kështu që po ta shqyrtojmë meselenë e injorancës, shohim se bashkësia jonë nuk ka ndonjë lidhje me injorancën. Injoranca qoftë arsyetim, qoftë mos arsyetim, ajo nuk ka të bëjë me bëshkësinë tonë. Kur i tërhiqet vëretja bashkësisë sonë, ajo është e pa interesuar ndaj Kur'anit, nuk interesohet për të.

2. *6/En'am, 19*

Të Qenurit Dhe Të Mosqenurit E Injorancës Arsyetım

Nëse një person bën diçka pa e ditur dispozitën sheriatike në lidhje me atë që bën, këtij i thuhet xhahil (injorant). Kur e pranojmë injorancën si arsyetim, kjo do të thotë se personi nuk është përgjegjës për gabimin që bëri, nuk ndëshkohet në dynja dhe nuk dënohet në ahiret për atë gabim. Nëse themi se injoranca është arsyetim për atë person i cili pi alkool duke mos e ditur dispozitën e pirjes së alkoolit, atëherë mbi atë nuk zbatohet dënimi sheriatik në dynja dhe nuk dënohet në ahiret me dënimin e pirësve të alkoolit.

Nëse themi se injoranca nuk është arsyetim, atëherë personi i cili bën ndonjë gabim qoftë edhe duke mos e ditur, ai ndëshkohet edhe në dynja edhe në ahiret.

Kundërshtimi i sheriatit të Allahut është i ndarë në pjesë dhe çdo pjesë ka dispozitat e saja të veçanta. Kështu që injoranca në disa lloje të kundërshtimeve është arsyetim, ndërsa në disa lloje të tjera nuk është arsyetim.

Shirku i madh dhe bërja shirk ndaj Allahut

Injoranca e personit i cili i bën shirk Allahut, nuk është arsyetim, sepse në natyrën e çdo njeriu është stabilizuar se bërja shirk ndaj Allahut është e shëmtuar. Për shkak se në natyrën e çdo njeriu ekziston dija se shirku është gabim, në këtë çështje nuk arsyetohet asnjë përgjegjës.

"Drejtohu si hanif (me sinqeritet, përkushtim) në fenë (e pastër), natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. Nuk ka ndryshim (të asaj natyrshmërie) të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Drejtohuni Atij me pendesë, frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni prej mushrikëve."[1]

Me këtë ajet është shprehur haptazi se hanifllëku, pra lënia e

1. *30/Rrum, 30-31*

shirkut dhe animi nga teuhidi është natyra në të cilën Allahu Teala i ka krijuar të gjithë njerëzit. Dhe Allahu, si domosdoshmëri të kësaj natyre, ka urdhëruar adhurimin, ibadetin, drejtimin ndaj Tij dhe lënien e shirkut.

Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka thënë kështu:

"Çdo fëmijë lind mbi natyrën (Islame). Më pas prindërit janë ata që e bëjnë atë çifut, kristian ose mexhusi (zjarrputist)."[2]

"... Unë robërit e mi i krijova të gjithë si hanifë (pra mbi natyrë të pastër). Më pas shejtanët i devijuan ata nga feja e tyre dhe i urdhëruan ata që ta bëjnë haramin hallall dhe të më bëjnë shirk Mua..."[3]

Teuhidi, i cili është stabilizuar në natyrën e njeriut kur ai është krijuar dhe për të cilin është marrë fjala e besës nga njeriu, e shfuqizon arsyetimin e injorancës dhe imitimit.

"Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre (duke u thënë): "A nuk jam Zoti juaj?" Ata thanë: "Po, dëshmuam!". Të mos thoni në ditën e kijametit: "Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur". Ose të mos thoni: "Prindërit tanë më parë ishin idhujtarë, e ne ishim pasardhës të tyre. A do të na shkatërrosh ne për atë që bënë ata asgjësues të së vërtetës?" Po, kështu ua sqarojmë argumentet, që ata të kthehen nga e gabuara në të vërtetën."[4]

Allahu Teala për t'ia përkujtuar njerëzve këtë fjalë ka dërguar pejgamberë, ka zbritur libra, ka bërë thirrësa që ftojnë për tek e vërteta dhe çdo vend të universit e ka mbushur me argumente që ata (njerëzit) të meditojnë dhe të marrin mësim.

Ata të cilët i kanë shkuar pas kësaj dije e cila gjendet në natyrën e njeriut, ata të cilët kanë menduar dhe logjikuar në lidhje me atë, kanë jetuar si muvahhidë (njësues të Allahut), ndërsa ata të cilët nuk i kanë dhënë rëndësi kësaj dije, të cilët

2. *Buhari, Muslimi*
3. *Muslimi*
4. *7/Araf, 172-174*

janë mjaftuar me atë që kanë gjetur nga prindërit e tyre, ata kanë jetuar si mushrikë.

Komenti i qartë i këtyre ajeteve dhe hadithe ësht ë qëndrimi që mbajti Islami ndaj njerëzve të cilët jetuan para ardhjes së Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Ndërmjet Isait (alejhis-selam) dhe Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka kaluar një periudhë 600 vjeçare. Në këtë periudhë nuk ka pasur as libër, as pejgamber. Feja e tyre ekzistuese ishte shtrembëruar, shirku dhe devijimi ishin përhapur.

Megjithëkëtë, Allahu Teala nuk i pranoi si të arsyetuar ata të cilët i bënë shirk Allahut në atë periudhë. Ndërkohë që emri i asaj periudhe ishte "periudha e injorancës". Ajo periudhë u emërtua e tillë për shkak se veçoria më e përhapur në atë periudhë ishte injoranca.

Imam Muslimi transmeton se një person e pyeti të dërguarin e Allahut: *"Ku është babai im?"* Ai u përgjigj: *"Në zjarr"*. Kur ky person po ikte, Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) e thirri dhe i tha: *"Edhe babai im, edhe babai yt janë në zjarr"*.

Të njëjtin hadith e transmeton Ibn Maxhe nga Abdullah ibn Umeri (radijAll-llahu anh):

"Erdhi një beduin tek i dërguari i Allahut dhe i tha: "O i dërguari i Allahut, babai im në periudhën e injorancës i mbante lidhjet farefisnore" dhe pasi i përmendi të mirat e tjera të tij, e pyeti se "ku është babai im?". Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i thotë: "Në zjarr". Kjo i erdhi rëndë beduinit dhe e pyeti: "Po babai yt ku është o i dërguari i Allahut?" Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i thotë: "Me cilindo varr të mushrikut të rastisesh, përgëzoje atë me zjarr". Më vonë beduini u bë musliman. Ai thoshte kështu: "Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) më ngarkoi mua një detyrë të rëndë. Me cilindo varr të mushrikut rastisem, e përgëzoj atë me zjarr".

Kështu që kushdo që ka jetuar dhe ka vdekur në atë pe-

riudhë, edhe pse ka pasur vepra të mira, (beduini) e ka përgëzuar me zjarr. Shkaku i vetëm i kësaj është se ata ibadetin që duhej t'ia bënin Allahut, ia drejtuan dikujt tjetër përveç Tij duke mos ditur, duke qenë injorantë dhe duke e komentuar rrugën e prindërve të tyre si një rrugë të hajrit.

Imam Muslimi transmeton: *"Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) vizitoi varrin e nënës së tij. Ai qau sa që i bëri të qajnë edhe ata që gjendeshin aty. (Më pas) tha kështu: "I kërkova leje Zotit tim të kërkoja falje për nënën time, por nuk më dha leje. I kërkova leje që ta vizitoja varrin e saj dhe më dha leje".*

Istigfari/kërkimi i faljes për mushrikët është i ndaluar. Edhe pse është nëna e Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem), për shkak se ajo i bëri shirk Allahut, Ai nuk e fali atë.

Pranë kësaj, ai i cili i shkoi pas dijes të cilën e kishte në natyrën e tij dhe i cili e njësoi Allahun, ai fitoi dynjanë dhe ahiretin. Zejd ibn Amr ibn Nufejli ishte njëri prej atyre.

Imam Buhari transmeton nga Abdullah ibn Umeri (radijAll-llahu anh):

"Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) u përball me Zejd ibn Amr ibn Nufejlin në pjesën e poshtme të Beldahut. Ky takim u realizua përpara se Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) t'i vinte shpallja. Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i ofruan një sofër, në sofër kishte edhe mish. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i'u shmang të ngrënit nga sofra dhe atë ia ofroi Zejdit. Edhe ai u shmang nga të ngrënit e saj. Më pas Zejdi tha kështu: "Unë nuk ha nga mishi të cilin e keni therur për idhujt tuaj. Unë ha vetëm nga e therura në të cilën është përmendur emri i Allahut". Zejdi i kritikonte kurejshit për shkak të asaj që thernin dhe i thoshte kështu: "Delen e krijoi Allahu, dhe për të zbriti ujë nga qielli dhe nxorri bimë nga toka, ndërsa ju e therni atë pa e përmendur emrin e Allahut". Në këtë mënyrë, Zejdi nxirrte në pah se këto sjelljet e tyre ishin të këqija."[5]

5. *Buhari*

Ndërsa në një transmetin tjetër vijon kështu:

"Zejd ibn Amr ibn Nufejli për të mësuar dhe për të pasuar fenë e vërtetë shkon në Sham (bashkë me Varaka ibn Neufelin). Aty u takua me një dijetar çifut. E pyeti atë rreth fesë së tij dhe i tha: "Ndoshta do të hyj në fenë tuaj (ma trego mua atë)". Çifuti thotë: "Ti nuk mund të hysh në fenë tonë pa marrë hise nga hidhërimi i Allahut". Zejdi i thotë: "Unë për t'u larguar nga hidhërimi i Allahut erdha këtu (unë nuk po kërkoj hidhërim, por mëshirë dhe kënaqësi) dhe me sa të kem mundësi, kurrsesi nuk kam ndërmend që të marrë hise nga hidhërimi i Allahut. Kështu që më trego ndonjë tjetër (që të shkoj tek ai)". Dijetari çifut i thotë: "Unë nuk di ndonjë gjë tjetër përveç hanifllëkut". Zejdi i thotë: "Çfarë është hanifllëku?". Dijetari çifut ia shpjegon: "Është feja e Ibrahimit. Ai nuk ishte as çifut as kristian, gjithashtu nuk adhuronte ndonjë gjë tjetër përveç Allahut". Zejdi kur ndahet nga ai, takohet me një dijetar kristian. Edhe atij i thotë po të njëjtat gjëra. Ai i thotë: "Ti nuk mund të hysh në fenë tonë pa marrë hise nga mallkimi i Allahut". Zejdi i thotë atij: "Në fakt, unë për t'u larguar nga mallkimi i Allahut erdha në këto vende. Dhe me sa të kem mundësi, kurrsesi nuk do të marr hise nga mallkimi i Allahut. A mund të më tregosh ndonjë tjetër?". Dijetari i thotë: "Jo, unë nuk di ndonjë gjë tjetër përveç hanifllëkut". Zejdi i thotë: "Çfarë është hanifllëku?". Dijetari i thotë: "Është feja e Ibrahimit. Ai nuk ishte as çifut, as kristian, ai adhuronte vetëm Allahun". Zejdi kur i dëgjoi fjalët e tyre rreth Ibrahimit u largua nga aty dhe kur doli jashtë ngriti duart lart dhe tha: "O Allahu im, Ty të kam dëshmitar, unë jam në fenë e Ibrahimit."[6]

Kufriatet e tjera përveç shirkut të madh

Kundërshtimi i ndonjë meseleje e cila është e domosdoshme që të dihet në fe siç është bërja e hallallit haram dhe haramit hallall, mohimi i një dispozite sheriatike (si mohimi i obligueshmërisë së namazit), tallja me ndonjë mesele sheriatike, miqësimi i armiqve të Allahut etj.[7]

6. *Buhari*
7. *Dija e cila është e domosdoshme që të dihet në fe: Janë dijet të cilat janë farz ajn për çdo musliman. Disa dijetarë këtë e kanë quajtur "Ilmu amme". Këto janë dije të cilat duhet t'i dijë çdo*

Të mësuarit e këtyre meseleve, është e mundur me Kur'an dhe me Sunnet. Këto për shkak se nuk janë të stabilizuara në natyrën e njeriut, personi dijen e saktë duhet ta mësojë nga një burim i jashtëm.

Dijetarët Islam në lidhje me këto lloj çështjesh përmendin këtë rregull: *"Muslimani i ri ose ai i cili jeton në një zonë larg muslimanëve, për shkak se ekziston gjendja e mosdijes së këtyre dispozitave, atij i shpjegohen dispozitat dhe nëse ai vazhdon akoma në kundërshtim bëhet qafir, nëse pendohet ai është i arsyetuar me injorancë.*

Ndërsa ai i cili jeton në mesin e muslimanëve, për shkak se ai është përgjegjës për t'i ditur këto dispozita, ai nuk arsyetohet me injorancë".

Kundërshtimi në meseletë sheriatike

Përsa i përket meseleve të cilat nuk janë shirk të madh, të cilat nuk janë të domosdoshme që të dihen në fe:

Mësimi i këtyre meseleve, të pasurit dijeni deri në detajet e fesë, është farz kifaje. Nuk është e detyrueshme që këto t'i mësojë çdo person. Ata të cilët i kundërshtojnë urdhërat sheriatike në këto lloj çështjesh, janë të arsyetuar.

përgjegjës me mendje të shëndoshë dhe në të cilat injoranca nuk arsyetohet. Farzet e Allahut dhe haramet e Tij hyjnë në këtë pjesë.

Përhapja E Kufrıt Dhe Shırkut Tek Ky Ummet

Për shkak se njerëzit, ajetet në lidhje me kufrin dhe shirkun i kanë kuptuar sikur kanë zbritur vetëm për ummetet e tjera, mendojnë se kufri dhe shirku nuk ka për t'u përhapur kurrë tek ky ummet. Ose ngaqë në ummet është i përhapur mendimi i Murxhiave, mendojnë se njerëzit pasi të dëshmojnë shehadetin, nuk bien më kurrë në kufër. Kjo gjë nën dritën e haditheve të pejgamberit dhe të atyre gjërave që janë jetuar, është një mendim batil (i kotë).

1. Tek Tirmidhiu dhe Ebu Davudi, kalon se Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: *"Nuk ka për t'u bërë kijameti derisa një grup nga ummeti im të adhurojë putat dhe një grup t'i bashkohet mushrikëve".* Ky hadith është argument i hapur që tregon se shirku do të përhapet në këtë ummet.

2. Pejgamberët (duke përfshirë edhe pejgamberin tonë) vazhdimisht i kanë porositur ummetet dhe pasardhësit e tyre që të qëndrojnë në Islam dhe po kështu kanë bërë dua për ta. Përshembull Ibrahimi dhe Ismaili kanë bërë dua kështu: *"Zoti ynë, bëna neve dyve muslimanë të sinqertë ndaj Teje dhe bëji pasardhësit tanë një ummet musliman."*[1] *"E Ibrahimi i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe Jakubi. (u thanë) "O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë (Islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë musliman."*[2]

3. Tek Buhariu dhe Muslimi, transmetohet se Ebu Hurajra ka thënë kështu: *"Kur pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ndërroi jetë dhe Ebu Bekri u bë kalif, i gjithë gadishulli arabik u kthye nga feja, përveç një grupi të vogël nga Meka, Medineja dhe nga bregu i Bahrejnit. Disa iu bindën pejgamberit gënjeshtar, disa thanë që ne nuk e japim zekatin dhe disa e braktisën fenë Islame duke marrë guxim prej atyre që u kthyen nga feja. 90 % e atyre që*

1. *2/Bakara, 128*
2. *2/Bakara, 132*

kishin besuar në kohën kur pejgamberi ishte në jetë, u kthyen nga feja. Ebu Bekri bashkë me sahabët luftuan me ta dhe një shumicë të tyre e vranë, ndërsa një shumicë prej tyre u prapësua prej frikës". Kjo ngjarje na tregon neve në një mënyrë shumë të qartë, se Islami nuk është një fe si mbledhje matematikore. Në Islam shumica e tyre që gabojnë ose rënia e shumicës në gabim, nuk e ndryshon gjykimin, sepse shumica dhe marrja për bazë fjalën e shumicës, është baza e fesë së demokracisë. Sahabët nuk bënë ndonjë mbledhje matematikore kur shumica u kthye nga feja, nuk hezituan fare për të luftuar kundër tyre. Shkaku më i madh që i shtyn disa që kufrin dhe shirkun që është përhapur në ditët e sotme ta bëjnë të ligjshëm në emër të Islamit, është ngaqë mashtrohen kur shumica e njerëzve bëjnë kufër dhe shirk. Musai (alejhis-selam) ka thënë kështu: "Nëse ju, dhe të gjithë ata që janë në tokë bëni kufër, Allahu është i panevojshëm (për falënderim), i lavdishëm (vetvetiu)."[3]

3. *14/Ibrahim, 8*

Lıgjvënıa

Në fakt teuhidi i hakimijes (ligjvënies) është tema e përbashkët e teuhidit uluhije, rrububije dhe esmau ue sifaatit. Veçanërisht shqyrtohet në temën e uluhijes dhe rububijes. Mirëpo në kohët e fundit, ngaqë teuhidi i ligjvënies nuk kuptohet, dhe veçanërisht për shkak se në këtë pikë ka shumë probleme, poseduesit e dijes, teuhidit të ligjvënies i kanë dhënë një vend të veçantë dhe e kanë përmendur si një temë të pavarur.

1. Dhe njëra nga pesë bazat e teuhidit rrububije, është ta njësosh Allahun në autoritetin e urdhërimit dhe ndalesës. Pra, ta njësosh Allahun Teala në çështjet siç është vendosja e ligjeve, përcaktimi i hallallit dhe haramit. Nga argumentat e kësaj është tefsiri i ajetit 31 të sures Teube.

2. Teuhidi i uluhijes është ta njësosh Allahun në cilësitë e ilahut, pra ta njësosh në ibadet. Dhe njëra nga kuptimet e fjalës ilah është të drejtosh, të gjykosh, të jesh kompetent. Në këtë drejtim, teuhidi i ligjvënies është brenda uluhijes.

3. Teuhidi esmau ues-sifaat. Njëri nga emrat e Allahut është el-Hakem, pra Gjykues.

Këto na tregojnë neve se sa i rëndësishëm është teuhidi i ligjvënies. Pika e përbashkët e tre pjesëve të teuhidit, është ligjvënia. Qëllimi i krijimit të njeriut është që të adhurojë Allahun. Ndërsa adhurimi është që personi t'i bëhet rob Allahut, pra t'i bindet urdhërave dhe ndalesave të Tij. Dhe kjo është vetë teuhidi i ligjvënies.

Një njeri që mendon siç duhet, e kupton shumë mirë këtë: të gjitha kanunet e universit i ka përcaktuar Allahu. Kur e shqyrtojmë universin edhe pse ai nuk ka mendje dhe ndërgjegje, shohim që në trupat e tij ka një sistem të përsosur. Po në të njëjtën mënyrë, siç është Allahu drejtuesi i universit, po ashtu është edhe drejtuesi i jetesës së njerëzve. Nëse njerëzit do t'u dorëzoheshin ligjeve të Allahut, do ta ndienin edhe tek vetet e

tyre atë sistem të përsosur të universit. Përsëri kur mendojmë, Allahu i cili ka krijuar njeriun, ndërsa universin ia ka ofruar në shërbim të tij, s'ka dyshim se nuk do të lihet pa përgjegjësi. *"A mos mendon njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë (pa kurrfarë përgjegjësie)."*[1] Ndërmjet atyre të cilët e quajnë veten musliman, nuk ka pasur ndonjë ihtilaf në çështjen që Allahu është hakim, drejtues, vendosës ligjesh. Por në praktikë kjo bazë ka pasur muhalefet (kundërshtim) serioz. Këto do t'i shqyrtojmë një e nga një në mësimet që vijojnë.

Një dyshim: Disa thonë se nuk ka ndonjë term si teuhidi i ligjvënies, nuk ekziston diçka e tillë tek sahabët dhe selefët.

Përgjigja: Për të qenë diçka itikad, nuk është e domosdoshme që sahabët dhe selefët të kenë folur për të. Përshembull, në meselet e emrave dhe cilësive nuk ka ndonjë ihtilaf (kontradiktë) ndërmjet sahabëve dhe nuk kishte ndonjë term si teuhidi esmau ues-sifaat. Në periudhat e mëvonshme kur njerëzit filluan të devijojnë në emrat dhe cilësitë, dijetarët e selefëve filluan të rëndohen në këtë pjesë të teuhidit, të shkruajnë libra të veçantë në këtë temë dhe ta shpjegojnë këtë. Po kështu është edhe teuhidi i ligjvënies.

1. *75/Kijameh, 36*

Gjendje Që Janë Kundër Teuhıdıt Të Lıgjvënıes

Teuhidi i ligjvënies; është njësimi i Allahut si vendosës ligjesh. Ligjet dhe mënyra e jetesës së çdo sistemi që nuk është përcaktuar nga Allahu, por nga institucionet dhe njerëzit, është sistem shirku dhe njerëzit të cilët e pëlqejnë këtë janë mushrikë. Ai që vendos ligje përveç Allahut qoftë shumica në demokraci, qoftë diktatori, qoftë perandoria, qoftë dinastia e një mbretërie, nuk ka ndryshim fare, që të gjithë janë mushrikë.

Demokraci; është një fjalë greke. Përbëhet nga fjalët Demos (populli) dhe Krates (gjykimi).

Kuptimi; gjykimi i takon popullit ose populli të drejtojë vetveten. Forma më e përhapur e kësaj është; pjesëmarrja e popullit në zgjedhje, votimi i ndonjërit prej kandidatëve që kanë dalë përpara dhe me votën që jep, ta dërgojë në parlament atë që zgjodhi si përfaqësues në mënyrë që ai të bëjë ligje në emër të tij. Në këtë gjendje populli është sikur vendos vetë ligje në parlament. Nga këto që kemi shkruajtur, si përfundim del kjo: Ka dy grupe njerëzish: Të zgjedhurit dhe zgjedhësit (ata që drejtohen).

Të Zgjedhurit

Ai që zgjidhet është parlamentar (deputet). Qëllimi i këtyre njerëzve që zgjidhen, është hyrja në parlament në mënyrë që të bëjnë ligje për njerëzit. Parlamenti është qendra e kufrit dhe ata njerëz që hyjnë aty, pa përjashtim janë qafirë.

Argumentet:

1. Nuk gjykojnë me atë që ka zbritur Allahu

"E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë qafirë."[1] Në shkakun e zbritjes së këtij ajeti përmenden dy transmetime:

1. Ehli kitabi personat që bënin zina i dënonte me rexhm.[2] Më vonë kur filluan ta bëjnë edhe të pasurit këtë punë, sollën dënimin e lyerjes së fytyrave me bojë të zezë dhe gjuajtjen me shkop. Kur u shtua zinaja thanë që; të gjejmë një dënim që ta praktikojmë edhe për të pasurit edhe për të varfërit. Dhe për shkak të kësaj zbritën këto ajete.

2. Përsëri një ndryshim të ngjashëm si ky e bënë në fidjen (shpagimin) e një personi të vrarë dhe për shkak të kësaj zbritën këto ajete.

Ata edhe pse nuk e mohuan librin, vetëm për shkak se bënë një ndryshim të lehtë në një ligj nga libri i Allahut, Ai ata i quajti qafirë. Ndërsa parlamentarët e sotëm, janë duke i ndryshuar plotësisht ligjet e librit.

Dyshim: Disa thonë që ky ajet ka zbritur rreth ehli kitabit, kështu që nuk na lidh neve!

Përgjigje: Në usulu tefsir ka një rregull të tillë: *"Mësimi është në fjalën e përgjithshme e jo në shkakun e zbritjes"*. Ky është një rregull mbi të cilin kanë rënë dakort të gjithë dijetarët. Po i njëjti dyshim, kur u përmend në kohën e sahabëve, Hudhejfe

1. *5/Maide, 44*
2. *Rexhmi është dënim me gurëzim ndaj zinaqares dhe zinaqarit të cilët janë të martuar. (shënim i përkthyesit)*

(radijAll-llahu anh) tha kështu: *"Sa mirë! Të gjitha të këqijat ehli kitabit, ndërsa të gjitha të mirat neve"*. Nëse ne i ndajmë ajetet duke thënë se këto zbritën për këtë e ato për atë, nuk mbeten më tepër se 100 ajete.

Dyshim: Disa të tjerë duke marrë ajetet 44-45-47 të sures Maide thonë se ata që nuk gjykojnë me atë që ka zbritur Allahu ndonjëherë bëhen qafirë, ndonjëherë dhalimë (zullumqarë) dhe ndonjëherë fasikë (të dalë nga rruga).

Përgjigje: Fjalët zullum dhe fisk në Kur'an, përdoren në kuptimin shirk dhe kufër. Lukmani (alejhis-selam) tha: *"S'ka dyshim se shirku është zullum i madh"*. Allahu Teala në shumë vende në Kur'an duke thënë që *"Allahu nuk e udhëzon popullin zullumqar, nuk e udhëzon popullin fasik"* qafirët i ka cilësuar si dhalimë dhe fasikë. Domethënë se përdorimi i zullumit dhe fiskut në Kur'an është dy llojesh:

- Kufër në kuptimin që e nxjerr personin nga feja
- Dhe në kuptimin që nuk e nxjerr personin nga feja

Kur i mbledhim në një vend ajetet në lidhje me ligjvënien, shohim se qëllimi është kufër në kuptimin që e nxjerr personin nga feja.

Dyshim: Disa të tjerë thonë që: *"Nëse personi nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu duke e mohuar atë, ai bëhet qafir. Nëse e pranon, por nuk i zbaton ligjet e Allahut për shkak të disa shkaqeve, ai nuk bëhet qafir"*. Edhe disa dijetarë kanë thënë disa fjalë të ngjashme me këto në tefsirin e ajetit 44 të sures Maide.

Përgjigje: Nga dhahiri i ajetit, kuptohet se ai që nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu është qafir. Ndërsa ky komentim që është sjellë, nuk ka asnjë bazë dhe është një vesvese e shejtanit. Madje kur edhe fjala e sahabëve nuk mund ta ndryshojë një kuptim që e ka vendosur Kur'ani, si mundet që ta ndryshojë një fjalë e pa bazë?

Në shkakun e zbritjes së ajetit, çifutët nuk e kishin mohuar

ligjin e Allahut. Kishin gjetur një dënim të përbashkët që ta zbatonin edhe mbi të pasurit edhe mbi të varfërit. Allahu Teala kur ia bën njerëzve tekfirin në Kur'an, merr për bazë fjalët që ata thonë dhe veprat që ata bëjnë. Mohimi ngaqë është një mesele që ka të bëjë me zemrën, nuk na lidh neve të cilët gjykojmë sipas dhahirit (anës së jashtme).

"E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: "Ne vetëm jemi mahnitur e dëfryer". Thuaj: "A me Allahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni? Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi që besuat, mohuat."[3]

Në këtë ajet, Allahu Teala atyre i ka bërë tekfirin me një fjalë të hapur. Përshembull, dijetarët Islam kanë rënë në ixhma se ai person që shan të shenjtën bëhet qafir, edhe pse nuk e mohon atë. Dhe kjo gjë na tregon neve se kur ndodh një vepër, ose fjalë kufri, nuk shikohet tek mohimi.

Siç kaloi edhe më parë që kufri ndahet në disa lloje. Dhe kufri i mohimit është vetëm njëri nga llojet e kufrit. Përshembull, shejtani nuk e mohoi Allahun. Vetëm se nuk solli në vend urdhërin e Allahut bëni sexhde Ademit. Ndërsa Allahu Teala tha për shejtanin se *"Ai u tregua mendjemadh dhe u bë nga qafirët".* Lloji i kufrit të shejtanit nuk është mohimi, por mendjemadhësia. Disa prej mushrikëve të Mekës (si Ebu Talibi) e pranonin që pejgamberi thoshte të vërtetën, por nuk e ndiqnin atë për shkak të imitimit të fesë së prindërve të tyre.

Shënim: Tek Ehli Sunneti imani është; fjalë, vepër dhe itikad (besim). Ndërsa kufri që është e kundërta e imanit bëhet me fjalë, vepër dhe me itikad. Sipas bidatxhinjëve të devijuar, imani ngaqë është vetëm besim me zemër, edhe kufri që është e kundërta e imanit, është me mohim. Ky është shkaku kryesor i ihtilafit. Argumentet dhe përgjigjet e kësaj kaluan në pjesën e imanit dhe kufrit.

Imam Ahmedi dhe Humejdi kur dëgjojnë se *"ata të cilët nuk*

3. *9/Teube, 65-66*

bëjnë vepra duke mos i mohuar ato, ose duke i pranuar ato, por bëjnë vepra kundër urdhrave të Allahut, janë muslimanë" thanë që "Ky është një kufër i qartë." Këtë mendim e kanë përmendur djali i Imam Ahmedit në librin e titulluar Sunnet dhe Ibn Tejmijje në fetvatë e tij.

Dyshim: Transmetohet se Ibn Abbasi për këtë ajet ka thënë: *"është kufër që nuk është kufër"* (kufrun dune kufër). Pra, është kufër që nuk e nxjerr personin nga feja.

Përgjigje:

1. Ky transmetim nuk është i saktë. Në zinxhirin e këtij transmetimi është një ravi (transmetues) i dobët me emrin Hisham ibn Huxhejr.

2. Edhe sikur ta pranojmë se është i saktë, Ibn Abbasi nuk e ka thënë këtë fjalë si tefsir të ajetit. Ibn Abbasi e ka thënë këtë koment kur Havarixhët me këtë ajet i thanë Aliut (radijAllllahu anh) qafir.

3. Edhe sikur ta pranojmë si të saktë këtë, a është argument fjala e sahabëve? Dijetarët kanë rënë në ihtilaf në këtë temë. Dijetarët që thonë se fjalët e sahabëve janë argument, kanë vendosur dy kushte:

- Nuk duhet të jetë në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin.

- Nuk duhet të jetë në kundërshtim me fjalën e ndonjë sahabiu tjetër.

Ky koment që transmetohet nga Ibn Abbasi është në kundërshtim me ajetin. Veçanërisht, Ibn Mes'udi ka thënë se në këtë ajet është për qëllim kufri. Dhe vecanërisht në transmetime të tjera të sakta, vjen se edhe Ibn Abbasi ka thënë se është kufër.

2. Janë qafirë sepse bëjnë ligje

Kompetenca e bërjes së ligjeve i takon vetëm Allahut. Kjo është njëra nga cilësitë që duhet të njësohet Allahu. Kur'ani në suren Jusuf tek ajeti 40, e ka përcaktur këtë duke thënë se *"S'ka dyshim që gjykimi i takon vetëm Allahut",* dhe duke tërhequr vëmendjen se veçoria këtu, nuk është një veçori e thjeshtë dhe ai që e kundërshton këtë del nga feja Islame, e ka përforcuar me ajetin *"Ai nuk ka ortak në gjykimin e Tij".* Për atë person që i bën shok Allahut në gjykimin e Tij, ose për ata që vendosin ligje, Kur'ani duke iu drejtuar atyre se *"Mos vallë ata kanë ortakë që bëjnë kanune në çështjet që Allahu nuk i ka dhënë leje?"* ka lajmëruar se ata që bëjnë ligje janë rrab (zot).

3. Këto parlamente ndryshojnë ligjet e Allahut

"Ata i konsideruan "ahbarët" (priftër jehudi) të tyre, "ruhbanët" (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos All-llahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj All-llahut një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë."[4]

"Kur Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) e lexoi këtë ajet, erdhi Adij ibn Hatemi me një kryq argjendi të varur në qafë, i cili në periudhën e xhahilijes ishte i krishterë dhe tha: "ata nuk i adhuruan rabinët dhe murgjit e tyre". Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i tha: "Drejtuesit e tyre të fesë ia bënë atyre hallallin haram dhe haramin hallall, ndërsa ata i pasuan ata në këtë. Ky pra është adhurimi që i bënë ata atyre."[5]

Ata që i ndryshuan ligjet e Allahut ishin dijetarët kristianë. Normalisht, Ai që ia jep kompetencën e ixhtihadit dijetarëve, është po Allahu. Megjithë këtë, dijetarët nuk kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në ligjet e Allahut. Allahu ka thënë se ata i morën për *"rrab/zota"* ata. Ndërsa tani, ata që e bëjnë këtë

4. *9/Teube, 31*
5. *Tirmidhiu*

punë janë liderët e partive, të cilëve nuk u është dhënë në asnjë mënyrë kjo kompetencë. Gjendjen e këtyre mendojeni ju.

"E shtyrja (e një muaji në vend të një tjetri) nuk është tjetër vetëm se një rritje e kufrit."[6] Në muajt që ka caktuar Allahu, madje edhe sikur vetëm një ditë të ndryshosh duke mos e mohuar, është rritje në kufër. Vallë të bësh ndryshim në të gjitha ligjet çështë?

4. Këto parlamente janë vende në të cilat ajetet e Allahut merren në tallje dhe mohohen

"Juve u është shpallur në librin (Kur'anin) që, kur të dëgjoni se po mohoen ajetet e Allahut dhe po bëhet tallje me to, mos rrini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata."[7]

Ky ajet është argument i qartë për ata persona që rrinë duke mos kundërshtuar në një vend ku ajetet e Allahut merren në tallje dhe mohohen, se janë në një gjykim me ata që e bëjnë këtë kufër. Në këtë temë dijetarët janë të një mendimi. Nuk ka ndryshim ndërmjet atij që e bën veprën dhe atij që tregon pëlqim. E ndejtura e atij personi në atë mexhlis, do të thotë pëlqim ndaj saj. Sidomos nëse ka hyrë në atë mjedis me dëshirën e tij, është përgjegjës për të gjitha veprat që bëhen aty.

Qëllimi i ndërtimit të parlamenteve të sotëm është mohimi i fesë. Çdo person që ka sado pak logjikë, e di që njerëzit që hyjnë në parlament nuk mund t'i kundërshtojnë dot ato gjëra që bëhen aty.

5. Këta gjykohen tek një shtet më lart

Çdo shtet për problemet e përgjithshme, gjykohet tek ata të cilët i dëgjohet fjala në botë siç është NATO, OKB'ja, SHBA'ja etj.

"A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë ta-

6. *9/Teube, 37*
7. *4/Nisa, 140*

guti, e duke qenë se janë të urdhëruar që të mos e besojnë atë. E shejtani dëshiron t'i humbë në pafundësi."[8]

"Për çdo send që nuk pajtoheni, gjykimi për të është te All-llahu. Ai (gjykatësi i famshëm) është All-llahu, Zoti im, vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm Atij i drejtohem."[9]

Siç theksohet edhe në ajet se të gjykuarit në kanune të tjera përveç kanuneve të Allahut dhe të Rrasulullahut, është kufër. Ata të parlamentit janë edhe tagutë ngaqë bëjnë kanune vetë, janë edhe qafirë ngaqë gjykohen tek kanunet e të tjerëve.

6. Këta i marrin qafirat për miq

Miqësimi i qafirave, dhënia e mbështetjes ndaj tyre është kufër. [10]

8. *4/Nisa, 60*
9. *42/Shura, 10*
10. *Kjo temë do të shqyrtohet në pjesën Uela dhe Bera.*

Ata Që Drejtohen

Ata të cilët drejtohen në sistemet demokratike duke u përzier tek zgjedhjet, marrin pjesë në udhëheqje. Prandaj njerëzve që zgjidhen, u thuhet deputet (përfaqësues) i popullit dhe vendi që këta mblidhen, i thuhet kuvendi i popullit. Të gjitha ajetet që shkruajtëm në temën e mëparshme, janë të vlefshme edhe për ata të cilët votojnë, sepse ai që i jep ndonjërit të drejtën e përfaqësimit, është përgjegjës për të gjitha gjërat që bën personi i cili mori të drejtën e përfaqësimit.

Dyshimet E Përgjithshme

Dyshimi 1. Sot muxhadeleja (përpjekja) bëhet vetëm me politikë. Dhe rruga e kësaj, është hyrja në parlament.

Përgjigja: Allahu Teala siç ka përcaktuar bazat e kësaj feje, po ashtu ka përcaktuar edhe bazat e të jetuarit, edhe bazat e përhapjes së kësaj feje. Muxhadeleja në Islam ka tre grada.

a. Davet (thirrje)

b. Përgatitje

c. Xhihad

Këto grada janë të vërtetuara me nass (ajet dhe hadith). Të gjitha metodat përveç kësaj, janë prodhim dëshirash.

"Pastaj, Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë."[1] Ky ajet është argument se të gjitha rrugët përveç rrugës që ka përcaktuar sheriati, janë rrugë dëshirash. Veçanërisht, edhe në periudhën që erdhi pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) kishte mundësi që të bënte muxhadele me rrugën e parlamentit. Edhe pse e ftuan pejgamberin dhe i propozuan një udhëheqje absolute, pejgamberi ynë nuk e pranoi një gjë të tillë.

Allahu azze ue xhel-le në Kur'an dhe pejgamberi (sal-lAll-

1. *45/Xhathije, 18*

llahu alejhi ue sel-lem) në Sunnet, vazhdimisht japin urdhëra që mundësojnë ndarjen e muslimanit me qafirin nga njëri-tjetri.

▪ Allahu e ka ndarë emrin e muslimanit me të qafirit nga njëri-tjetri.

▪ Vendin që ata do të shkojnë e ka ndarë si Xhennet dhe Xhehennem.

▪ I ka ndarë ata në veshje.

▪ I ka ndarë vendet e tyre duke i urdhëruar muslimanëve hixhretin (emigrimin).

▪ I ka urdhëruar muslimanëve xhihadin duke ia ka zhdukur qafirave të drejtën e të jetuarit.

Metoda e përpjekjes me politikë dhe parlament, nuk është e përfshirë në asnjërën nga këto pika që ne rradhitëm.

Dyshimi 2. Puna që ne bëjmë edhe pse është në kundërshti me nassin, është maslahati që është nga argumentet e sheriatit. Ne veprojmë me maslahatin (pra, shohim dëmin dhe dobinë, shënim i përkthyesit).

Përgjigja: Maslahati është i diskutueshëm se a është një argument sheriatik apo jo. Shumica e dijetarëve nuk e kanë pranuar maslahatin si një argument sheriatik, ndërsa dijetarët që e pranojnë, e ndajnë në tre pjesë:

1. Maslahatin që e pranon Allahu (ajo që është e përshtatshme me nassin).

2. Maslahatin që e refuzon Allahu (ajo që është në kundërshti me nassin).

3. Maslahatin që sheriati as nuk e refuzon e as nuk e pranon (maslahati mbi të cilin nuk ka nass).

I gjithë ummeti është në një mendim se me pjesën e dytë

nuk veprohet. Ndërsa kur arrijmë tek pjesa e tretë, ata që e pranojnë këtë kanë vendosur tre kushte për të vepruar me të:

- Nuk duhet të jetë në kundërshtim me nassin.
- Maslahati duhet të jetë kat'i (i prerë, i qartë).
- Maslahati duhet të jetë umumi (që të përfshijë të gjithë ummetin).

Kur shqyrtohen tekstet të cilat i dhamë më parë, shihet se parlamentet përfshihen në pjesën e teksteve ndaluese. Pra në pjesën e maslahatit të refuzuar.

Madje edhe sikur t'i vlerësojmë parlamentet në pjesën e maslahatit mbi të cilin nuk ka nass, përsëri dalim në konkluzionin se nuk lejohet hyrja në këto vende, sepse për të vepruar me një maslahat të tillë, nuk realizohet as edhe një kusht nga kushtet e domosdoshme të këtij maslahati.

Rezultatet që dalin nga hyrja në këto vende, janë të gjitha në kundërshti me nassin. Si për shembull; të mirën dhe të keqen ta lësh në zgjedhjen e njerëzve, të betohesh në ligjet e kushtetutës, të punosh së bashku me armiqtë e Allahut, t'i lejosh ligjet për të cilat Allahu nuk ka dhënë leje si shkak të shumicës së parlamentit...

Mos të harrojmë se sot në këtë shtet (pra në Turqi shënim i përkthyesit) të gjitha shtëpiat publike, fabrikat e prodhimit të alkoolit dhe kumari (lojërat e fatit), zbatohen nga ana e një partie islamike (!).

Veçanërisht ky maslahat nuk është kat'i / i prerë / i qartë. Ihvanët e Egjiptit u rrëzuan me një grusht shteti, me dhjetëra mijë njerëz u shkatërruan për hir të demokracisë. Shembujt si Algjeria dhe Erbakani i kemi akoma të gjalla në mendjet tona.

Ky nuk është një maslahat umumi. Disa njerëz përfitojnë prej kësaj, ndërsa shumë njerëz dëmtohen. Është interesante se në Turqi, periudha në të cilën muslimanët janë arrestuar

më së shumti dhe në të cilën kanë marrë dënime të larta, është periudha e AKP-së (partia e Erdoanit, shënim i përkthyesit).

Dyshimi 3. Në periudhën e pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) Nexhashiu pranoi Islamin dhe vazhdoi mbretërinë, dhe nuk gjykoi me ligjet e Islamit. Megjithë këtë, pejgamberi ynë i fali namazin e xhenazesë atij.

Përgjigja:

▪ Nexhashiu pasi e pranoi Islamin, atij nuk i mbërriti asnjë ligj i Islamit. Abdullah ibn Mes'udi thotë se pasi u kthyem nga Etiopia, kur pejgamberi po falte namaz i dhamë selam siç i jepnim edhe më parë. Këtë herë ai nuk e mori selamin tonë dhe tha: *"namazi është preukopim."* [2]

Ky hadith tregon se madje edhe kushtet e namazit i cili falet pesë herë në ditë, për shkak të pamundësisë, nuk kanë mbërritur në Etiopi. Nuk është e mundur që njeriu të gjykojë me gjëra që nuk i di.

▪ Në burimet e historisë nuk ka ndonjë informacion rreth Nexhashiut që tregon se ai ka gjykuar me ligjet e Allahut apo që nuk ka gjykuar me ligjet e Tij. Të thuash se Nexhashiu nuk ka gjykuar me ligjet e Allahut, është të shkosh pas asaj njohurie që nuk e di. Dhe këtë Allahu e ka ndaluar. [3]

Dyshimi 4. Jusufi (alejhis-selam) punoi si ministër pranë Faraonit qafir.

Përgjigja:

a. Të flasësh rreth një pejgamberi pa dituri dhe ti mveshësh atij një vepër e cila pranohet si kufër, me ixhmanë e dijetarëve është kufër.

b. Mbi Jusufin (alejhis-selam) janë hedhur dy shpifje: Shpifja e zinasë nga gruaja e mbretit dhe shpifja se nuk ka gjykuar me atë që ka zbritur Allahu nga partiakët.

2. *Buhari*
3. *17/Shih Isra, 36*

c. Jusufi (alejhis-selam) është një pejgamber nga pejgamberët. Thirrja e të gjithë pejgamberëve është sqaruar në këtë ajet: *"Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë "Adhuroni vetëm Allahun dhe largohuni nga taguti."*[4]

Edhe detyra e Jusufit (alejhis-selam) është si detyra e pejgamberëve të tjerë, që t'i thërrasin njerëzit që të largohen nga taguti. Siç e shohim tek ajeti 60 i sures Nisa që njëra nga kuptimet e tagutit, është ai që nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu. Sipas mendimit partiak, Jusufi (alejhis-selam) nuk e ka sjellë detyrën e tij në vend, përkundrazi ai e ka kundërshtuar mesazhin hyjnor. Në vend të largimit nga taguti, ai ka marrë vend pranë tij. Kështu që partiakët kanë dy rrugë; ose do e pranojnë mbretin si musliman që ta shpëtojnë Jusufin (alejhis-selam) nga kjo shpifje dhe ta braktisin këtë shirk, ose duke vazhduar në këtë shirk do të pranojnë një ajet nga Kur'ani dhe do të mohojnë një ajet tjetër të tij.

Shënim: Imam Neveviu, Muxhahidi dhe dijetarët e tjerë, janë të mendimit se mbreti ka qenë musliman. *"Sepse kur e shikojmë Kur'anin, në përgjithësi udhëheqësit kanë dalë kundër thirrjes së pejgamberëve dhe i kanë kërcënuar ata.*[5] *Mbreti i kohës së Jusufit (alejhis-selam) u soll mirë ndaj Jusufit, madje i dha detyrë atij. Dhe kjo tregon se mbreti ka qenë musliman*". Sigurisht që këto janë vetëm një gjasë. Por komentimet e imamllarëve, janë më të mira nga interesat e partiakëve. Në fakt, një pejgamber që i thotë njerëzve qysh në burg se *"gjykimi i takon vetëm Allahut",* nuk mund të mendohet që ky pejgamber mos t'ia shpjegojë meselenë kur të përballet me atë njeri që e ka rrëmbyer gjykimin, gjë e cila duhet shpjeguar me patjetër.

E (mbreti) pasi bisedoi me të tha: *"Tash ti ke tek ne pozitë dhe je i besueshëm."*[6] Ky është argument se Jusufi (alejhis-selam) foli gjatë me mbretin dhe se atij iu dha detyrë. (folja 'kel-leme' që kalon në ajet, vjen në kuptimin bisedë e gjatë).

4. *16/Nahl, 36*
5. *7/A'raf, 88, 14/Ibrahim, 113*
6. *12/Jusuf, 54*

Pyetja e cila duhet shtruar këtu është se çfarë bisedoi Jusufi (alejhis-selam) kaq gjatë? Një pejgamber, detyra e të cilit është shpjegimi i Islamit njerëzve, një pejgamber si Jusufi (alejhis-selam) i cili nuk e braktisi detyrën e thirrjes së njerëzve për tek Allahu edhe në kushtet më të vështira (pra në burg, shënim i përkthyesit), sigurisht që në atë bisedë me mbretin i ka shpjeguar atij teuhidin.

Në ajetin 54 të cilin e përmendëm më lart, thuhet se mbreti u soll mirë me atë dhe i dha pozitë atij. Kur shqyrtohet Kur'ani, shihet në një mënyrë të qartë ky realitet: Udhëheqësit kur përballen me këtë davet, i kundërshtojnë thirrësit, i kërcënojnë, ngrihen për t'i vrarë dhe nuk sillen mirë apo t'i japin poste. Dhe kjo e përforcon gjasën se mbreti i kohës së Jusufit (alejhis-selam) është ndryshe dhe se u bë musliman. Edhe transmetimet e tjera të ngjarjes aludojnë në këtë të vërtetë:

Në ajetin 56 të sures Jusuf thuhet se: *"Dhe kështu Ne Jusufit i dhamë pozitë në vend (në Egjipt). Ai lëvizte ku të dëshironte". Pjesa e vijëzuar e ajetit, tregon se Jusufi (alejhis-selam) nuk ecte sipas ligjeve të mbretit, por lëvizte atje si të dëshironte. Një argument tjetër i kësaj, është ajeti 76 i sures Jusuf: "Sipas ligjit të mbretit, atij (Jusufit) nuk i takonte ta ndalte (peng) vëllain e vet".*

Në këtë ajet theksohet qartë se Jusufi (alejhis-selam) nuk ka vepruar me sheriatin e mbretit. Atëherë me çfarë ka gjykuar? Me sheriatin e Jakubit (alejhis-selam).... Sepse dënimi i vjedhësit në sheriatin e tij, ishte që të merrej peng përkundrejt gjësë që vidhte.

Allahu Teala thotë kështu:

"E kur i pajisi ata me pajimet e tyre, e vuri tasin (gotën) në barrën e vëllait të vet, e pastaj një thirrës thirri: "O ju devexhinj, ju jeni vjedhës!" U kthyen (devexhinjtë) dhe thanë: "Çka keni humbur?" (shërbëtorët e sundimtarit) Thanë: "Kemi humbur tasin e sunduesit, e kush e sjell atë (tasin), ka (shpërblim) një barrë deveje (drith). Unë vetë jam për këtë garantues!" Ata (vëllezërit e Jusufit) thanë: "Pasha All-llahun, ju e dini se ne nuk kemi

ardhur për të bërë shkatërrime në tokë dhe nuk jemi vjedhës!" (shërbëtorët) Thanë: "Nëse jeni gënjeshtarë, çfarë duhet të jetë ndëshkimi i atij (që ka vjedhur)?" (vëllezërit) Thanë: "Dënimi i tij është, vetë ai (të robërohet) në barrën e të cilit gjendet. Kështu ne i dënojmë të padrejtit!"[7]

Dyshimi 5. Njerëzit të cilët e bëjnë këtë punë janë injorantë. Kështu që për shkak se janë injorantë nuk bëhet tekfiri mbi ata.

Përgjigja:

a. Përgjigjen e këtij dyshimi, e shpjeguam në kapitullin e xhehlit (injorancës) në mënyrë të përgjithshme.

b. Ligjvënia është një mesele me të cilën interesohet teuhidi. Është farz ajn për të gjithë që ta mësojnë. Në vendet që ka mbërritur Kur'ani dhe Sunneti, asnjë njeri nuk është i arsyetuar në meselet që kanë të bëjnë me farzin ajn. Këtyre nuk u thuhet xhahil (injorant), por u thuhet mu'rid (ata që ia kthejnë shpinën fesë së Allahut). Dhe ky është një kufër më vete. Këto ajete janë argument për këtë:

"Po çka kishin ata që largoheshin prej Kur'anit? Ata ishin si gomerë të egër. Që ikin prej luanit (ose prej gjahtarit)."[8]

"Kush është më zullumqar se ai që është këshilluar me argumentet e Zotit të vet, e ua kthen shpinën atyre."[9]

c. Xhahil (injorant) është ai person që nuk ka dije rreth çështjes. Ndërsa për personat të cilët bëhet fjalë këtu, kur flitet për fe i sheh ata se kanë dije rreth maslahatit, Nexhashiut, ndodhisë së Jusufit (alejhis-selam), shkencës së usulit dhe tefsirit.

Dyshimi 6. Këta janë ehli te'uil. Kështu që nuk bëhet tekfiri mbi ehli te'uilin.

7. *12/Jusuf, 70-75*
8. *74/Muddeth-thir, 49-51*
9. *18/Kehf, 57*

Përgjigja:

a. Ç'do të thotë te'uil? Te'uili është t'i japësh kuptim tjetër një nassi dhahir duke u bazuar në ndonjë nass tjetër.

Siç kuptohet edhe nga përkufizimi, te'uili duhet të bazohet në nass. Nëse bazohet në nass i thuhet te'uil sahih (i saktë). Nëse nuk bazohet në nass, i thuhet te'uil fasid (i prishur). Siç kaloi edhe në temat e mëparshme që partiakët nuk kanë asnjë argument të saktë ku të bazohen. Dhe të thuash se ehli te'uili është i arsyetuar, nuk lejohet, sepse çdo gabimtar në rruzullin tokësor, e bazon gabimin e tij në ndonjë argument.

b. Në meselet që kanë të bëjnë me bazat e fesë, te'uili nuk është i vlefshëm. Përshembull; ata që nuk dhanë zekatin duke i bërë te'uil ajetit 103 të sures Teube ku thotë *"Merr prej pasurisë së tyre zekatin"* thanë që *"zekati i jepet pejgamberit"*, sepse në vazhdim të ajetit thuhet *"që t'i pastrosh me të dhe t'u shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta"*. Dhe thanë që këto cilësi, janë vetëm për pejgamberin. Ndërsa Ebu Bekri (radijAll-llahu anh) dhe sahabët (radijAll-llahu anhum) nuk e pranuan këtë. Të mendojmë, megjithëse ata u bazuan në një ajet të hapur nga pikëpamja e jashtme në meselenë e zekatit, sahabët i shpallën ata persona murtedë. Po gjendja e atyre personave që nuk kanë as edhe një argument, si i bëhet vallë?

c. Për të qenë te'uili i vlefshëm duhet që të ketë këto kushte:

1. Nuk duhet të jetë në kundërshtim me nasset e qarta të fesë.

2. Ai që bën te'uil duhet të jetë dijetar.

3. Duhet të përshtatet me gjuhën arabe.

4. Rezultati që del, nuk duhet të bie në kundërshtim me asnjë nass (ajet dhe hadith).

Dyshimi 7. Po të themi kështu, i bie që shumica të jenë qafirë!

Përgjigja: Në Islam kur Allahu e urdhëron ose e ndalon diçka, ai urdhër ose zbatohet, ose shihet se a ka leje apo jo në atë

çështje. Nëse ka leje në atë çështje, ai që dëshiron e zbaton atë urdhër dhe ai që nuk dëshiron nuk e zbaton. Përveç kësaj, çfarëdo lloj kushtesh qofshin, kush i shkel kufijt e Allahut, sipas shkeljes së kufirit bëhet ose qafir, ose fasik. Vlera e numrit nuk ka asnjë ndikim në qëndrueshmërinë e ligjeve. Vlera e numrit nuk është e rëndësishme në Islam, por në demokraci.

a. Kundërshtimi i shumicës nuk ndikon tek ligjet. *"E Musai tha: "Nëse ju, dhe të gjithë ata që janë në tokë bëni kufër, Allahu është i panevojshëm (për falënderim), i lavdishëm (vetvetiu)."* [10]

b. Allahu Teala në Kur'an lajmëron se shumica i kundërshton urdhrat e Allahut. *"Në qoftë se u bindesh shumicës, ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut."* [11]

"Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun, vetëm se duke i bërë shok Atij." [12]

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Ebu Hurajra dhe siç transmetohet nga librat e historisë, se me vdekjen e pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) disa u kthyen nga feja duke i besuar pejgamberit gënjeshtar, disa duke mos dhënë zekat dhe disa duke thënë se Muhammedi vdiq. Raporti i atyre që u kthyen, krahasim me raportin e atyre që qëndruan, është 90%.

Dyshimi 8. Madje edhe sikur të jenë qafirë këta, çfarë përfitojmë ne me tekfirin ndaj tyre?

Përgjigja: Tekfiri është një dispozitë e sheriatit. Në rastet kur plotësohen kushtet dhe ngrihen pengesat, duhet bërë tekfir.

Ne, kur bëjmë tekfir, nuk bëjmë tekfir me qëllim përfitimi. Qëllimi është që të zbatojmë urdhrin e Allahut. Kjo është e vlefshme për tekfirin e njerëzve normalë. Nëse personi ka ardhur në gradën e tagutit, tekfiri ndaj këtij është kusht për hyrjen e personit në Islam.

10. *14/Ibrahim, 8*
11. *6/En'am, 116*
12. *12/Jusuf, 106*

Kur shikojmë Kur'anin në kuptim të përgjithshëm, Allahu i ka ndarë njerëzit mu'min-qafir dhe i ka sqaruar në një mënyrë të detajuar të gjitha veçoritë e të dy grupeve. Njerëzit të cilët i posedojnë këto veçori, i ka emërtuar me emra të qartë. Shkaku më i rëndësishëm i kësaj është që besimtarët t'i dinë veçoritë, emrat e kësaj rruge dhe t'i dinë dispozitat që përbëhen bashkë me këto emra dhe të jetojnë sipas kësaj. Nëse kjo do të ishte diçka e pavlefshme, Allahu Teala nuk do t'i përmendte në Librin e Tij.

Ndërsa kur shikojmë Sunnetin, pejgamberi i ka shpjeguar njerëzve teuhidin, dhe ka sqaruar emrat dhe dispozitat e atyre që e kanë kundërshtuar teuhidin. Shembulli më i qartë për këtë, është surja Kafirun. Shkaku që i nxehte më shumë mushrikët dhe që i bënte ata që t'i sulmonin muslimanët, ishte thënia se prindërit e tyre janë në Xhehennem dhe poshtërimi i putave të tyre. Para se të vinte pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), në Mekë kishte njerëz që e jetonin teuhidin të cilët njiheshin si Hanifë, mirëpo ata asnjëherë nuk vuajtën. Shkaku i kësaj, është ngaqë pejgamberi i sqaroi në një mënyrë të hapur emrat dhe dispozitat e mushrikëve.

Bërja e një personi qafir ose musliman ndryshon në veshje, ngrënie, pirje, në mënyrën e të folurit, në mënyrën e të ecurit në rrugë dhe në shumë dispozita të tjera. Për shembull:

- Bindja ndaj udhëheqësit musliman është farz, ndërsa kryengritja ndaj udhëheqësit qafir dhe rrëzimi nga posti i tij -sipas mundësive- është farz.

- Dhënia e zekatit ndaj udhëheqësit musliman është farz, ndërsa dhënia e taksës me dëshirë ndaj udhëheqësit qafir është kufër.

- Është haram që muslimani t'i ngjajë qafirit në veshje.

- Varrezat e muslimanëve me të qafirëve janë të ndara.

- Muslimani nuk e përdor enën e qafirit, përveçse kur ka ne-

vojë. Nëse nuk gjen ndonjë enë tjetër, e merr atë enë dhe e përdor pasi ta lajë.

- Muslimani nëse gjen pasuri në një vend ku jetojnë muslimanët, duhet që t'ia kthejë pronarit, nëse pronari është qafir, është ganimet (plaçkë lufte). [13]

- Muslimani as nuk i merr e as nuk i jep vajzë qafirit.

Në një çështje ku ka kaq shumë ndryshime dhe kaq shumë dispozita, personit i cili thotë *"çfarë përfitojmë duke thënë qafir"* mund t'i themi që *"ti mos thuaj kot më kot qafir, sepse nuk je përgjegjës, nuk përfiton ndonjë gjë."*

13. *Kjo pasuri nuk quhet ganimet, sepse ganimeti merret me anë të luftës, por kjo pasuri mund të quhet fej, pra pasuri e cila merret pa luftë. (shënim i përkthyesit)*

Mıqësıa Dhe Armıqësıa (Uela Dhe Berra)

Allahu e ka përcaktuar në Kur'an në një mënyrë të detajuar, se kë duhet të marrin muslimanët për miq dhe se kë duhet të kenë armiq. Në vitet e para kur erdhi Islami, lidhjet e miqësisë dhe armiqësisë së njerëzve, ishin të ndërtuara në; fis, kushëri, rracë dhe në lidhje të ngjashme. Islami i refuzoi të gjitha këto dhe i emërtoi si xhahilije (injorancë). Në vend të këtyre, solli sistemin e vet. Lidhja e vetme e miqësisë në Islam është imani, ndërsa lidhja e vetme e armiqësisë është kufri. Në këtë pikë lidhjet e fisit dhe të rracës, nuk kanë asnjë vlerë.

Miqësia në arabisht kalon si *"uela"* e cila vjen në kuptimin; të duash, të ndihmosh, të kesh respekt, të ndjekësh etj. Kuptimi më i qartë brenda këtyre është; dashuria dhe ndihma. Ndërsa armiqësia në arabisht kalon si *"berra"* e cila vjen në kuptimin; të braktisësh diçka, të qëndrosh larg saj, të kesh urrejtje ndaj saj dhe ta armiqësosh.

Në uela dhe berra ka edhe kuptime dhahirije (të dukshme) edhe kuptime batinije (të fshehta). Përshembull, të ndihmosh është dhahirije, ndërsa të dashurosh është batinije. Të braktisësh diçka është dhahirije, ndërsa të urresh diçka është batinije. Islami asnjëherë nuk përcakton ndonjë dispozitë sipas batinijes. Të gjitha dispozitat i përcakton sipas dhahirijes. Dhe tema që do të shqyrtojmë ne këtu është ana e dhahirijes e cila na intereson neve në lidhje me çështjen.

Miqtë të cilët duhet t'i zënë besimtarët

Në ajet thuhet: *"Mik i juaji është vetëm Allahu, është i dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zekatin duke bërë ruku' (duke qenë respektues). E kush ka për mik Allahun, të dërguarin e Tij dhe ata që besuan, s'ka dyshim se ana (pala-krahu) e Allahut është ngadhënjyese."*[1]

Dhe në një ajet tjetër thuhet: *"Muhammedi është i dërguar i*

1. *5/Maide, 55-56*

Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve e janë të mëshirshëm ndërmjet vete."[2]

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në hadith thotë që *"Kushërinjtë e mi nga babai im, nuk janë miqtë e mi. Miqtë e mi, janë vetëm besimtarët vepërmirë."*[3]

Ajetet dhe hadithi që përmendëm janë dëshmia më e madhe që tregon se në Islam, lidhja e miqësisë dhe armiqësisë është e bazuar vetëm në iman. Allahu Teala pasi e përcakton këtë lidhje, e ndalon miqësimin me qafirat. Normalisht, urdhërimi i diçkaje, në të njëjtën kohë është edhe ndalimi i të kundërtës së saj. Por për rëndësinë e çështjes, veçanërisht kanë ardhur tekste që përmbajnë ndalesë.

Në ajet thuhet: *"Besimtarët të mos i miqësojnë mosbesimtarët, e t'i lënë anash besimtarët. E kush e bën atë, ai nga feja e Allahut nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. Allahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm tek Allahu është e ardhmja."*[4]

Në një ajet tjetër thuhet: *"O ju që besuat, mos i zini miq jobesimtarët e t'i lini mënjanë besimtarët! A doni t'i sillni Allahut argument të qartë kundër vetes!"*[5]

Grada e ndalimit të miqësimit të qafirave

Kur Allahu e ndalon diçka, ajo ndalesë ndahet në tre pjesë; mekruh, haram dhe kufër. Gjëja që ndalon, nëse hyn tek pjesa e parë dhe e dytë, nuk e nxjerr personin nga feja, por bëhet shkak që personi të bie në fisk (gjynah) dhe t'i pakësohet imani. Nëse gjëja që ndalon është kufër, e nxjerr personin nga feja. Miqësimi i qafirave është kufër, argumenti i kësaj është ky ajet:

"E kush e bën atë, ai nga feja e Allahut nuk ka asgjë."[6]

2. *48/Fet'h, 29*
3. *Buhari*
4. *3/Ali Imran, 28*
5. *4/Nisa, 144*
6. *3/Ali Imran, 28*

Në një ajet tjetër thuhet: *"Ti (Muhammed) lajmëroji munafikët se me të vërtetë ata kanë një dënim të dhembshëm. Të cilët përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë dinjitet te ta? S'ka dyshim, i tërë dinjiteti i takon Allahut."*[7] Në këtë ajet është theksuar se ata që i miqësojnë qafirat janë munafikë.

"O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit."[8]

"Sikur ata vërtet të besonin Allahun, pejgamberin dhe atë që i zbriti atij, nuk do t'i zinin për miq ata (idhujtarët), por shumica prej tyre janë fasikë."[9]

Këto ajete janë argumente shumë të rëndësishme për bazën e miqësisë dhe armiqësisë. Nëse një person i miqëson qafirat dhe bashkë me këtë pretendon se ka besuar, imani i këtij personi është i pavlefshëm. Sepse Allahu ka thënë se "Sikur ata vërtet të besonin Allahun nuk do t'i zinin për miq ata". Një gjë e ngjashme me këtë, është përmendur edhe në ajetin 22 të sures Muxhadele: *"Nuk gjen popull që e beson Allahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që e armiqëson Allahun dhe të dërguarin e Tij."*

Shkaku i ndalimit në miqësimin e qafirave

Zoti ynë i cili e ka ndaluar miqësimin e qafirave, urtësitë e kësaj i ka theksuar në ajete të ndryshme.

"As ata, ithtarët e librit që nuk besuan, e as idhujtarët nuk duan që juve t'ju vijë ndonjë e mirë nga Zoti juaj. Mirëpo, All-llahu me mëshirën e vet veçon atë që dëshiron, All-llahu është Zot i mirësisë së madhe."[10]

Miqësimi me bashkësi të cilat nuk duan mirësi dhe dobi për muslimanët, përfundon në dëm të muslimanëve. Historia është dëshmitarja më e mirë për këtë gjendje. Duke qenë në

7. *4/Nisa, 138-139*
8. *5/Maide, 51*
9. *5/Maide, 81*
10. *2/Bakara, 105*

krye Osmallinjtë, shumë shtete si rezultat i aleancës që bënë me qafirat, ishin të detyruara që të shembeshin.

"O ju që besuat, mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, ata nuk pushojnë së vepruari në dëm tuajin, u dëshirojnë çka u mundon juve. Urrejta kundër jush duket nga gojët e tyre, por ajo që fshehin në gjoksat tyre është edhe më e madhe. Ne pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni. Ja, ju (muslimanë) jeni që i doni ata, e ata nuk u duan juve. Madje ju i besoni librat në tërësi (të gjitha shpalljet), e kur ju takojnë thonë: "Ne kemi besuar"! E kur veçohen, ata nga mllefi kundër jush grisin majet e gishtërinjve. Thuaju: "Vdisni me atë mllef tuajin"! All-llahu e di shumë mirë se çka mbajnë (të fshehtat) zemrat e tyre. Nëse ju përjetoni ndonjë të mirë, ata i dëshpëron ajo, e nëse ju godet ndonjë e keqe, ata gëzohen për atë. Po, në qoftë se ju bëheni të durueshëm dhe ruheni (mëkateve), dinakëria e tyre nuk do t'u dëmtojë aspak. Është e sigurt se All-llahu e ka në dorë atë që punojnë ata." [11]

Në një ajet tjetër, kjo urtësi theksohet kështu:

"Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmujë e madhe në tokë." [12]

Ata me veprat e tyre të këqija duke qenë në krye shirku, janë duke bërë shumë të zeza në tokë dhe në det, janë duke e prishur ekuilibrin e universit i cili i bën ibadet Allahut me çdo gjë të tijën.

"Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat). Thuaj: "Ecni nëpër tokë dhe shikoni se si ishte përfundimi i atyre që ishin më parë, shumica e tyre ishin jobesimtarë." [13]

11. *3/Ali Imran, 118-120*
12. *8/Enfal, 73*
13. *30/Rrum, 41-42*

Duhet ndaluar dhe larguar dëmi i njerëzve të cilët bëjnë kaq shumë dëme me shirkun e gjynahet e tyre ndaj muslimanëve dhe krijesave të tjera që jetojnë në tokë e në det. Ndërsa ata të cilët i miqësojnë qafirat, janë duke i ndihmuar ata në vazhdën e këtij dëmi dhe shkatërrimi.

Shkaqet që i shtyjnë njerëzit që t'i miqësojnë qafirat

Në Kur'an ata që i miqësojnë qafirat, janë njerëz me karakter munafiku. Munafiku ngaqë nuk beson, vazhdimisht mundohet për interesin e vet. Prandaj mundohet që ta sigurojë veten edhe pranë besimtarëve edhe pranë qafirave. Në ajet thuhet se *"Ata janë të luhatshëm ndërmjet atij (besimit) dhe atij (mosbesimit) e nuk janë as me ata (me besimtarët) as me ata (me jobesimtarët). Po atë që e mposht Allahu, ti nuk mund të gjesh shpëtim për të."* [14]

Gjatë gjithë historisë njerëzit, interesaxhinjtë që zgjedhin jetën e dynjasë ndaj jetës së ahiretit, kanë marrë për miq qafirat. Dhe në këtë mënyrë kanë humbur edhe dynjanë edhe ahiretin. Në ajet thuhet se *"E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh se nga rendin tek ta (për miqësi) duke thënë: "Po frikësohemi se mos po na sillet ndonjë e keqe."* [15] Në këtë ajet, Allahu Teala thekson se ata i miqësojnë qafirat për shkak se kanë frikë. Kur nuk stabilizohet frika ndaj Allahut në zemër, zemra fillon të frikësohet nga çdo gjë që është në univers. Dhe kjo frikë sipas llojit të saj, e shtyn njeriun që të veprojë ato gjëra që i ka ndaluar Allahu.

Në ajet [16] Allahu pasi lajmëron miqësimin e munafikëve me qafirat, sqaron edhe njërin nga shkaqet e miqësimit me qafirat duke thënë se *"a mos kërkojnë dinjitet tek ta."* Mu'mini i beson Allahut dhe jetën e tij e rregullon sipas emrave dhe cilësive të Tij. Njeriu i cili i beson Allahut i cili është Aziz (ngadhënjyes), e ndjen veten aziz (të lartë) dhe nuk e ndjen nevojën

14. *4/ Nisa, 143*
15. 5/Maide, 52
16. *4/Nisa 138-139*

që të kërkojë izzet (dinjitet) në ndonjë vend tjetër. Ai e di që Islami është dinjiteti i tij. Dhe ky është njëri nga faktorët që e ka bërë të virtytshme periudhën e sahabëve. Shumë sahabë kanë thënë: *"Ne ishim të poshtëruar, Allahu na lartësoi. Nëse ne e kërkojmë dinjitetin diku tjetër përveç Islamit, Allahu na poshtëron përsëri."*

Ndërsa munafiku dhe qafiri ngaqë nuk besojnë, nuk e ndjejnë këtë dinjitet dhe e kërkojnë burimin e dinjitetit (diku tjetër). Sot po ta mendojmë këtë ajet dhe mendimin partiak, partiakët për të nxjerrë në pah fjalën e muslimanëve, shfaqen si miq të sistemit të cilin edhe vetë e pranojnë se është sistem kufri. Ndërsa shkaku i kësaj, është ngaqë nuk i kanë besuar Allahut i cili është Aziz.

Mënyrat më të qarta të miqësisë së ndaluar

Të shkosh ushtar tek ushtritë e tagutit

Kur bëmë përkufizimin e miqësisë, thamë se veçoria më e qartë bashkë me dashurinë është ndihmesa. Dashuria ngaqë ka të bëjë me zemrën, është ndërmjet personit dhe Allahut. Ndërsa dispozitat e dynjasë, gjithmonë jepen sipas pamjes së jashtme. Nëse një person i ndihmon qafirat (me dorë, me pasuri, me gjuhë), madje edhe sikur të thotë që unë nuk i dua këta, nuk ka asnjë rëndësi. Sepse ndihmesa që ai i bën, është miqësia më e madhe. Gjendja e një personi në një ushtri e cila ka për qëllim të mbajë kufrin në këmbë dhe të luftojë me Islamin, është shenjë që tregon se ai i ka miqësuar ata. Allahu në Kur'an në përgjithësi thotë se marrja e qafirave për miq, është kufër. Ai që bën ushtrinë, sipas këtyre nasseve bie në kufër. Bashkë me këtë, të qenurit bashkë me qafirat, të marrësh pjesë në ushtritë e tyre, Allahu përsëri kësaj gjendje i thotë kufër.

Në ajet thuhet se *"Ata që besuan luftojnë në rrugë të Allahut, e ata që nuk besuan luftojnë në rrugë të tagutit. Luftoni pra miqtë e shejtanit, s'ka dyshim se intriga e shejtanit është e dobët."*[17] Ky ajet

17. *4/Nisa, 76*

tregon në një mënyrë të qartë se në pikëpamjen e Islamit, janë dy rrugë dhe se ata që luftojnë në këto dy rrugë, kanë emra të ndryshëm nga njëri-tjetri. Ata që luftojnë në rrugë të Allahut janë besimtarë, ndërsa ata që luftojnë në rrugë të tagutit janë qafira. Ky ajet pasi vendos këtë dispozitë të përgjithshme, në Kur'an dhe Sunnet ka argumente në lidhje me këtë se kjo kështu është edhe në praktikë.

Faraoni dhe ushtarët e tij: Allahu Teala në Kur'an thotë se Faraoni e shtypte popullin e tij dhe e grupëzonte. Edhe pse Faraoni e detyronte popullin e tij në punë të ndryshme, Allahu nuk e ndau në asnjë mënyrë atë nga ushtarët e tij.

"Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kokën lart në tokë, e popullin e saj e grupëzonte dhe një grup prej tyre e shtyp që t'i dobësojë. Prandaj djemt e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve."[18]

Ky ajet tregon se koha jonë është e njëjtë me kohën e Faraonit. Faraonët të cilëve u janë ndryshuar emrat, i ndajnë njerëzit në rraca, në zona në mënyrë që t'i dobësojnë. Që më vonë duke përfituar nga pafuqia e tyre, i përdorin ata në punë të përshtatshme për interesat e tyre. Dhe në krye të kësaj, në kohën më të prodhimshme të jetës së njerëzve, vjen shkuarja në ushtri. Kështu që ndërmjet kohës tonë dhe kohës së Faraonit, nuk ka ndonjë ndryshim.

Nëse do t'i ktheheshim Kur'anit:

"Vërtet, Faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre ishin në gabim."[19] Ajeti gabimin nuk ia ka mveshur vetëm Faraonit, por edhe ushtarëve. Ky është argument se ushtarët mblidhen nën emrin e njëjtë me institucionin që përbëjnë ushtrinë.

"Dhe Faraonit, Hamanit dhe ushtrisë së këtyre dyve donim që t'ua tregojmë atë që i ruheshin (ia kishin frikën)."[20] Allahu në

18. *28/Kasas, 4*
19. *28/Kasas, 8*
20. *28/Kasas, 6*

këtë ajet, Faraonin dhe ushtarët e tij nuk i ka ndarë nga njëri-tjetri nga kërcënimi.

"Ne e kapëm atë dhe ushtrinë e tij dhe e hodhëm në det."[21] Allahu Teala në këtë ajet, nuk e ka ndarë Faraonin dhe ushtrinë e tij nga njëri-tjetri kur i shkatërroi.

"Dhe ata i bëmë prijësa që thërrasin për në zjarr dhe në ditën e kijametit atyre nuk do t'u ndihmohet. Edhe në këtë botë i kemi përcjellë ata me mallkim, kurse në ditën e kijametit ata janë të përbuzur."[22]

Ky ajet është argument se edhe në ahiret Faraoni dhe ushtarët e tij do të kenë të njëjtin dënim.

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) akiden që e shpjeguam në mësimet e mëparshme, e ka zbatuar në praktikë. Kur pejgamberi emigroi, disa njerëz duke mos patur arsyetim, nuk emigruan dhe qëndruan në Mekë. Në ditën e Bedrit, mushrikët i morën në luftë me dhunë këta persona dhe i futën në rreshtat e tyre. Këta persona ngaqë e dinin se grupi përballë ishte musliman, nuk luftuan. Shigjetat dhe gjërat e ngjashme që vinin nga muslimanët, binin mbi këta dhe vdiqën. Rreth këtyre personave zbriti ajeti 97 i sures Nisa. Këtë ndodhi Buhariu e transmeton nga Ibn Abbasi.

"Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetes iu thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të paaftë në atë tokë!" (engjëjt) iu thanë: "A nuk ishte e gjërë toka e Allahut e të migronit në të?". Vendi i tyre është Xhehennemi dhe sa vend i keq është ai!"[23]

Në ushtrinë e kufrit, njerëzit të cilët nuk i dhanë asnjë ndihmë atyre dhe që ishin çuar atje me dhunë, u bënë pjesë e këtij ajeti. Ata i thanë engjëjve arsyetimet e njëjta me të kohës tonë. I thanë që ne ishim mustadaf. Mustadaf do të thotë që ishim

21. 28/Kasas, 40
22. 28/Kasas, 41-42
23. 4/Nisa, 97

të paaftë, të dobët që nuk kishim mundësi dhe rrugëzgjidhje. Por engjëjt nuk ia pranuan arsyetimet.

Po në të njëjtën mënyrë, në ditën e Bedrit kur pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) e kapi si rob xhaxhain e tij, Abbasin u soll ndaj tij siç u soll ndaj mushrikëve. Kur Abbasi pretendoi se unë jam musliman, pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i tha *"Mirëpo ti nga pamja e jashtme ishe kundër nesh. Kështu që do të japësh shpagim si të gjithë mushrikët e tjerë."* Këto dy ngjarje tregojnë këto dy pika që janë shumë të rëndësishme në lidhje me temën:

Pretendimi i çdo personi që thotë *"Unë jam i paaftë, jam në ikrah (në imponim, jam i detyruar)"* nuk është i vlefshëm. Edhe sahabët gjetën arsyetime për veten e tyre, por arsyetimet e tyre nuk u pranuan.

Njeriu, nëse nga pamja e jashtme është në një gjendje, edhe sikur ta mohojë këtë gjendje me gjuhë, nuk merret për bazë ajo që thotë me gjuhë, por merret për bazë gjendja në të cilën ai ndodhet. Kjo mbështet edhe rregullin që dijetarët janë të një mendimi duke u bazuar në shumë nasse që "Dispozita jepet sipas pamjes së jashtme".

Dyshime në lidhje me meselenë e ushtrisë

Dyshimi 1. Allahu Teala në ajetin 28 të sures Ali Imran thotë kështu: *"Besimtarët të mos i miqësojnë mosbesimtarët, e t'i lënë anash besimtarët. E kush e bën atë, ai nga feja e Allahut nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. Allahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm tek Allahu është e ardhmja."*

Allahu Teala në ajet pasi e ndalon miqësinë me qafirat thotë që *"përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre."* Thonë që në rast frike qafirat mund të merren për miq.

Përgjigja: Kur sqaruam miqësinë dhe armiqësinë, prekëm një pikë të tillë; në ajetin 52 të sures Maide ata të cilët thanë *"Po frikësohemi se mos po na sillet ndonjë e keqe"* frika e atyre që i miqësuan qafirat nuk u arsyetua, dispozita u zbatua edhe mbi ata. Kur shqyrtohet një temë, mblidhen të gjitha nasset rreth temës dhe nxirret një rezultat. Përndryshe personi bëhet pjesë e dispozitës së ajetit 7 të sures Ali Imran ku thotë *"E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar fitne."* Kur merren dy ajete njëherësh në mes del ky rezultat; çdo frikë nuk është arsyetim që të miqësohen qafirat. Kur shikojmë tefsirin që i kanë bërë selefët ajetit 28 të sures Ali Imran, tema kuptohet më qartë. Në lidhje me takijje'n [1] që kalon në ajet, ka dy mendime:

- Kjo dispozitë është anulluar.

- Kjo dispozitë është e vlefshme deri në kijamet dhe ky është mendimi i saktë.

Ibn Abbasi thotë që: *"Takijje' ja bëhet me fjalë. Të vrasësh një njeri dhe të bësh gjynah nuk është takijje."* Ibn Abbasi me këtë fjalë sqaron se takijje'ja e ligjshme është vetëm me fjalë dhe se vepra nuk është e përfshirë në të. Personi për t'u mbrojtur

1. *Takijje dmth; fshehja e besimit. (shënim i përkthyesit).*

nga qafirat, mund të sillet i butë ndaj tyre me fjalë. Por të bëjë vepra që janë të ndaluara, të marrë pjesë në ushtritë e tyre, t'i mbështesë ata, këto nuk janë të përfshira në ajet.

Shënimi 1: Dijetarët që kanë folur për takijjen kanë tërhequr vëmendjen në një pikë të tillë: takijjeja është një leje e përkohshme. Por ata të cilët e kanë keqkuptuar takijjen, kufrin e miqësisë dhe armiqësisë, e kanë bërë në çdo fushë të jetesës së tyre nën emrin e takijjes.

Shënimi 2: Takijje'ja është arsyetim për personat të cilët nuk kanë mundësi të arratisen nga qafirat. Ai person që shkon me dëshirë brenda qafirave të cilët detyrojnë për kufër, ai person që ka mundësi të arratiset dhe nuk arratiset, ai që e dorëzon veten e vet me duart e tij tek qafirat, këta lloj njerëzish nuk janë të arsyetur.

Shënimi 3: Është theksuar shumë hapur në ajetin 98 të sures Nisa se kujt i pranohet arsyetimi: *"Përveç atyre që ishin të paaftë nga burrat, gratë e fëmijët që nuk kishin mundësi të gjenin, as mënyrë, as rrugë (për emigrim). Atyre do t'ia falë Allahu. Allahu është që shlyen e fal shumë (gabime)."*

Shënimi 4: Ata që e marrin takijjen si argument të cilët e shesin fenë plotësisht, janë njerëz interesantë. Nëse i thoni ndonjërit bëj zina ose pi alkool duke bërë takijje, dalin kundra rreptësisht dhe thonë që kjo gjë është haram. Ndërsa në meselet që e kanë kufrin e hapur siç është kufri i ushtrisë, veprojnë shumë lirshëm me takijje. Shkaku i kësaj është humbja e rëndësisë së meseleve të imanit dhe kufrit me përhapjen e mendimit të irxhasë (murrxhiave). Kur nuk shpjegohet imani-kufri, emrat dhe dispozitat, kjo gjë në syrin e njerëzve shihet si e parëndësishme. Në emër të fesë ngaqë flitet vetëm për haramet, njerëzit në këtë temë janë mjaft të ndjeshëm. Thirrësat Islam duhet të sjellin në rendin e ditës meseletë e imanit dhe kufrit të cilat janë më shumë ndikuese në jetën e përjetshme të njerëzve.

Dyshimi 2. Pasuesit e dyshimit thonë që *"Ushtria është kufër, ne nuk shkojmë në ushtri me dëshirë, jemi në ikrah. Në Turqi ushtria është e detyruar, ai që nuk shkon e dënojnë, kështu që kjo hyn tek ikrahu."*

Përgjigja: *"Ai që pas besimit të tij e mohon Allahun, me përjashtim të atij që është në ikrah (dhunohet për të mohuar), e zemra e tij është e bindur plotësisht me besim, por fjala është për atë që ia hap gjoksin mosbesimit, ata i ka kapur hidhërimi nga Allahu dhe ata kanë një dënim të madh."*[2]

Ky ajet është ajeti i ikrahut. Sipas tefsireve, nëna dhe babai i Ammar ibn Jasirit ranë shehid si përfundim i dhunimit. Ndërsa Ammari u torturua derisa filloi të zvarritej në tokë. Mushrikët i thanë që të pohonte mosbesimin. Ai nuk duroi dot ndaj torturave dhe pohoi me gojë mosbesimin. Pastaj Ammari erdhi tek pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) duke qarë, i tregoi rastin, e pejgamberi e pyeti: *"Si e kishe zemrën o Ammar?"* Ai i tha *"plot iman."* Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i tha *"shko, nëse të ndodh përsëri, ti prap vepro ashtu."*

Shkaku i zbritjes së ajetit të ikrahut është siç kaloi më lart. Nuk ka ndonjë problem në ajetin që kanë sjellë pasuesit e dyshimit, mirëpo vendi që kanë përdorur dhe ndodhia që kanë përdorur, është plotësisht e shkëputur nga ajeti dhe nga shkaku i zbritjes së ajetit. Ndryshimet ndërmjet këtij ajeti dhe gjendjes sonë:

Ammari (radijAll-llahu anh) e ka përdorur këtë leje, kur ishte i lidhur dhe duke u torturuar nga dora e mushrikëve. Ndërsa njerëzit e sotëm, janë njerëz që e marrin çantën në dorë dhe dorëzohen vetë.

Ikrahu në kuptimin gjuhësor dhe sheriatik është; ta detyrosh një person të bëjë diçka që ai nuk e do. Gjendja e njerëzve të cilët shkojnë vetë në ushtri, nuk ka asnjë lidhje me ikrahun, as në kuptim gjuhësor, e as në kuptim sheriatik.

2. *16/Nahl, 106*

Njerëzit të cilëve u ishte dhënë leja e ikrahut, nuk ishin urdhëruar akoma me hixhret. Pasi u urdhëruan me hixhret, Allahu nuk arsyetoi asnjë përveç të moshuarëve, grave dhe fëmijëve. [3]

Dijetarët Islam, kanë përmendur disa kushte për ikrahun që të jetë një arsyetim i vlefshëm dhe që mos ta fusë personin në kufër. Disa prej këtyre kushteve edhe pse janë me ihtilaf, në përgjithësi kushtet për të cilat kanë rënë dakort janë këto:

Ai që bën ikrahun (ai që e detyron personin për të bërë kufër) duhet të jetë i fuqishëm.

Personi i cili është në ikrah, nuk duhet të ketë asnjë mundësi arratisjeje.

Ai që bën ikrahun -nëse nuk bëhet ajo gjë që ai kërkon- duhet të kërcënojë me jetë, me prerjen e një organi, me burgim të gjatë dhe me gjëra të ngjashme. Gjithashtu duhet të ketë fuqi në çdo mënyrë që ta bëjë atë që kërcënon.

Gjëja që kërcënohet duhet të jetë momentale. Pra duhet të bëhet në atë moment. Përshembull, nëse thotë: *"Nëse nuk e bën këtë, pas një viti do të bëj këtë e atë",* nuk quhet ikrah.

Ai që është nën ikrah duhet të bëjë vetëm aq sa i kërkohet. Përshembull, nëse nga ai (i cili është nën ikrah) kërkohet që të mohojë vetëm Allahun, nuk është ikrah që ai të mohojë edhe Allahun, edhe të dërguarin, edhe fenë.

Nëse i mendojmë ato që kemi shkruar që nga fillimi i temës, shohim se nuk ka as edhe lidhjen më të vogël ndërmjet ajetit të ikrahut me njerëzit që shkojnë vetë në ushtri. Personi i cili mund të flitet në lidhje me ajetin e ikrahut, është ai i cili arratiset për të mos shkuar në ushtri aq sa ka mundësi dhe më pas kapet nga ana e qafirave dhe dërgohet në ushtri. Dhe kjo nuk i jep të drejtën absolute këtij njeriu që të bëjë ç'të dëshirojë. Ato që do të bëjë janë të përkufizuara sipas kushteve të ikrahut.

3. *4/Nisa, 97-98*

Dyshimi 3. Ndodhia e Hatib ibn Ebi Belta's:

Para çlirimit të Mekës, Hatibi shkruan një letër dhe ia jep një robëreshe që t'ia dërgojë Mekasve, në të lajmëron se pejgamberi do të vijë për në Mekë. Allahu Teala e lajmëron pejgamberin (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) për këtë gjendje. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) dërgon Aliun dhe Zubejrin (radijAll-llahu anhuma) pas gruas që kishte letrën. Letra doli nga gërshetat e saj. Kur ata erdhën tek pejgamberi me letrën, Umeri (radijAll-llahu anh) thotë: *"O i dërguari i Allahut, a t'ia heq kokën këtij munafikut."* Ndërsa pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë: *"Përse e bëre diçka të tillë o Hatib?"* Hatibi thotë që: *"Uallahi, nuk e bëra për të hyrë në kufër, për të treguar kënaqësi ndaj kufrit dhe për t'u bërë murted."* Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë: *"Bëni ç'të doni o ehli Bedër, s'ka dyshim se Allahu ju ka falur juve."*

Ata që e sjellin si argument këtë ndodhi, thonë që personi përderisa nuk e do kufrin dhe nuk tregon kënaqësi ndaj tij, nëse i miqëson qafirat për shkak të ndonjë rroge dynjaje dhe për shkaqe të ngjashme, nuk bëhet qafir.

Përgjigja:

Ajo që bëri Hatibi është kufër. Kur Umeri (radijAll-llahu anh) tha *"s'ka dyshim se ky u bë munafik. A t'ia heq kokën këtij munafikut"* pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) nuk tha gjë që *"Jo, ai nuk është munafik."* Pyeti vetëm për ta vërtetuar ngjarjen. Dhe vetë Hatibi kur u pyet nga pejgamberi, tha që unë nuk e bëra këtë për të hyrë në kufër. Kjo do të thotë se dihet nga të gjithë që vepra është kufër.

Ata të cilët e marrin si argument këtë ndodhi, në përgjithësi thonë se ata njerëz që bëjnë ushtri me lekë dhe bëhen policë, bëjnë gabim, por nuk u bëhet tekfiri këtyre.

Të krahasosh policin dhe ushtarin me Hatibin, është sikur të marrësh patentë nga kasapi. Hatibi vetëm një herë të vetme i shkruajti një letër qafirave nga krahu i muslimanëve pa marrë

pjesë në safin e qafirave, ndërsa polici dhe ushtari merr pjesë në safin e tyre një jetë të tërë, e i mbrojnë ligjet e kufrit dhe shirkut. Argumentet në lidhje me punën që bën polici dhe ushtari, i përmendëm në mësimet e kaluara se puna e tyre është kufër i hapur.

Që të jetë kijasi sahih, duhet që të mos ketë ndonjë nass në lidhje rreth çështjes. Këtyre kijaseve të tilla, u thuhet kijas fasid (i prishur). Ndodhia e Hatibit mund të jetë argument duke u krahasuar me këtë: Një musliman vetëm një herë të vetme mund t'i japë dije qafirave pa dalë nga safi i muslimanëve. E shumta, mund të merret për argument se nuk mund të bëhet menjëherë tekfir mbi atë që bën diçka të tillë.

Islami gjithmonë gjykon sipas pamjes së jashtme. Pejgamberi tha për Hatibin se është fjalë drjetë ngaqë i erdhi shpallje. Sot nuk ka njeri që të ketë një të drejtë të tillë, për shkak se nuk i vjen asnjë njeriu shpallje. Të gjithë janë të detyruar të gjykojnë sipas pamjes së jashtme. Edhe pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në gjendjen kur nuk i ka ardhur shpallje, i ka gjykuar njerëzit sipas pamjes së jashtme. Tek Buhariu, Umeri (radijAll-llahu anh) ka tërhequr vëmendjen në këtë pikë kështu: *"O ju njerëz, në kohën e pejgamberit të gjithë gjykoheshin me shpallje, por sot shpallja u ndërpre. Kush bën mirë, gjykohet me të mirë, e kush bën keq, gjykohet me të keqe, edhe sikur brendia ime të thotë mirë!"*

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) e pyeti Hatibin dhe e gjykoi atë. Sepse ai kishte mundësi ta gjykonte atë. Kësaj në jurisprudencën Islame i thonë *"makdur alejhi"* që vjen në kuptimin ka mundësi ndaj tij. Një person i cili jeton nën mbizotërimin e muslimanëve të cilin mund ta gjykojnë muslimanët, kur bën një gabim nuk mund të ndërhyjë njeri përveç halifes dhe gjykatësit që ka caktuar halifja. Pas gjykimit, dispozita jepet sipas sheriatit. Ka dhe *"mumteni"*, pra, njerëz që muslimanët nuk kanë mundësi t'i gjykojnë. Mbi këta njerëz, mund të bëhet tekfiri pa i gjykuar dhe pa i marrë në pyetje.

Hatibi ishte në pozitën makdur alejhi. Ndërsa polici, ushtari i sotëm është në dispozitën e mumteniut.

Ta mbështesësh qafirin me gjuhë

Njerëzit siç e marrin fuqinë nga ushtritë, po ashtu e marrin edhe nga politika, mediat dhe nga institucione të ngjashme. Sidomos në periudhën e luftës së ftohtë, populli merret nën kontroll duke përdorur institucionet që ndikojnë tek ai siç është edukimi, feja, media etj. Një person i cili lavdëron me gjuhë, ose me laps sistemet tagutije, ose një besim kufri, ai ka marrë vend pranë tyre dhe i ka marrë për miq ata. Veçanërisht në këtë pjesë përfshihen nëpunësit fetarë zyrtarë, gazetarët etj. Në Kur'an kalon se qafirat nuk kanë bërë armiqësi vetëm me luftë, por kanë bërë armiqësi edhe me propaganda, dyshime dhe me metoda të tjera në mënyrë që t'i kthenin muslimanët nga besimi i tyre.

Shënim 1: Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i ka falur shumë herë ata të cilët e kanë armiqësuar me shpatë. Ndërsa ata të cilët e kanë armiqësuar me gjuhë, ata të cilët kanë bërë propagandë kundër tij, nuk i ka falur. Kjo tregon se lufta që bëhet me gjuhë (këtu përfshihet edhe shkrimi) është akoma më e ashpër. Përshembull, pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) Kaab bin Eshrefit i bëri atentat, Abdullah ibn Ebi Serhi i cili u bë murted pasi ishte katibi (shkruajtësi) i uahjit, shkon në Mekë dhe bën propagandë kundër tij, pejgamberi për të thotë që *"Vriteni atë edhe sikur ta gjeni të mbështjellur pas mbulesës së Qabes."*

Armiqësitë që bëhen në luftë, janë të përkohshme. Ndërsa propaganda që bëhet me gjuhë, është e qëndrueshme.

Shënim 2: Në përgjithësi në botë, veçanërisht në gjeografinë tonë armiqtë më të mëdhenj të teuhidit janë ata që flasin gjuhën tonë, ata që kanë të njëjtën ngjyrë si ne të cilët populli i njeh si hoxhallarë, ata që marrin post pranë sistemeve ta-

gutije, ata që kanë titullin dijetar, ata të cilët me emërtimin e Kur'anit janë gomerë që mbartin libra.

Ky problem nuk ka ndodhur vetëm në umetin tonë, por edhe në umetet e kaluara. Allahu Teala në shumë vende në Kur'an, ka tërhequr vëmendjen se rabinët dhe priftërinjtë kanë devijuar dhe bashkë me këtë edhe njerëzit kanë dalë nga feja duke iu bindur atyre. Përsëri Allahu Teala ka tërhequr vëmendjen se jo çdo kush që di, është alim (dijetar), gjithashtu ka tërhequr vëmendjen se ka njerëz që duke e ditur hakun, nuk veprojnë me të. Kur shikojmë në gjeografinë tonë, shohim se njerëzve itikadi i kufrit dhe i shirkut i mbërrin nga ana e imamllarëve zyrtar të shtetit, ose nga ana e teologëve. Më të mirët prej këtyreve, janë ata që heshtin. Madje edhe heshtja e tyre bën efekt negativ tek populli dhe e bën të ligjshme kufrin dhe shirkun.

Baza e sistemeve tagutije, për shkak se është e mbështetur në adhurimin e njeriut nga njeriu, tagutët për të legjitimuar vetet e tyre, përdorin strukturën e vlerës më të rëndësishme të popullit. Sistemi tagutik i Republikës së Turqisë, është i njohur me laicitetin e tij dhe me armiqësinë që ka ndaj fesë. Aq sa edhe shaminë e kokës të cilën e mbajnë vajzat, shami e cila nuk ka asnjë lidhje me fenë Islame (për shkak se nuk ngjason fare me mbulesën që urdhëron Islami, shënim i përkthyesit), ata nuk e durojnë dot.

Bashkë me këtë, lejojnë namazet e xhumasë, disa rite të tjera fetare dhe institucionin e Dijanetit (siç është këtu tek ne kmsh-ja, shënim i përkthyesit) i cili ka nën kontroll këto lloj aktivitetesh që bëhen. Shkaku i kësaj është legjitimimi i veteve të tyre në emër të fesë tek populli i cili e mendon veten e tij se është musliman. Madje edhe duaja që bëjnë klerikët e Dijanetit për shtetin dhe ushtrinë pas ceremonisë zyrtare, e legjitimon shtetin dhe ushtrinë në syrin e popullit. Kjo propagandë që bëhet, lë mbresa tek populli. Një nënë, edhe pse ushtria e pengon shaminë e kokës së vajzës së saj, ajo e dërgon

djalin e saj në ushtri duke e cilësuar ushtrinë si *"preh pejgamberësh."* Prindërit të cilëve i vriten djemtë në ushtrinë e cila i ka hapur luftë fesë në çdo drejtim, ngushëllohen me termin e shehidllëkut në Islam. Në këtë mënyrë ata e bënë popullin laik dhe e demokratizuan me projektin *"fe kundra fesë."* Gjatë historisë, fetë nuk janë prishur nga ana e duarve të jashtme, por janë prishur nga ana e pasuesve të epshit të cilët ia atribuonin veten e tyre fesë. Pauli dëmtoi kristianizmin, dijetarët e këqij dëmtuan hebraizmin, ndërsa sot, fenë Islame e dëmtojnë hoxhallarët të cilët hanë bukë nga bestytnitë, nëpunësit e faljes së namazit të dijanetit dhe akademikët që japin mësime të fesë Islame nëpër universitete.

Disa prej këtyre e fshehin fenë:

"Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruam njerëzve në librin, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë."[4]

Disa anojnë nga dynjaja, ndjekin epshin dhe nuk veprojnë me dijen e tyre që ia ka dhënë Allahu.

"Dhe lexoju atyre tregimin e atij që ia patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre dhe atëherë atë e shoqëroi shejtani dhe kështu ai u bë prej të humburve. E sikur të donim Ne, do ta ngrenim lartë me atë (dituri), por ai nuk iu largua tokës (Dunjasë) dhe shkoi pas epshit të vet. Shembulli i tij është si ai i qenit, të cilin nëse e përzë ai e nxjerr gjuhën, po edhe nëse nuk e përzë, ai sërish e nxjerr gjuhën. Ky është shembulli i atyre që i konsideruan të rreme argumentet Tona. Ti rrëfe tregimet (umetit tënd) në mënyrë që ata të mendojnë."[5]

"Shembulli i atyre që janë obliguar me Tevrat, dhe nuk e zbatojnë atë, është si shembulli i ndonjë gomari që bart libra. Shembull i keq është shembulli i popullit që i përgënjeshtroi ajetet e All-llahut, e All-llahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin jobesimtar."[6]

4. *2/Bakara, 159*
5. *7/A'raf, 175-176*
6. *62/Xhuma, 5*

Disa e përziejnë të vërtetën me të kotën dhe në këtë mënyrë turbullohet qartësia e të vërtetës.

"E mos e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën dhe me vetëdije të fshehni realitetin."[7]

Disa shkruajnë libra me duart e veta dhe ia atribuojnë Allahut duke thënë se *"ky libër m'u dha mua në ëndërr."*

"Është shkatërrim për ata që me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: "Ky është prej All-llahut"! E për të arritur me të një fitim të paktë, pra është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i madh për ta ajo çka fitojnë."[8]

Ta mbështesësh me pasuri:

Mbështetja e qafirave me pasuri për arsye që të forcohen, është nga format më të qarta të kufrit. Veçanërisht, në shekullin tonë pasuria është më ndikuese se forca e njeriut. Në ajet thuhet se *"Ata që nuk besuan, shpenzojnë pasurinë e tyre për të penguar nga rruga e Allahut."*[9] Brenda kësaj është edhe dhënia e taksave ndaj qafirave vullnetarisht, edhe dhënia lëmoshë vullnetarisht tek institucionet që përhapin kufrin etj. Disa mesele që ngatërrohen në këtë:

Tregtia me qafirat: Disa njerëz për shkak të disa gjendjeve që ndodhin në dynja, sidomos gjërat që bëjnë çifutët, duke menduar se tregtia me çifutët hyn brenda miqësisë dhe armiqësisë, kanë shkuar deri në ekstrem.

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij edhe pse ishin armiq me çifutët, bënin tregti me ta. Madje kur pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ndërroi jetë, mburoja e tij ishte peng tek një çifut për shkak të tregtisë. S'ka dyshim se ndjeshmëria e disa njerëzve në këtë pikë, është e mirë. Është shfaqja e shqetësimit me hallin e ummetit, mirëpo

7. 2/Bakara, 42
8. 2/Bakara, 79
9. 8/Enfal, 36

dispozitat që kanë të bëjnë me të tjerët, nuk duhet të bazohen në ndjenja dhe slogane. Patjetër që duhet të ketë një mbështetës sheriatik. Ata njerëz që ecin me këtë logjikë, gjithashtu ata nuk duhet të marrin as mallin e kristianëve. Sepse të gjithë e dimë se firmat amerikane i paguajnë taksa SHBA'së dhe SHBA'ja me të ardhurat e këtyre taksave i gjuan Afganistanit dhe Irakut. Kështu që në shtetin ku jetojmë, markat që tregohen si alternativë janë rekordmen taksash. Ose dhurimet vullnetare që i bëjnë këto marka për sigurimin e shtetit janë shumë ashiqare. Pra, nuk është e mundur që të arrish në një rezultat me kufij të qarta, në meselet që baza nuk bazohet në rregullat sheriatike.

Dialog ndërfetar

Thelbi i kësaj filozofie, është të bësh dialog ndërfetar e cila përmban besimin në Allah dhe besimin në ahiret. Për dialogistët problemi bazë janë teoritë që i emërtojnë si ateistë, mohues dhe me emra të ngjashëm disa prej atyre që nuk e pranojnë besimin në Allah. Që një mendim të bëjë dialog me një mendim tjetër, më parë duhet që ta pranojë ligjshmërinë e tij.

Nuk është e mundur që të bëjmë dialog me njerëzit që ne i cilësojmë si qafirë e banorë të zjarrit. Para se të shqyrtojmë mendimin diaolog ndërfetar, më parë duhet të shqyrtojmë dispozitën e çifutëve dhe kristianëve në Islam, të cilët janë bashkëbisedues të dialogut.

Dispozita e ehli kitabit:

Në ajete thuhet: *"S'ka dyshim se bënë kufër ata që thanë: "Zot është ai, Mesihu bir i Merjemes."* [10]

"S'ka dyshim se bënë kufër ata që thanë: "Allahu është i treti i treve." [11]

"Çifutët thanë: "Dora e Allahut është e shtrënguar!" Qofshin të shtangura duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, pse thanë atë." [12]

10. 5/Maide, 17
11. 5/Maide, 73
12. 5/Maide, 64

Kur'ani Kerim është i mbushur me ajete që tregojnë se ehli kitabi është i mallkuar, se e ka merituar dënimin e Allahut. Para se të vinte pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) edhe pse ka pasur brenda tyre që kanë qenë në Islam, pasi erdhi pejgamberi, Allahu në shumë ajete ka sqaruar duke iu drejtuar atyre se nuk pranohet asnjë fe tjetër përveç fesë që ka sjellë pejgamberi i fundit.

"S'ka dyshim se feja e pranuar tek Allahu është Islami." [13]

"E nëse ata polemizojnë me ty, ti thuaj: "Unë me tërë qenien time i jam dorëzuar Allahut, e edhe ithtarët e mij"! E thuaju edhe atyre që u është dhënë libri dhe injorantëve: "A pranuat fenë islame?" Nëse e pranuan islamin, atëherë e kanë gjetur të vërtetën, e nëse refuzojnë, ti ke për obligim vetëm t'u komunikosh." [14]

"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit." [15]

Këto ajete shprehin haptazi se pas pejgamberit të fundit, këto fe nuk e shpëtojnë njeriun në asnjë mënyrë. Kështu që edhe ehli kitabi është nga grupi i qafirave. Dhe në të gjitha ajetet në lidhje me qafirat përfshihen edhe ata. Xhihadi me qafirat, armiqësimi ndaj tyre, mos lejimi i propagandimit të besimeve të tyre, janë dispozita në lidhje me qafirat. Dialogu me njerëz që janë në këtë gjendje, nga pikëpamja sheriatike është e pamundur. Për të bërë dialog duhet që këto ajete të bësh sikur nuk i sheh. Në realitet kjo është një ndodhi praktike. Dialogistët edhe pse pretendojnë se janë muslimanë, vetëm për të realizuar dialogun e tyre, nuk i përmendin asnjëherë gjithë këto ajete që janë në Kur'an. Nëse do t'i përmendnin këto ajete, edhe sikur të duan këta, grupi përballë nuk do që të hyjë në dialog.

Lloji i mënyrës së veprimit: Në mësimin e mëparshëm, thamë që Kur'ani e shikon ehli kitabin si qafir e të mallkuar.

13. *3/Ali Imran, 19*
14. *3/Ali Imran, 20*
15. *3/Ali Imran, 85*

Siç sillemi me ehli kitabin, po ashtu në të njëjtën mënyrë sillemi edhe me qafirat. Vetëm kur ehli kitabi pranon që të japë xhizje, atyre i jepet e drejta e të jetuarit përkundrejt taksës që paguan. Në ajete thuhet:

"O pejgamber, luftoi jobesimtarët dhe hipokritët dhe sillu rrept ndaj tyre, vendi i tyre është Xhehennemi që është përfundimi më i keq." [16]

"O ju që besuat! Luftoni jobesimtarët që i keni afër jush, e le ta ndiejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre. E dijeni se Allahu është me të devotshmit." [17]

"Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi Allahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri, derisa ta japin xhizjen në dorë e duke qenë të mposhtur." [18]

Islami i jep ehli kitabit të drejtë jetese, derisa ata ta japin xhizjen në dorë e duke qenë të mposhtur. Por rreth kësaj jetese siç thuhet edhe në ajet, bien në çdo lloj poshtërimi. Në hadith thuhet kështu: *"Ehli Kitabit mos i jepni ju të parët selam. Kur të përballeni me ata në rrugë, shtyjini ata në pjesën e ngushtë të rrugës."* Në librat e Fikhut rreth ehli dhimme's janë disa kushte që i ka vendosur Umeri (radijAll-llahu anh) të cilat dihen si *"Kushtet e Umerit"*: Nuk do të vishen si muslimanët, nuk do të vendosin emrat e muslimanëve, nuk do të mbajnë armë, nëpër kisha nuk do të ngrihet zëri i këmbanave dhe zëra adhurimi të ngjashëm, nuk do të flasin me ndonjë gjuhë tjetër vetëm se me gjuhën që flitet në atë zonë dhe kushte të tjera.

Ehli Kitabi që jeton sot, janë të gjithë ushtarakë. Udhëheqësit e tyre i kanë uzurpuar tokat islame, i kanë shpallur luftë haptazi Islamit, ndërsa këta janë të kënaqur me këta udhëheqës.

16. 9/Teube, 73
17. 9/Teube, 123
18. 9/Teube, 29

Ehli Kitabi pasi pranon të japë xhizjen, jetojnë në tokat islame të sigurtë si muslimanët përderisa nuk i tradhtojnë muslimanët. Asnjë person nuk ndërhyn në mallin, nderin e tyre. Nëse një musliman dhunon të drejtat e tyre padrejtësisht, dënohet sipas dënimeve që janë përcaktuar në sheriat. Nëse shqyrtohen librat e kada'së dhe hukmit në shtetet e kaluara islame, do të shihet se ata kanë jetuar të qetë përderisa nuk kanë tradhtuar.

Ata të cilët nuk i bëjnë tekfirin atyre të cilët i përkasin ndonjë feje tjetër përveç Islamit apo atyre të cilët pranojnë besimet bazë të ndonjë feje tjetër, me ixhma janë qafirë. Sepse këta kanë përgënjeshtruar tekstet e qarta të cilat theksojnë kufrin e atyre personave që marrin ndonjë fe tjetër përveç Islamit apo që veprojnë me parime të kundërta me Islamin. Si shembull për këtë mund të tregojmë Hebraizmin, Kristianizmin, demokracinë, komunizmin, laicizmin, humanizmin, shirkun etj.

Ata të cilët prezantohen me këto fe (pra me Hebraizmin, demokracinë etj) ose ata të cilët i pranojnë parimet e besimit të këtyre feve (duke thënë se triniteti është i saktë, se lejohet kërkimi i duasë nga njerëzit e mirë, se sistemi i demokracisë është i përshtatshëm etj.) janë qafirë.

T'i ngjasosh qafirave:

Ngjasimi ndaj qafirave është nga llojet e të bërit miq ata. Ndërsa ajo që është bazë në Islam, është kundërshtimi ndaj qafirave. Njëra nga shkaqet më kryesore të kësaj, është hapja e rrugës së dashurisë dhe pëlqimit në ngjasimin e jashtshëm dhe imitimin e brendshëm. Ndërsa kjo është e ndaluar. Në një hadith të saktë Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë kështu: *"Kush i ngjan një populli ai është prej tyre."*

Shënim: Ky hadith nuk merret dhahiri (sipas kuptimit të jashtëm). Nëse njeriu i ngjan qafirave në gjëra me përmbajtje kufri që janë të posaçme të fesë së tyre, kjo gjë është kufër.

Përshembull si mbajtja e kryqit, veshja e rrobave të tyre fetare, pjesëmarrja në ceremonitë e tyre që simbolizojnë kufrin e tyre etj. Nëse ngjasimi dhe taklidi (imitimi) është në gjëra që nuk është kufër, atëherë është haram. Argumenti i të parës: Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) kur ia pa kryqin në qafë Adij ibn Hatemit i tha që *"hiqe këtë putën (idhullin) nga qafa."* Ndërsa argumenti i të dytës (pra, ngjasimi is ë cilës është haram); është kur Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) pa në një sahab tjetër një rrobë që ai kishte veshur, i thotë që *"kjo është rrobë e qafirave, mos e vish këtë."* Islami që pas ditës që erdhi, e ka bërë sheriatike kundërshtimin ndaj qafirave (sidomos në simbolet fetare). Pejgamberi kur erdhi në Medine, medinasit kishin dy bajrame që i festonin. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) tha që *"S'ka dyshim, se Allahu i ndërroi ato me dy ditë më të mira, me bajramin e kurbanit dhe bajramin e ramazanit."*

Në një hadith tjetër thotë që *"Kundërshtojini çifutët dhe falni namaz me këpucë."* Në një hadith tjetër thotë që *"Kundërshtojini mushrikët, zgjatini mjekrat dhe shkurtojini mustaqet."*

Në një hadith tjetër thotë që *"Ehli Kitabi nuk i lyn mjekrat me këna. Kundërshtojini ata dhe lyjini mjekrat me këna."*

Ka aq shumë hadithe ku pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) urdhëron kundërshtimin e tyre sa që Ehli Kitabi që ndodhej në Medine tha: *"Ky njeri kundërshtoi çdo gjë që gjendej tek ne."*

Shënim: Kundërshtimi ndaj mushrikëve, në çdo mënyrë është i mirë. Veçanërisht kundërshtimi nga brenda gjithmonë është kusht për saktësinë e imanit, ndërsa kundërshtimi nga jashtë më tepër ka të bëjë me forcën. Pejgamberi ynë këtyre gjërave i ka dhënë më tepër rëndësi në Medine sesa në Mekë. Sepse Meka ishte vend dobësie, ndërsa Medineja vend force. Disa nga dijetarët kanë tërhequr vëmendjen në këtë pikë. Ndërsa në kohën tonë gjendja ka ndryshuar shumë. Disa që i kanë kuptuar gabim fetvatë e dijetarëve ngjasojnë me qafi-

rat madje edhe në vende ku nuk përzihet asnjëri me tjetrin, në vende që respektohet mendimi personal dhe si rrjedhojë e kësaj nuk kanë fare tipare islame. Çdo kohë dhe çdo periudhë ka fikhun e vet sipas të sajës. Në këtë kohë përveç atyre të cilëve bëjnë xhihad, që punojnë për maslahatin (dobinë) e muslimanëve, të gjithë duhet të kenë tipare islame. Ndërsa ata muslimanë që do të përdorin ruhsatin (lejen) nuk duhet t'i vendosin përmasat vetë, por duhet të konsultohen me njerëzit e dijes të cilët dinë të ndajnë përmasën e haramit-hallallit, ruhsatit-azimetit (vendosmërisë në mosveprimin e ruhsatit).

Dısa Mesele Në Lıdhje Me Teuhıdın

Rukje

Rukje, është kurimi me ajete kuranore dhe dua (lutje) që kanë ardhur nga sunneti kur personi është në gjendje sëmundje apo në gjendje të ngjashme.

Kjo bëhet duke i fryrë ose duke e prekur me dorë të sëmurin, duke i lexuar disa ajete nga Kur'ani dhe disa dua që i ka lexuar Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Pejgamberi e ka bërë rukjen vetë dhe i ka thënë edhe të tjerëve që ta bëjnë. Në një transmetim të saktë kalon kështu: Një grup prej sahabëve dolën në udhëtim, kur arritën tek një fis arab kërkuan strehim. Ata nuk pranuan që t'i strehonin. Pasi sahabët u nisën të iknin, kryetarin e fisit e pickon një gjarpër. Pjesëtarët e fisit i kërkojnë ndihmë sahabëve. Njëri nga sahabët i bën rukje atij duke i lexuar suren Fatiha përkundrejt disa deleve dhe i sëmuri shërohet. Pasi ia tregojnë ndodhinë pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ai i thotë që delet ndajini midis jush, por më ndani edhe mua një hise".

Përsëri në një transmetim tjetër të saktë, pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i lexonte këtë dua të sëmurëve *"O Allah Ti i cili je Zoti i njerëzve! Largoje vështirësinë, Ti je shërues, nuk ka shërim tjetër përveç shërimit Tënd. Jepi një shërim që mos të ngelë sëmundja"* dhe i fërkonte me dorë. Që pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue s"el-lem) ka bërë kurë me këtë metodë, ka transmetime të sakta dhe të ndryshme.

Kur erdhi Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), në bashkësinë injorante, kishte rukje të cilat i bënin njerëzit. Njëri prej sahabëve e pyet atë: *"O i dërguari i Allahut, ç'mendim ke për rukjet që përdornim para Islamit?"* Ai ia ktheu: *"M'i tregoni rukjet tuaja. Nëse nuk përmbajnë shirk, ato janë të lejuara."*

Ky transmetim na tregon neve se disa lloje rukjesh përmbajnë shirk. Këto janë rukje që bëhet dua në emër tjetër për-

veç Allahut, që përmendet emri i xhindëve e shejtanëve dhe rukjet që ndodhen nëpër librat e magjisë. Të gjithë dijetarët kanë rënë dakort njëzëri në lidhje me lejimin e rukjeve nëse plotësohen tre kushte:

Kurimi që bëhet me rukje, duhet të jetë nga Kur'ani dhe Sunneti:

Kurimi me rukje ose materiali që do të përdoret në kurim, duhet të jetë nga meselet që mbështeten në nass (Kur'an e hadith). Veçanërisht, rukja e cila nuk i dihet se ku e ka burimin, ka shumë mundësi të jetë shirk. Siç e shpjeguam më lartë se magjistarët duke adhuruar xhindët dhe shejtanët, bëjnë rukje me shirk. Prandaj për t'u siguruar prej kësaj, është kusht që rukja të përbëhet nga Kur'ani dhe hadithet.

Gjuha që përdoret, duhet të dihet ose të jetë në gjuhën arabe:

Shkaku i kësaj është që të parandalohen rukjet me përmbajtje shirku që i bëjnë magjistarët të cilat nuk i kupton kush.

Personi të cilit i bëhet rukje, duhet ta dijë se shërimi është nga Allahu e jo nga rukja:

Në bazën e besimit islam është besimi se e mira dhe e keqja vjen vetëm nga Allahu. Allahu Teala siç i ka lejuar disa kurime fizike me anë të mjeksisë, po ashtu ka lejuar edhe kurime shpirtërore me anë të rukjes. Siç duhet të dihet se në kurimin me ilaç, shërimi është nga Allahu, ndërsa ilaçi është vetëm një shkak, po ashtu e njëjtë është edhe puna e rukjes.

Të mbajturit e nuskës, fijes me qëllim mbrojtjeje nga nazari, syri i keq, zilia etj.

Më parë çdo musliman duhet të dijë se e mira dhe e keqja vjen vetëm nga Allahu. Disa dua (lutje) dhe dhikri që bëhen për qëllim mbrojtjeje, bëhen ngaqë Allahu Teala i ka lejuar. Të bësh krahasime batile (të kota), të bësh gjëra shkak mbrojtjeje që Allahu nuk i ka bërë shkak ato, do të thotë t'i kalosh kufijt dhe të flasësh në fenë e Allahut pa ditur. Qenia e disa ajete-

ve dhe haditheve me përmbajtje mbrojtëse, nuk janë gjëra që dihen me mendje dhe që i dihet shkaku, që ti të ngrihesh e t'i krahasosh këto me gjëra të tjera. Veçanërisht pejgamberi ynë ka ndaluar që të varen apo të lidhen gjëra me qëllim mbrojtjeje. Në një çështje ku ka nass të veçantë nuk bëhet kijas (krahasim) duke përdorur mendjen.

Që e mira dhe e keqja vjen nga Allahu: *"Nëse Allahu të godet me ndonjë të keqe, s'ka kush që ta largojë atë pos Tij…",* [1] *"…Nëse Allahu dëshiron ndonjë të mirë ndaj meje, a mund ta pengojnë ata të mirën e Tij?.."* [2]

Gjërat që njerëzit i mbajnë në trupat e tyre dhe që i varin nëpër shtëpiat e tyre me qëllim mbrojtjeje, ose janë ajete dhe hadithe -siç shkruhet ajeti kursij, suret muavidhetejn që njerëzit këtyreve i thonë nuska- ose janë gjëra si patkua e kalit, hudhra etj., që vendosen për t'u mbrojtur nga nazari, syri i keq dhe sëmundjet, pra janë gjëra për të cilat njerëzit besojnë se i mbrojnë. Këto mund të ndryshojnë sipas kohës dhe vendit.

Nuskat që përmbajnë pjesë të Kur'anit dhe hadithit:

A mund të mbahen tekste me ajete të shkruajtura në letër të cilat theksojnë ruajtjen nga shejtanët dhe belatë?

Kjo temë, duke qenë sahabët në krye, është bërë shkak për ihtilaf (kontradiktë) ndërmjet selefëve. Abdullah ibn Amr ibn el-Asi dhe nëna jonë Aishja e kanë lejuar këtë. Ndërsa Ibn Mes'udi, Hudhejfeja dhe sahabët e tjerë e kanë ndaluar këtë. Për shkak të ihtilafit të sahabëve, edhe ata dijetarë që kanë ardhur pas tyre kanë rënë në ihtilaf në këtë çështje. Ajo që parapëlqehet është që të mos mbahet, për shkak të shkaqeve që do t'i rradhisim më poshtë:

Argumentet që ndalojnë varjen e diçkaje ose besimin ndaj diçkaje janë të përgjithshme. Për ta lejuar varjen e gjërave që përmbajnë Kur'an duhet argument. Sepse i dërguari i Allahut

1. *6/En'am, 17*
2. *39/Zumer, 38*

e ka lejuar leximin e këtyre ngaqë janë të nevojshme, por rreth shkrimit dhe varjes së këtyre nuk ka thënë ndonjë gjë.

Të ndalosh gjëra të tilla është Seddu'dh-dherai (t'i mbyllësh rrugët të cilat të shpien në të keqe). Zemra duke iu mbështetur këtyre gjërave, mund ta harrojë Allahun i cili është mbrojtësi. Kur i shqyrtojmë popujt e hershëm shohim se risitë që ata futën në fe, me kalimin e kohës i kanë çuar ata në shirk.

Ata persona që mbajnë gjëra të cilat përmbajnë Kur'an, kur janë të detyruar të hynë në vende si tualeti, kjo gjë është mos-respekt ndaj Kur'anit.

Varja e gjërave që nuk i pranon sheriati si fija, rruaza (kokërr qelqi me një vrimë në mes) etj.:

Në hadith kalon se: *"Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) pa një person që kishte vënë një byzylyk në dorën e tij për shkak të dhimbjes së krahut dhe e pyet se ç'është kjo? Ai i thotë se e vendosa për shkak të dhimbjes së krahut. Rrasulullahu (sallAll-llahu alejhi ue sel-lem) i thotë që: "Hiqe atë. Nëse do të vdisje me të nuk do të shpëtoje kurrë."*[3]

Përsëri në hadith kalon se *"Kush var në qafë temime (gjë të cilës i besohet se të ruan nga hasedi) ose gjëra (që vendosen) për nazar, Allahu mos ia pruftë punët mbarë."*[4]

Në një transmetim tjetër Hudhejfe (radijAll-llahu anh) sheh në dorën e dikujt një fije që e kishte vendosur për t'u mbrojtur nga sëmundja e malarjes. Menjëherë ia këput atë dhe i lexon këtë ajet: *"Shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun, vetëm se duke i bërë shirk."*[5]

Përsëri në hadith thuhet se *"Kush var temime ka bërë shirk."*[6]

Në një hadith tjetër thuhet se *"Rukja, nuska dhe hajmalia janë shirk."*[7]

3. *Imam Ahmedi, Ibn Maxhe*
4. *Imam Ahmedi, Hakimi*
5. *Imam Ahmedi*
6. *Imam Ahmedi, Ibn Maxhe*
7. *Ahmedi dhe Ebu Davudi, nga Said ibn Xhubejri*

Dhe Said ibn Xhubejri thotë që *"Kush ia këput ndonjërit nuskën nga qafa, është sikur ka liruar një rob."*

Thamë që rreth nuskave të cilat përmbajnë Kur'an, ndërmjet selefëve ka ihtilaf. Ajo që parapëlqehet është që ato s'duhet të përdoren. Në bashkësinë tonë ka një pikë të vërtetuar me përvojë: Shumica e njerëzve që merren me magji, tek nuskat në vend të Kur'anit shkruajnë emra xhindësh, emra kurbanësh që theren për shejtanin dhe vizatojnë shenja që nuk i dihet se çfarë kuptimi kanë. Këto lloj nuskash, s'ka dyshim që janë kufër. Për shkak të kësaj rrezikshmërie, e mira është që nuskat ekzistuese të digjen. Shumë nuska që ne i kemi hapur për t'i parë, kanë qenë me përmbajtje shirku, emra xhindësh dhe të zbukuruara me vizatime.

Ata të cilët varin gjëra që nuk janë si gjërat të cilat varen për nazar, nëse besojnë se dëmin dhe dobinë e japin vetëm këto, kjo gjë është shirk edhe në rububije, edhe në uluhije dhe e nxjerr personin nga feja. Nëse besojnë se dëmin dhe dobinë e jep Allahu, ndërsa këto i shohin si shkak, ky është shirk i vogël, nuk e nxjerr personin nga feja, mirëpo i hap derën e shirkut të madh dhe është pengesë për përfitimin nga plotësimi i teuhidit.

E dimë se sahabët dhe selefët ia kanë hequr njerëzve nga qafat e tyre nuskat dhe gjërat e ngjashme. Në bashkësinë tonë të praktikosh një gjë të tillë duke u bazuar në këto transmetime, sipas asaj që ne mendojmë është gabim. Sepse në bashkësinë tonë, ngaqë tradita është nga bazat e fesë, shumë njerëz nuk e dinë dispozitën e këtyre gjërave. Ajo që është më e mira, është që t'ia shpjegosh këtë në një mënyrë të mirë dhe me argumente. Metoda e ndryshimit të keqes në një vend ku mbizotëron injoranca dhe në të cilin njerëzit shirkun dhe bidatin e bëjnë në emër të fesë, duhet të jetë ndryshe nga metoda e cila praktikohet në një bashkësi në të cilën Teuhidi dhe Sunneti kanë zënë rrënjë. Duhet t'i afrohemi njerëzve me urtësi, me fjalë të buta, me këshilla të bukura, ndërsa besimet e kota të cilat i

kanë çuar njerëzit në këto vepra, duhet t'i ç'rrënjosim duke i kujtuar atyre vërtetësinë e qartë dhe të pastër të teuhidit.

Thirrja me butësi, fjala e mirë dhe afrimi me urtësi, nuk duhet të na ndalojnë neve që t'i emërtojmë njerëzit me emrat që i ka emërtuar Allahu. Metoda e butë në davet është për të fituar zemrën e bashkëbiseduesit, e nuk është për t'i zbutur dispozitat e Allahut e t'i themi musliman një personi i cili i bën shirk Allahut.

Istigathe

Bërja e duasë ndaj dikujt tjetër përveç Allahut dhe kërkimi i ndihmës nga dikush tjetër përveç Allahut në gjëra që ka fuqi vetëm Allahu (Istigathe)

Në mësimet tona të mëparshme, thamë që duaja është ibadet dhe kur i drejtohet dikujt tjetër përveç Allahut, e nxjerr personin nga feja. (Argument i kësaj është ajeti 60 i sures Mu'min dhe hadithi që thekson se *"Duaja është thelbi i ibadetit."*) [8]

Një nga shkaqet më të qarta që Allahu i quajti Mekasit mushrikë, është se Mekasit i bënin dua putave të njerëzve për të cilët besonin se ishin salih (vepërmirë) dhe kërkimi i ndihmës prej tyre. Në ajet thuhet: *"Përqëndrohu me tërë qenien tënde në fenë e drejtë, e mos u bë nga idhujtarët! Dhe mos lut tjetërkë pos Allahut, ndonjë (idhull) që nuk të sjellë as dobi as dëm, e nëse e bën atë, dije se bëhesh nga zullumqarët. Nëse Allahu të provon me ndonjë të keqe, atë s'mund ta largojë kush pos Tij, po nëse dëshiron të japë ndonjë të mirë, s'ka kush që mund ta pengojë dhuntinë e Tij."* [9]

Shënim: Qëllimi nga pjesa e ajetit ku thotë *"dije se bëhesh nga zullumqarët"* është në kuptimin se bëhesh nga mushrikët. Fjala shirk dhe zullum në Kur'an përdoret edhe në kuptime të njëjta. Në ajet thuhet se *"S'ka dyshim se idhujtaria është një zullum i madh."* [10]

8. *Tirmidhiu*
9. *10/Junus, 105-107*
10. *31/Lukman, 23*

Në ajet thuhet se *"Kush është më i humbur se ai që pos Allahut lut diçka që nuk i përgjigjet atij deri në kijamet, sepse ata (që luten) janë gafilë ndaj lutjes së tyre. E kur do të tubohen njerëzit, ata (zotat e tyre) do të jenë armiq të tyre (të adhuruesve) dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre (të idhujtarëve)."*[11]

Forma më e qartë e duasë drejtuar dikujt tjetër përveç Allahut, është kërkimi i ndihmës në moment vështirësie prej atyreve të cilët besohen se janë njerëz të mirë duke përmendur emrat e tyre. Në përgjithësi kjo bëhet duke thënë *"Medet (ndihmë) o Abdulkadir Gejlani"* ose duke përmendur emrat e shejlerëve të tjerë. Kjo gjë siç është shirk nga ana e bërjes dua dikujt tjetër përveç Allahut, po në të njëjtën mënyrë është shirk edhe nga ana e dhënjes së veçorive që i përkasin vetëm Allahut, krijesave. Një person që ka vdekur për të ndihmuar një person që është në vështirësi, duhet që t'i posedojë këto veçori:

Duhet të posedojë cilësinë e dijes absolute, që të dijë gjendjen e atij personi që kërkon ndihmë në pozitë vështirësie.

Duhet të posedojë cilësinë e dëgjimit absolut, që të dëgjojë lutjen e personit.

Duhet të posedojë cilësinë e fuqisë absolute, që t'i çojë në vend dëshirat e personit.

Bërja teberruk me gjëra si pema, varri etj.

Teberruk domethënë; personi të shpresojë bereqet, të kërkojë bereqet. Ndërsa në temën tonë është të besosh se të vjen bereqeti nga gjëra si: vende që njihen si vende mubareke (të shenjta), persona që besohen si njerëz salihë, ose shtimi i mirësisë pranë disa sendeve. Në Islam ka teberruk që është i ligjshëm, ka teberruk që është në kundërshti me teuhidin i cili nuk është i ligjshëm.

Teberruku që është i ligjshëm: Janë gjëra që i ka pranuar

11. *46/Ahkaf, 5-6*

dhe pohuar i dërguari i Allahut. Përshembull; kur pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ishte gjallë, bërja teberruk e sahabëve me ujin që tepronte kur ai merrte abdest, ose nga vendi që ai hante dhe pohimi i këtyre nga pejgamberi ynë.

Ndërsa teberruku që nuk është i ligjshëm: Shpresimi i bereqetit nga gjëra që ai i shikon sipas vetes së tij si të shenjta. Ebu Uakid el-Lejthi tregon kështu: *"Ne dolëm bashkë me Rrasulullahun (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në luftën e Hunejnit. Ne sapo kishim braktisur kufrin. Mushrikët kishin një pemë që quhej "Dhatu envat" në të cilën varnin armët tek ajo, bënin tavaf rreth saj, shpresonin bereqet prej saj dhe thernin kurban pranë saj. Kur ne i pamë mushrikët që vepronin ashtu, i thamë pejgamberit që të na bënte një pemë të tillë. Pejgamberi pasi thotë Allahu Ekber, na drejtohet neve duke na thënë se kjo fjala juaj është si fjala e Beni Izrailëve kur i thanë Musait (paqja qoftë mbi të): O Musa, na e bën edhe neve një zot si zotat e tyre. Në të vërtetë ju jeni një popull xhahil (injorant)."* [12]

Ky hadith është argument për gabueshmërinë e shpresimit të bereqetit dhe mirësisë në një gjë. Sepse sahabët kur panë mushrikët që i varnin armët e tyre tek ajo pemë, menduan se ngadhënjenin dhe ngaqë ishin edhe vetë në gjendje lufte, i kërkuan pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) një kërkesë të tillë. Ndërsa pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) për të treguar se kjo kërkesë e tyre është shumë e keqe, tregon shembullin e kërkimit të Beni Israilëve.

Ky hadith na tregon neve metodën e davetit të Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Ai normalisht edhe pse ka përdorur metodë të butë dhe fytyrëqeshur, kur meseleja kishte lidhje me teuhidin dhe shirkun, edhe pse ata përballë tij ishin të rinj në Islam, përdori një metodë të ashpër. Po në të njëjtën mënyrë edhe atij sahabiut që mbante byzylyk në dorë për shkak të dhimbjes së krahut i thotë që *"Nëse do të vdisje me të nuk do të shpëtoje kurrë."* Ata të cilët marrin vetëm disa fjalë

12. Imam Ahmedi, Tirmidhiu

dhe një pjesë të metodës së davetit të pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) dhe e përgjithësojnë këtë, të cilët tolerancën që i tregoi pejgamberi beduinit i cili urinoi në mesxhid e praktikojnë në të gjitha meselet, ata posedojnë një kuptim të mangët ndaj pejgamberit dhe një metodë daveti të mangët.

Në çështjen e teberrukut ata të cilët marrin bërjen e sahabëve teberruk në gjëra që kanë lidhje me pejgamberin (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) dhe të cilët besojnë se kjo bëhet edhe tek njerëzit salih që vijnë pas tij, janë duke bërë një kijas të gabuar. Sepse sahabët edhe pse i shihnin disa sahabë të tjerë si Ebu Bekrin, Umerin, Aliun shumë të virtytshëm, nuk bënin teberruk me ata. Nëse do të ishte e lejuar teberruku me njerëz salih, sahabët do ta vazhdonin teberrukun me këta njerëz.

Në këtë temë fjala e Umerit është e mjaftueshme për ta ndriçuar çështjen. Ai pasi e puthi Haxherul-Esvedin (gurin e zi) tha kështu: *"Uallahi unë e di që ti je një gur që nuk jep as dobi e as dëm. Nëse nuk do ta shihja Rrasulullahun që të puthi ty, as unë nuk do të puthja ty."* [13]

Kjo fjalë është argument se shpresimi i bereqetit nga prekja apo puthja e ndonjë gjëje, është e lidhur vetëm me sheriatin.

Në bazën e shirkut, në tevexh-xhuhun (drejtimin) nga salihët ka ekstremitet

Shkaku kryesor i rënies së ummeteve në shirk pas të dërguarëve, është ngaqë e tepruan me njerëzit salihë. Pas Ademit (alejhis-selam), shirku tek Ehli kitabi dhe si përfundim tek ky ummet, në përgjithësi ka dalë në këtë fushë. Në ajet thuhet *"Dhe u thanë: Mos braktisni zotat tuaj kurrsesi, mos braktisni Vedda-në, as Suvva-në, e as Jeguth-in, Jeukë-n e Nesre-n."* [14]

Buhari në sahihun e tij në lidhje me këtë ajet dhe emrat që kalojnë në ajet, transmeton nga Ibn Abbasi këtë: *"Emrat që kalojnë në këtë ajet, janë emrat e personave salihë të popullit të*

13. *Buhariu, Ebu Davudi, Nesaiu*
14. *71/Nuh, 23*

Nuhut. Kur ata vdiqën, shejtani i dha vesvese popullit të tyre që në vendet ku ata banonin t'i bënin nga një statujë dhe t'i jepnin këtyre statujave emrat e atyre personave. Edhe ata bënë të njëjtën gjë që i tha shejtani. Derisa vdiq brezi i cili i bëri statujat, këto nuk u adhuruan. Më vonë pasi u harrua dituria, njerëzit filluan t'i adhurojnë këto."

Në një ajet tjetër thuhet *"Ata i konsideruan "ahbarët" (rabinët) e tyre, "ruhbanët" (priftërinjtë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos Allahut."*[15] Tefsiri i këtij ajeti kaloi më parë. Kur shqyrtohen ajetet dhe tefsiret e këtyre, do të shihet se në bazën e shirkut të varrit dhe ligjvënies të cilat janë më të përhapura në rruzullin tokësor, është shkuarja në ekstremitet tek njerëzit salihë ose tek dijetarët.

Kjo ngjarje që i ka ndodhur ummeteve të kaluar, do t'i ndodhë edhe këtij ummeti. Në hadith thuhet se *"Ju do të ndiqni rrugët e të parëve tuaj, hap pas hapi, pëllëmbë pas pëllëmbe. Ata edhe nëse hynë në brimën e zhapikut edhe ju do të hyni në të! Ata që ishin aty e pyetën: O i dërguari i Allahut a çifutët dhe të krishterët janë këta? Ai i tha: E kush mund të jetë tjetër."*[16] Dhe në një hadith tjetër thuhet se *"Nuk ka për t'u bërë kijameti derisa një grup nga ummeti im të adhurojë putat dhe një grup t'i bashkohet mushrikëve."*

Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ngaqë e dinte me anë të shpalljes për ummetin e tij që do të binte e do të devijonte në gjendjen e ummeteve të mëparshme, i ka dhënë disa urdhëresa dhe ndalesa këtij ummeti dhe gjatë gjithë jetës së tij ka bërë përpjekjen për të mbyllur të gjitha rrugët që të çojnë në shirk. Siç është në thirrjen e çdo pejgamberi, disa nga njerëzit i kanë dhënë rëndësi këtyre këshillave, nuk kanë devijuar nga vija e teuhidit, ndërsa disa të tjerë nga njerëzit ia kthyen shpinën këtyre këshillave dhe ranë në shirk hap pas hapi si ummetet e mëparshme. Të rradhisim disa nga këto urdhëresa:

15. *9/Teube, 31*
16. *Buhari, Muslimi*

"Mos shkoni në ekstremitet, sepse ekstremiteti i shkatërroi ata që ishin para jush."[17] Në përgjithësi nuk është mjaftuar vetëm me ndalimin e ekstremitetit, por ai edhe pse është personi më i përshtatshëm për ta respektuar e lartësuar, ekstremitetin nuk e ka dashur edhe ndaj vetes së tij. Në hadith thuhet: *"Mos më lartësoni siç e lartësuan të krishterët birin e Merjemes. Unë jam vetëm rob i Tij, andaj thoni:"Rob dhe i Dërguar i Allahut."*[18]

"Allahu i mallkoftë çifutët dhe të krishterët. Sepse ata varret e pejgamberëve i bënë mesxhid."

"O Allahu im! Mos e bëj varrin tim një put që adhurohet. Allahu është hidhëruar me ata që i bënë mesxhid varret e pejgamberëve."[19]

"Mos i bëni shtëpiat tuaja varreza, dhe varrin tim mos e bëni vend bajrami."[20]

Magjia

Magjia ka dy mënyra: me shpejtësinë e dorës t'i tregosh gjërat ndryshe nga ç'janë dhe t'i ndryshosh disa gjëra duke madhëruar shejtanët dhe duke i përdorur ata. Ajo që na interson neve është pjesa e dytë.

Magjistarët lidhen me shejtanët duke bërë shirk. Ata duke i ofruar disa ibadete shejtanëve të cilat duhen bërë vetëm për Allahun, marrin ndihmë prej tyre në çështje që i bëjnë keq njerëzve, psh., njërin e xhindosin, tjetrin e sëmurin, ndajnë burrin nga gruaja etj. Magjistari kur merr ndihmë nga shejtanët siç hyn vetë në kufër, po ashtu mepatjetër që e fut në kufër edhe atë njeriun që shkon tek ai. Ata bëjnë vepra të cilat e çojnë njeriun në kufër si përshembull, i poshtërojnë ajetet e Allahut, shkruajnë ajete me gjakun e gruas me zakone, hedhja e letrave me ajete në tualet dhe në vende të pista, ose prerja e kurbanit në emër tjetër përveç Allahut.

17. *Ahmedi, Tirmidhiu*
18. *Buhari, Ahmedi*
19. *Imam Maliku, Ahmedi*
20. *Ebu Davud, Ahmedi*

Dispozita e magjisë

Magjia është kufër. Edhe ai që bën magji edhe ai që shkon tek magjistari për t'i bërë ndonjë personi magji, hyn në kufër. Kjo ka dy argumente:

Sulejmani nuk bëri kufër, por shejtanët, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thonin: *"Ne jemi vetëm sprovë, pra mos bëj kufër!" E ata e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit)."* [21]

> *"E sikur të kishin besuar ata dhe sikur të ishin ruajtur (prej mëkateve), po të dinin, shpërblimi prej Allahut do të ishte shumë më i dobishëm."* [22]

Ky ajet i gjatë në lidhje me magjinë, është argument në një mënyrë të hapur se bërja e magjisë dhe të vepruarit me magji, është kufër.

Realiteti i magjisë; pra ai që bën magji bën shirk. Ata magjistarë që janë penduar nga të bërit magji, ose ata magjistarë që janë kapur në shtete të ndryshme duke bërë magji dhe janë dënuar, e kanë pohuar haptazi këtë (pra kanë pohuar se kanë bërë shirk).

Ndikimi i magjisë

Magjia realizohet dhe ndikon me lejen e Allahut. Po në ajetin 102 të sures Bakara thuhet se *"E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e Allahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm."* Kjo pjesë e ajetit thekson në një mënyrë të hapur se magjia ndikon, ndan burrin nga gruaja.

21. *2/Bakara, 102*
22. *2/Bakara, 103*

Dënimi i magjistarit

Xhundebi (radijAll-llahu anh) thotë kështu: *"Dënimi i magjistarit është t'i pritet koka me shpatë."* [23]

Umeri (radijAll-llahu anh) dërgon një letër ku thotë që *"vritini të gjithë magjistarët."* Sahabët të cilët e morën këtë letër, vranë tre magjistarë. [24]

Nëna jonë Hafsa vrau robëreshën e vet e cila i bëri magji asaj. [25]

Këto transmetime tregojnë se magjistari duhet vrarë. Personi i cili bën magji, nëse më parë ka qenë musliman, vritet si murted. Përsëri këto transmetime na tregojnë neve se edhe në periudhën e sahabëve, ka pasur njerëz që janë marrë me magji. Fatkeqësisht në periudhën tonë, gjendja e magjisë dhe përhapja e saj është normale.

Prishja e magjisë (Nushra)

Për të prishur magjinë që i është bërë një personi ka dy mënyra:

Prishja e magjisë duke përdorur një magji të ngjashme: Kjo mënyrë kurrsesi nuk lejohet. Kjo do të thotë të pastrosh papastërtinë me papastërti. Xhabiri (radijAll-llahu anh) pyeti Rrasulullahun (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) rreth nushras. Ai i tha që *"është punë e shejtanit."* [26]

Prishja e magjisë me dua nga Kur'ani dhe Sunneti (me rukje): Kjo është mënyra e shërimit që është e lejuar. Në mësimin tonë në lidhje me rujken, i dhamë argumentet se shërimi me këtë usul (metodë) lejohet. Rukja më ndikuese ndaj magjisë, është leximi i muavidhetejnit (sures Felek dhe Nas).

23. *Tirmidhiu*
24. *Ebu Davudi, Ahmedi*
25. *Imam Malik*
26. *Ebu Davudi, Ahmedi*

Nuk e di kush gajbin (të fshehtën) përveç Allahut

Njëra nga parimet më kryesore të Islamit është se gajbin, se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, nuk e di kush tjetër përveç Allahut. Në ajet thuhet se *"Vetëm Allahut i takon fshehtësia e qiejve dhe e tokës!"* [27]

Në Kur'an, në shumë vende, kjo shprehje është përsëritur me dhjetëra herë në një mënyrë të qartë se *"Nuk e di kush gajbin përveç Allahut."* Ky parim duke përfshirë edhe pejgamberët, i përfshin të gjithë. Askush nuk e di gajbin. Njoftimi i pejgamberëve për gjëra që do të ndodhin në të ardhmen, nuk është ngaqë ata dinin gajbin, por ngaqë ata njoftoheshin me uahij (shpallje). Pejgamberët siç lajmërojnë me shpallje për gjërat që kanë ndodhur në umetet e mëparshme, po ashtu me shpallje lajmërojnë edhe për gjërat që do të ndodhin në të ardhmen (psh; shenjat e kijametit). Ky ajet ku Nuhu thotë *"Unë nuk u them juve se tek unë janë depot e Allahut, as nuk u them se unë e di gajbin"*, [28] e përsërit këtë të vërtetë. Në një ajet tjetër ku Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) urdhërohet të thotë kështu: *"Thuaj: "Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depot e Allahut (e t'ju sjell mrekulli), as nuk pretendoj se e di gajbin, as nuk u them se unë jam një melek (engjëll). Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua."* [29] *"Sikur ta dija gajbin, do t'i shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe."* [30]

Në Kur'an kur shqyrtohen këto ajete, theksohet në veçanti pejgamberi ynë dhe të gjithë pejgamberët në përgjithësi se nuk e dinë gajbin dhe për lajmet që kanë dhënë se do të ndodhin, nuk i kanë shpjeguar si dije nga gajbi, por si dije nga shpallja. Megjithë këtë, e çuditshme është kur disa njerëz thonë që *"Miqtë e Allahut pse mos ta dinë gajbin me lejen e Allahut që?"* Nëse dija e gajbit do të ishte nga shfaqjet e miqësisë me Allahun, pejgamberët nuk ia ndalonin këtë veteve të

27. *16/Nahl, 77*
28. *11/Hud, 31*
29. *6/En'am, 50*
30. *7/A'raf, 188*

tyre me këmbëngulje. Cilësia më e qartë e miqve të Allahut, është imani dhe takvaja (devotshmëria). *"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evlijatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të devotshëm."*[31] Takvaja është që personi të dijë kufirin, mos t'i kalojë kufijt. Asnjë mik i Allahut nuk pretendon se e di gajbin gjë të cilën e di vetëm Allahu, nëse pretendon, nuk është mik i Allahut.

Për shkak të këtyre shkaqeve, ai që pretendon se e di gajbin dhe ai që pretendon se këtë veçori e posedon ndonjë njeri, me unitetin e dijetarëve, ai ka dalë nga feja e Islamit.

Rreth këtyre që rradhitëm deri më këtu, në përgjithësi nuk ka pasur problem ndërmjet ummetit. Por vetëm se ka që pretendojnë se janë të këtij ummeti, të cilët janë bërë bela e këtij ummeti, të cilët nuk pretendojnë direkt se e dinë gajbin, por kujtojnë se lajmërojnë për gajbin me mënyra të ndryshme. Ndërsa populli mashtrohet pas këtyre veprimeve të cilave u janë ndryshuar emrat, mirëpo thelbin e kanë lajmërim nga gajbi. Ndërsa ndryshimi i emrit të një gjëje, nuk e ndryshon realitetin dhe gjynahun e atyre njerëzve që e veprojnë atë. Nëse do të jepnin shembuj për disa forma të këtyre, mund të themi:

Fallxhori: Dhënia e lajmeve për të ardhmen me disa metoda, njoftimi i një gjëje që ka humbur, dhënia e lajmeve që do të ndodhin në jetët e njerëzve duke parë fall dhe duke parë yjet.

Këto me të gjitha llojet e tyre, janë plotësisht në kundërshti me teuhidin, janë vepra dhe besime të cilat janë shirk. Në hadithe thuhet se *"Kush shkon tek një fallxhor dhe i pranon ato që thotë ai, e ka mohuar atë që i ka zbritur Muhammedit."*[32]

31. *10/Junus, 62-63*
32. *Tirmidhiu, Ebu Davudi*

"Kush pyet një fallxhor dhe e pohon atë që thotë ai, dyzet ditë nuk i pranohet namazi."[33]

Horoskopi: Dhe pranë këtyre e cila është përhapur në kohët e fundit, është edhe horoskopi. Veçanërisht nëpër gazeta duke u bazuar tek datat e lindjes së njerëzve, japin lajme në lidhje me jetën ditore dhe javore të njerëzve. Kjo nuk është gjë tjetër vetëm se munexh-xhimizm (është besimi se universin e kontrollojnë yjet dhe emri që i jepet atyreve që i bëjnë këto punë) që ekzistonte kur erdhi Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Buhariu transmeton nga Ebu Katade këtë: *"Allahu i ka krijuar këto yje për tre gjëra; për të zbukuruar qiellin, për të goditur xhindët dhe që të gjehet drejtimi i rrugës me anë të tyre. Ai që i drejtohet ndonjë te'uili tjetër përveç kësaj, ka gabuar dhe e ka humbur hisen e tij. Dhe e ka ngarkuar veten e tij rreth një çështje për të cilën nuk ka dije."*

Shënim: Caktimi i kohës dhe i drejtimit duke u bazuar tek yjet, dielli, hëna dhe planetet e tjera, nuk ka të bëjë me këtë çështje. Siç kaloi edhe tek fjala e Katades se një nga qëllimet e yjeve, është gjetja e drejtimit të rrugës me anë të tyre. Ajo që është e ndaluar ose ajo që është në kundërshti me Islamin, është të besosh se lëvizja e këtyre trupave, ka një lidhje me jetesat e njerëzve dhe të japësh lajme për të ardhmen duke parë yjet.

Shefati

Në kuptimin gjuhësor do të thotë *"çift, e cila është e kundërta e tekut",* ndërsa në kuptimin sheriatik, do të thotë të kërkosh hajër për dikë tjetër, të bëhesh ndërmjetës në hajër. Në preiudhën që erdhi Islami, e refuzoi të kuptuarit e shefatit të gabuar që ekzistonte tek mushrikët dhe në vend të tij solli një të kuptuar shefati me kushte dhe kufij të caktuar e të qartë. Mushrikët me statujat e njerëzve që besonin se ishin salihë, me varret ose me ato gjëra që i përfaqësonin ato, bënin shefat ndërmjet Allahut dhe tyre që Allahu t'ia plotësonte nevojat.

33. *Taberani*

"Thuaj: "Thirrni ata, të cilët i menduat për zota pos Allahut!" Ata nuk posedojnë sa një grimcë as në qiej e as në tokë dhe as që kanë në to ndonjë pjesë, dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë përkrahje. Dhe shefati (ndërmjetësimi) nuk bën dobi tek Ai, përveç i atij të cilit i jep leje." [34]

Në ajete dhe hadithe sahih, madje mutevatir, pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) flet për shefatin e shehidave. Kjo tregon se shefati ndahet në dy pjesë, shefati menfi dhe shefati muthbet:

Shefati menfi: Të kërkosh shefat në punët që nuk ka fuqi kush tjetër përveç Allahut dhe të kërkosh shefat nga i vdekuri ose i gjalli, në çështjet ku nuk ka dhënë leje Allahu. Ajeti i sipërpërmendur theksoi se ky lloj shefati është i pavlefshëm. Problemi i këtyreve që binë në shirk, siç kaloi edhe në mësimet e mëparshme, është sepse nuk i dinë kufijt e sheriatit dhe besimi i tepruar që kanë ndaj njerëzve salihë (të mirë).

Shefati muthbet: Shefati që bëjnë personat (pejgamberët, melekët, shehidat...) të cilëve Allahu i jep leje ndaj personave prej të cilëve Allahu është i kënaqur. *"E sa engjëj ka që janë në qiej, e që shefati i tyre nuk bën dobi asgjë, vetëm pasi që Allahu të japë leje për atë që dëshiron dhe që është i kënaqur për të."* [35]

"Kush mund të bëjë shefat tek Ai, pos me lejen e Tij?" [36]

Në Kur'an thelbi i ajeteve në lidhje me shefatin tregon dy kushte: Allahu duhet të japë leje dhe të jetë i kënaqur; 1) edhe me atë që bën shefatin 2) edhe me atë të cilit i bëhet shefati. Kjo është e vlefshme vetëm për besimtarët. Ebu Hurajra (radijAll-llahu anh) e pyet Rrasulullahun (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) se kush është më i lumturi me shefatin tënd? Ai i thotë: *"Ata të cilët sinqerisht thonë La ilahe il-lall-llah."* [37]

34. *34/Sebe, 22-23*
35. *53/Nexhm, 26*
36. *2/Bakara, 255*
37. *Buhari, Muslimi*

Llojet e shefatit muthbet:

Shefati që do të bëjë pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) në ditën e Gjykimit. Përmbledhja e hadithit është kështu: *"Në ditën e Gjykimit njerëzit ngaqë do vuajnë nga pritja e nisjes së Llogarisë, do të shkojnë tek pejgamberët që ata të bëjnë shefat që të fillojë llogaria. Më parë shkojnë tek Ademi (alejhis-selam). Ai duke u arsyetuar me pemën e ndaluar që hëngri, i dërgon tek një pejgamber tjetër. Pastaj shkojnë tek Nuhu (alejhis-selam), Ibrahimi (alejhis-selam), Musai (alejhis-selam) dhe te Isai (alejhis-selam). Edhe ata i dërgojnë njerëzit tek Muhammedi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Ai do të shkojë pranë Allahut dhe do t'i bëjë sexhde Atij, do ta falënderojë, do t'i kërkojë leje për të bërë shefat dhe Ai do t'i japë leje."* [38]

Shefati i pejgamberit tonë që të hyjnë xhennetlinjtë në Xhennet: Pejgamberi thotë që *"Unë jam i pari i njerëzve që do të bëjë shefat (për hyrjen e njerëzve) në Xhennet."* [39]

Shefati i pejgamberit tonë për disa qafirë: Njëri nga sahabët pranë pejgamberit tonë përmend të mirat e Ebu Talibit ndaj pejgamberit. Dhe e pyesin se a do t'i bëjnë dobi ato të mira që ai i ka bërë ndaj teje? Pejgamberi thotë: *"Në ditën e gjykimit shefati im atij do t'i bëjë dobi. Ai do të ketë dënimin më të lehtë në Xhehennem. Atij do t'i vendosen dy gaca zjarri poshtë thembrave të tij dhe do t'i valojnë trutë."* [40]

Këto tre lloje shefatesh janë vetëm për pejgamberin tonë.

Nxjerrja nga xhehennemi i atyre personave që kanë bërë gjynahe të mëdha: Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) thotë: *"Shefati im është për ata që bëjnë gjynahe të mëdha nga ummeti im"*. [41]

Mundësimi që do të bëjë pejgamberi ynë për hyrjen e disa personave në Xhennet pa llogari: Pejgamberi (sal-lAll-llahu

38. *Buhari, Muslimi*
39. *Muslimi*
40. *Buhari, Muslimi*
41. *Ahmedi, Ebu Davudi.*

alejhi ue sel-lem) ka lajmëruar se nga ky ummet do të hynë në Xhennet 70 mijë persona pa dhënë llogari. Sahabët e pyetën se kush janë këta o i dërguari i Allahut. Pejgamberi iu përgjigj: *"Ata janë njerëz që nuk kërkojnë t'u bëhet rukje, nuk i besojnë fatit të keq dhe i mbështeten vetëm Zotit të tyre"*. Ukkashe ibn Mihsani, sapo e dëgjoi këtë, u ngrit nga vendi dhe tha: *"Bëji dua Allahut që edhe mua të më bëjë prej tyre, o i dërguari i Allahut!"* I dërguari i Allahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i tha: *"Ti je prej tyre!"*. [42]

Këto shefatet e fundit që rradhitëm nuk janë vetëm për pejgamberin tonë. Këtë shefat me lejen e Allahut do ta përdorin salihët, melaiket dhe pejgamberët e tjerë.

Shënimi 1: Në Kur'an në disa ajete thuhet *"Dhe ruajuni një dite kur askush nuk do të mund ta ndihmojë tjetrin për asnjë send, nuk pranohet prej askujt kompensim, nuk do t'i bëjë dobi askujt shefati"*. [43] Ky ajet dhe ajete të tjera të ngjashme si ky, nga pikëpamja e jashtshme theksojnë se s'ka shefat dhe se është plotësisht i padobishëm. Mu'tezilitë dhe disa sekte të ngjashme, duke u bazuar tek këto nasse, e mohojnë shefatin tërësisht ose një pjesë të madhe të tij. Mirëpo siç kaloi edhe në fillim të mësimit se Kur'ani thekson se shefati është i përfshirë në lejen dhe pëlqimin e Allahut, ndërsa sunneti e sqaron shefatin detajisht në hadithe që shkojnë deri në gradën muteuatir. Kur i mbledhim të gjitha nasset, kuptohet se nasset që e ndalojnë shefatin flasin për shefatin menfi.

Shënimi 2: Kërkimi i shefatit nga pejgamberi duke thënë *"Shefat o RrasulAllah"* është në kundërshti me ajetin *"Thuaj: "I tërë shefati (ndërmjetësimi) i takon vetëm Allahut"*. [44] *Ky ajet tregon se i tërë shefati i takon Allahut dhe se nuk kërkohet nga të tjerët. Shefati që do t'ia njohë Allahu pejgamberit nuk është shefat absolut, por është një shefat i lidhur me lejen dhe pëlqimin e Tij. Kështu që shefati nuk kërkohet nga pejgamberi, por nga Allahu.*

42. *Buhari, Muslimi.*
43. *Bakara 2/123.*
44. *Zumer 39/44.*

Thuhet kështu; O Allah mos na lër neve të privuar nga shefati i pejgamberëve". Nëse do të ishte i ligjshëm kërkimi i shefatit direkt nga pejgamberi, pejgamberët me patjetër që do ta kishim sqaruar këtë gjë.

Tevessuli

Rrënja e fjalës së tevessulit është *"vesile".* Vesilja në gjuhën arabe do të thotë shkaku që të shpie tek qëllimi, ndërsa në kuptimin sheriatik do të thotë afrimi tek Allahu me ato vepra që Ai është i kënaqur.

Vesilja ose tevessuli në fushën sheriatike ndahet në dy pjesë:

Tevessuli i ligjshëm

Tevessuli i ligjshëm është t'i afrohesh Allahut me ato shkaqe që Ai është i kënaqur me mënyrën që Ai është i kënaqur. Kur shqyrtohet Kur'ani dhe Sunneti, shihet se kjo përbëhet nga tre pjesë:

a) Të bësh tevessul me emrat dhe cilësitë e Allahut:

"Allahu ka emrat më të mirë, andaj bëni dua Atij me ato". [45]

Për të shtënë diçka në dorë kur i bën dua Allahut, emrat e Tij të bukur mund të përdoren për të mbërritur tek qëllimi. Praktikën e këtij ajeti e shohim tek duatë e pejgamberit. Ai në duanë e Istihares duke thënë *"O Allahu im, unë me ilmin (dijen) Tënde, kërkoj atë që është e hajrit. Me kudretin (fuqinë) Tënde, kërkoj që të më japësh forcë"* bënte vesile për kërkesën e tij, me cilësinë e ilmit dhe kudretit të Allahut. Përsëri pejgamberi ynë në dhikret që bënte pas namazit të sabahut thoshte *"Ja Hajj, ja Kajjum, kërkoj ndihmë me rahmetin (mëshirën) Tënde".*

b) Tevessuli me iman dhe vepra të mira:

"Zoti ynë, ne sinqerisht besuam, na i fal mëkatet tona na ruaj prej ndëshkimit të zjarrit". [46]

45. *7/A'raf, 180*
46. *3/Ali Imran, 16*

"Zoti ynë, ne e besuam atë që e zbrite (shpalljen), e pasuam të dërguarin, pra shënona bashkë me ata që dëshmojnë". [47]

Në hadith pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë: *"Tre persona nga popujt para nesh, gjatë udhës futen në një shpellë për të pushuar. Derën e shpellës e mbyll një gur i madh. Ata thonë që për të shpëtuar nga këtu, secili prej nesh t'i bëjë dua Allahut me veprat e mira që ka bërë më parë. I pari përmend mirësinë që zgjodhi prindërit para fëmijëve. Thotë "O Allahu im, nëse e kam bërë këtë vepër vetëm për hir Teje, na shpëto neve nga kjo gjendje". Guri lëviz pak, por nuk mund të dilnin. I dyti në momentin që do të bënte zina me një femër heq dorë nga zinaja kur ajo i thotë që ki frikë Allahun. Dhe ky i lutet Allahut si ai i pari. Guri lëviz edhe pak, por përsëri nuk mund të dilnin. Ndërsa i treti lutet si dy të parët duke bërë vesile ruajtjen e amaneteve të njerëzve dhe guri lëviz plotësisht".* [48]

Ajetet dhe hadithet që rradhitëm tregojnë se kur kërkon diçka nga Allahu për të mbërritur tek ajo kërkesë, mund të bësh vesile me imanin dhe veprat e mira që ke bërë vetëm për hir të Tij.

c) Tevessuli me duanë e muslimanëve:

Një musliman mund të kërkojë nga një vëlla musliman tjetër që të bëjë dua për atë. Të gjitha hadithet kur sahabët i thonin pejgamberit *"bëj dua për mua"* hyjnë këtu. Dhe kërkimi i sahabëve nga Abbasi që të bënte dua për rënien e shiut pas vdekjes së pejgamberit, është gjithashtu argument për këtë.

Tevessuli që nuk është i ligjshëm:

Ndërsa tevessuli jo i ligjshëm, është jashtë këtyre tre pjesëve që i rradhitëm, i cili është i përhapur tek njerëzit me fjalët *"për hatër të filanit, për hir të filanit, për post dhe nder të filanit"*. Siç e theksuam edhe më parë se besimtarët nuk shpikin shkaqe të tjera përveç atyre shkaqeve që i ka bërë Allahu të ligjshme, ose nuk shtojnë gjëra të tjera duke bërë krahasime me mendjet e

47. *3/Ali Imran, 53*
48. *Buhari, Muslimi*

tyre ndaj atyre shkaqeve që i ka bërë Allahu të ligjshme. Ndërsa pasuesit e shirkut dhe bidatit, nxjerrin shkaqe nga vetvetet e tyre, ose shpikin risi duke bërë krahasime të pabaza ndaj shkaqeve të ligjshme. Ky është shkaku kryesor i tevessulit jo të ligjshëm që ekziston në ditën tonë.

Shënim: T'i bësh Allahut dua me fjali të ngjashme si kjo *"për hatër të pejgamberit tonë"* është pjesë e tevessulit jo të ligjshëm. Kjo nuk është siç e kuptojnë disa që i bie vlera pejgamberit. Edhe pse nuk lejohet të bësh tevessul me Rrasulullahun (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), njeriu më i vlefshëm tek Allahu po ai është. Përkundrazi, mos bërja tevessul me të, është t'i japësh vlerë atij. Atij nuk i jepet vlera me slogane dhe ndjenja, por duke iu bindur fesë që ai solli dhe duke mos futur risi në fe e cila është e plotësuar. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i cili na ka lajmëruar për gjërat që të afrojnë tek Allahu, për gjërat që ta lehtësojnë rrugën e Xhennetit, për gjërat që të largojnë nga zjarri dhe për çdo gjë që është e dobishme për fenë e këtij ummeti dhe për dynjanë, nëse do të ishte e ligjshme dhe e dobishme bërja e tevessulit me të, ai do të na lajmëronte.

Argumentet e gabuara që janë sjellë për tevessulin jo të ligjshëm:

Ajetet: *"O ju që besuat! Kini frikë Allahun dhe kërkoni vesile për t'u afruar tek Ai, luftoni në rrugën e Tij që të gjeni shpëtim"*. [49]

"Të tillët (zotat) që këta po lusin (pos Zotit), vetë ata (zotat e tyre) kërkojnë vesile (te Zoti i vërtetë), shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit të Tij". [50]

Fjala vesile në Kur'an kalon tek këto dy ajete. Ata që mbrojnë tevessulin jo të ligjshëm, veçanërisht sjellin si argument ajetin e parë.

Qëllimi nga vesilja që kalon tek ky ajet, është që t'i afrohesh

49. 5/Maide, 35
50. 17/Isra, 57

Allahut me vepra të ligjshme. Në vazhdimin e ajetit, pjesa *"luftoni në rrugë të Tij"* është sqaruese e pjesës *"kërkoni vesile për t'u afruar tek Ai"*. Dhe mufessirët (komentatorët) e vjetër e kanë komentuar ajetin kështu: *"kërkoni vepra që t'ju afrojnë tek Ai"*. Ne në pjesën e tevessulit të ligjshëm, e shpjeguam se tevessuli me vepra të mira lejohet.

Ndërsa ajetin e dytë, Abdullah ibn Mes'udi e komenton kështu: *"Disa nga njerëzit i bënin ibadet xhindëve. Këta xhind u bënë muslimanë, por ata njerëzit e vazhduan ibadetin ndaj tyre"*. [51]

Sipas këtij tefsiri, ata kur i bënin ibadet xhindëve, xhindët nuk ishin të kënaqur nga ato që bënin ata. Vetë xhindët kërkonin vesile me vepra të mira ndaj Zotit të tyre. Nëse shihet me kujdes, ajeti i dytë nuk ka asnjë lidhje përveç argumentimit të tevessulit të ligjshëm dhe mbajtjes së emrit të ngjashëm me tevessulin jo të ligjshëm.

Hadithet: Pasuesit e bidatit kanë marrë shumë hadithe si argument ndaj vetes së tyre. Hadithet që i sjellin si dyshim, ose janë sahih, por që s'kanë asnjë lidhje me çështjen, ose janë hadithe të trilluara dhe të dobëta që kanë të bëjnë me çështjen. Ne po përmendim prej këtyre ato që janë më të përhapura.

Hadithi që kalon tek Buhariu: *"Umeri (radijAll-llahu anh) në vitin e thatësirës doli në duanë e shiut bashkë me xhaxhain e pejgamberit, Abbasin dhe tha kështu: "O Allahu im, s'ka dyshim se ne më parë të bënim tevessul Ty me pejgamberin dhe Ti na dërgoje neve shi. Ndërsa tani të bëjmë tevessul me xhaxhain e pejgamberit tonë, na dërgo shi"*. Ky hadith është i saktë, por kuptimi dhe rezultati që nxorrën pasuesit e bidatit nga ky hadith, nuk është i saktë. Pra;

Pjesa *"Ne të bënim tevessul Ty me pejgamberin"* është e mbyllur. Ata mund të kenë bërë tevessul me duanë e pejgamberit, mund të kenë bërë tevessul me hatrin e tij, mund të kenë bërë tevessul me postin ose me individin e tij. Për ta kuptuar këtë duhet që të shqyrtojmë hadithin.

51. Buhari

Nëse kanë bërë tevessul me individin e pejgamberit, vlera që ka pasur pejgamberi tek Allahu para se të vdiste, po atë vlerë ka edhe pas vdekjes së tij. Atëherë përse Umeri (radijAll-llahu anh) nuk bëri tevessul me pejgamberin, por bëri me xhaxhain e tij? Dhe kjo tregon se tevessuli që bënin sahabët me pejgamberin kur ai ishte gjallë, është tevessul që bënin me duanë e tij.

Kur shqyrtohet tevessuli që bënin me Abbasin (radijAll-llahu anh) kuptohet se çfarë qëllimi kishin sahabët nga tevessuli. Abbasi (radijAll-llahu anh) i ngriti duart dhe bëri dua kështu: *"O Allahu im, ne t'i ngritëm Ty duart tona gjynahqare dhe kërkojmë prej Teje që të na dërgosh shi"*. Ja pra, argumenti se sahabët kanë bërë tevessul me duanë e Abbasit. Kjo praktikë ka vazhduar edhe tek selefët. Halifët dhe prefektët dilnin me njerëzit e mirë dhe me dijetarët për duanë e shiut dhe kërkonin nga ata që të bënin dua. Ndërsa ligjshmërinë e kësaj, e shpjeguam në tevessulin e ligjshëm.

Imam Ahmedi dhe Tirmidhiu ndodhinë e një sahabiu të verbër e tregojnë kështu: *"Një sahabi i verbër erdhi tek pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) dhe i tha "O i dërguari i Allahut, bëji dua Allahut që të më shërojë"*. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i tha: *"Nëse dëshiron unë bëj dua për ty, nëse ti dëshiron bëj sabër (durim). Kjo është më e mirë për ty"*. Sahabiu i verbër i kërkoi që ai të bënte dua. Pejgamberi ynë i thotë *"Atëherë merr abdest dhe pasi të falësh dy rekat namaz, bëje këtë dua: "O Allahu im, unë kërkoj nga Ty, të drejtohem Ty me pejgamberin e mëshirës, Muhammedin. O Allahu im, bëje Muhammedin ndërmjetës ndaj meje"*.

Ky hadith është i saktë, ndërsa kuptimi që i jepet hadithit është gabim. Sepse as në fillim të hadithit dhe as në fund të hadithit, nuk bëhet fjalë tevessuli me individin e pejgamberit tonë. Pra;

Sahabiu kërkoi dua nga pejgamberi. Nëse do të ishte i lejuar tevessuli me individin e pejgamberit, ai nuk kishte pse të sh-

konte tek pejgamberi, por bënte tevessul me individin e tij nga aty ku banonte.

Dhe pejgamberi ynë kur i tha *"Nëse dëshiron unë bëj dua për ty" e theksoi haptazi se funksioni është bërja e duasë."*

Dhe duaja që i mësoi pejgamberi atij *"O Allahu im, bëje Muhammedin ndërmjetës ndaj meje"* është në kuptimin o Allahu im, pranoje duanë e atij që do të bëjë për mua. Sepse pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i sugjeroi atij që të bënte dua, që Allahu t'ia pranonte pejgamberit duanë që do të bënte për atë.

Në një hadith që e transmeton Hakimi, kur Ademi (alejhis-selam) u nxorr nga xhenneti bëri dua në këtë mënyrë: *"O Allahu im, të kërkoj që të më falësh mua për hir të Muhammedit"*. Allahu i thotë se nga e njeh ti Muhammedin kur Unë atë nuk e kam krijuar akoma? Ademi (alejhis-selam) thotë: *"Kur Ti më krijove mua, unë ngrita kokën dhe në shtyllat e arshit pashë se shkruante La ilahe il-lall-llah Muhammedun Rrasulullah. Kuptova se Ti nuk shkruan emër tjetër nga krijesat përveç atij që do më shumë"*.

Ky hadith, është një hadith i trilluar. Është në kundërshtim edhe me ndodhinë e Ademit (alejhis-selam). Në ajetin 37 të sures Bakara thuhet: *"E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë (lutje), prandaj Ai ia fali (gabimin), Ai është Mëshirues dhe pranues i pendimit"*. Ndërsa në ajetin 23 të sures A'raf është sqaruar se çfarë ishin këto fjalë: *"Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë (i dëmtuam) vetvetes sonë, në qoftë se nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!"*. Nëse shihet me kujdes, Ademi (alejhis-selam) nuk bëri teube me individin e pejgamberit tonë, por me këtë dua që kalon në ajet.

"Bëni dua me pozitën time. Sepse pozita ime tek Allahu është e madhe".

Ky hadith është i pabazë dhe batil. Nuk kalon në asnjë nga burimet mu'tebere (të vlefshme).

Fikhu İ Duasë Në Kur'an

Kur'ani dhe Sunneti vazhdimisht i thërret njerëzit në dua. Kushdo që i shqyrton nasset (tekstet), do të shohë se duaja në Islam ka një vend të gjerë. Duaja në Kur'an dhe në Sunnet është quajtur thelbi i ibadetit, është përmendur si ndryshim mdërmjet robërve të Allahut dhe mustekbirëve (mendjemëdhenjëve). Në të gjitha nasset të cilat thërrasin për dua, bëhet fjalë vetëm për kërkimin nga Allahu dhe direkt nga Ai. Dhe kjo është në një kundërshti të madhe me tevessulin jo të ligjshëm.

Në ajet thuhet kështu: *"E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem duasë (lutjes) kur lutësi më lutet"*. [1]

Në Kur'an në ajetet pyetëse si *"Nëse të pyesin", "Të pyesin"* etj., përgjigja gjithmonë është *"Thuaj që"*. Ndërsa në ajetin e duasë, Allahu edhe pejgamberin e ka hequr nga mesi dhe është përgjigjur direkt Vetë. Dhe në të gjitha ajetet e tjera në lidhje me duanë, thuhet që *"Bëni dua Zotit tuaj"* në mënyrë që njeriu t'i drejtohet direkt Allahut.

Dyshimet e bazuara në nasse të atyre që mbrojnë tevessulin jo të ligjshëm, i përmendëm. Pranë kësaj ka dhe një të kuptuar tjetër që nuk është i bazuar në nasse, por në gjuhën e popullit në këtë mënyrë: *"Njeriu kur i duhet të bëjë ndonjë punë, me patjetër që duhet të ketë një ndërmjetës në mes. Në lidhje me marrëdhëniet tona me Allahun, ne gjynahqarët nuk kemi ndonjë vlerë. Prandaj kur kërkojmë nga Allahu, kërkojmë me pozitën e njerëzve të mirë"*.

Krahasimi i Allahut si një drejtor dhe nxjerrja e një rezultati sheriatik nga ky krahasim, është si puna e shejtanit që duke krahasuar baltën me zjarrin, e pa veten më të mirë se Ademi (alejhis-selam). Si mund të krahasohet Krijuesi me krijesën?

Kur kërkohet diçka nga njeriu, ai nuk kënaqet dhe është tip

1. *2/Bakara, 186*

që dëshiron t'i shtypë njerëzit duke përdorur nevojat e tyre. Ndërsa Allahu kënaqet kur kërkohet nga Ai, madje hidhërohet kur nuk kërkohet nga Ai dhe kënaqet kur ia plotëson nevojat njerëzve. Kështu që nuk është i mundur një krahasim i tillë.

Që drejtori t'i dijë nevojat tona, me patjetër që duhet ta lajmërojë dikush. Ndërsa Allahu Teala i di problemet e njerëzve pa patur ndërmjetës në mes.

Ata të cilët e krahasojnë Zotin me drejtorin e firmës, duhet të ulen dhe të mendojnë se në ç'humbje të madhe janë. Shejtani ka luajtur me ata deri në këtë gradë dhe i ka mashtruar me Allah. Ata e kanë krahasuar Allahun me njeriun, ndërkohë që Allahu është Krijuesi dhe Furnizuesi, i cili posedon emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta.

Besimi në pambarësi, fatkeqësi (Tiare, Teshaum)

Tiare domethënë që personi disa gjëra t'i quajë si pambarësi. Ky është një besim që ka ekzistuar edhe shumë kohë më parë dhe në çdo bashkësi ka qenë në forma të ndryshme. Disa bashkësi para se të bënin një punë e lëshonin një zog, nëse zogu do të fluturonte në krahë të djathtë, këtë e quanin mbarësi dhe e fillonin atë punë, nëse zogu do të fluturonte në krahë të majtë, këtë e quanin pambarësi dhe hiqnin dorë nga ajo punë. Disa njerëz kur shohin disa kafshë, thonë se s'ka shans në këtë punë dhe besojnë se nuk do t'i shkojnë punët mirë. Në bashkësinë tonë, nëse sheh lypës në mëngjes kur ikën për punë, nëse sheh mace të zezë, nëse gjarpëri të pret rrugën ose kur të ndodhin 3-4 gjëra ters njëra pas tjetrës brenda shtëpisë, cilësohen si pambarësi.

Nëse personi beson se ndikimi tek ndodhitë vjen vetëm nga Allahu, por në disa mesele beson se nuk do t'i shkojnë punët mbarë duke e lidhur me disa gjëra që sheh gjatë ditës, ka bërë shirk të vogël. Gjërat që ai i quan si pambarësi, nëse beson se ndikimi vjen direkt prej tyre, ky person ka bërë shirk të

madh i cili të nxjerr nga feja. Pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në shumë hadithe kur ka numëruar faktorët e shirkut, ndërmjet tyre, ka numëruar edhe tiaren: *"Tiarja është shirk, tiarja është shirk, tiarja është shirk. Nuk ka ndërmjet nesh që nuk i vijnë në mendjen e tij gjëra të tilla, por Allahu ia largon atij atë me tevekkul (me mbështetje ndaj Allahut)".* [2]

Në një hadith tjetër sahabët e pyesin kështu: "O i dërguari i Allahut, ndërmjet nesh ka disa persona që disa gjëra i pranojnë si pambarësi. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) i thotë: *"Kjo është një gjë që e ndien çdo person. Por kjo ndjenjë mos ta ndalojë atë nga puna që ai do të bëjë".* [3]

Këto hadithe tregojnë se besimi në pambarësi mund të jetë tek çdo person. Shkaku i kësaj është pikëpamja e fjalëve dhe veprave të bashkësisë në të cilën jemi rritur. Kur forcohet tevekkuli i personit, shpëton nga këto lloj besimesh të prishura. Nëse personit i vjen në mendje ky mendim, duhet ta largojë menjëherë atë dhe duhet që të mos veprojë sipas asaj që ndien. Në një hadith pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) thotë: *"Kush heq dorë nga një punë për shkak të tiares, ka bërë shirk."* Sahabët e pyesin se *"Çfarë është kefareti (shpagimi) i kësaj o i dërguari i Allahut?"* Ai i thotë: *"Personi të thotë se nuk ka hajër tjetër përveç hajrit Tënd, nuk ka pambarësi tjetër përveç takdirit (caktimit) Tënd dhe nuk ka ilah tjetër përveç Teje".* [4]

2. *Ahmedi, Ebu Davudi*
3. *Muslimi*
4. *Ahmedi*

Besımı Në Melaıke (Engjëjt)

Në Kur'an dhe Sunnet është theksuar se besimi në melaike, është nga bazat e domosdoshme të imanit. *"I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, melaikeve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij..."* [1]

Shumë imamllarë hadithesh duke qenë në krye Buhariu dhe Muslimi, transmetojnë nga sahabë të ndryshëm hadithin që njihet si *"Hadithi i Xhibrilit"* ku Xhibrili e pyet pejgamberin se *"Çështë imani?"* e ai i thotë *"Imani është të besosh Allahun, melaiket e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, ringjalljen pas vdekjes, se e mira dhe e keqja vjen nga Allahu"*.

Në përgjithësi është kusht për çdo njeri që të besojë në ekzistencën e melaikeve, se ata janë krijuar për t'i bërë ibadet Allahut, se nuk bëjnë kryengritje ndaj Tij, se nuk hanë e nuk pinë, se nuk kanë gjini.

"E ata thanë: "I Gjithëmëshirshmi ka fëmijë (melaiket)!" Larg saj qoftë madhëria e Tij! Jo, ata (melaiket) janë robër të ndershëm! Që nuk flasin para Tij, ata veprojnë me urdhërin e Tij. Ai (Allahu) e di çka vepruan më parë dhe çka do të veprojnë dhe ata nuk përpiqen të bëjnë shefat pos për atë me të cilin është i kënaqur Ai, e ata dridhen prej frikës së Tij". [2]

"Vetëm e Tij është çdo gjë që është në qiej e në tokë! E ata që janë pranë Tij (melaiket), nuk shprehin mendjemadhësi në adhurimin ndaj Tij, e as nuk u bëhet (ibadeti) monoton. Ata lartësojnë (Allahun) natë e ditë dhe nuk mërziten". [3]

"Falënderimi i qoftë Allahut, Krijuesit të qiejve e tokës, Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tri palë e katër palë krahë". [4]

Këto dhe ajete të ngjashme, janë argumente të përgjithshme në lidhje me besimin rreth melaikeve.

1. *2/Bakara, 285*
2. *21/Enbija, 26-28*
3. *21/Enbija, 19-20*
4. *35/Fatir, 1*

Detyrat e melaikeve

Allahu i krijoi melaiket dhe çdonjërit prej tyre i dha detyra të ndryshme. Disa janë të angazhuar vazhdimisht me ibadetin dhe tesbihun ndaj Allahut, ndërsa disa të tjerë bashkë me tesbihun vazhdimisht ndaj Allahut, janë të ngarkuar edhe me detyra të ndryshme.

▪ Dikush është engjëll i shpalljes. Është e vërtetuar në Kur'an dhe Sunnet se Xhibrili është engjëll i shpalljes.

▪ Dikush është i ngarkuar me shiun dhe punët e bimëve. Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) kur e pyeti Xhibrilin për detyrën e Mikailit, ai i tha se *"Ai është i ngarkuar me shiun dhe punët e bimëve"*.

▪ Dikush është i ngarkuar me fryerjen e surit. Në hadith pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: *"Pronari i surit e ka përkulur kokën përpara dhe si të jem i qetë unë kur ai pret për t'i fryrë surit!"*. [5]

▪ Dikush është i ngarkuar me marrjen e shpirtrave. *"Derisa kur ndonjërit prej jush i afrohet vdekja, atij ia marrin shpirtin të dërguarit tanë (melekët e vdekjes), ata kurrë nuk janë të pakujdesshëm ndaj detyrës së tyre"*. [6]

Emri i këtij meleku është meleku i vdekjes. Në hadithe kalon se ky engjëll bashkë me ndihmuesit që i janë dhënë, ia marrin shpirtrat njerëzve në mënyra të ndryshme, sipas gjendjeve që ata kanë. Nuk ka asnjë transmetim të saktë se emri i këtij meleku është Azrail.

Këta janë katër melaiket që përmenden më së shumti në Kur'an. Përveç këtyre ka edhe melaike që janë të detyruar të ruajnë njerëzit (Enbija, 42), që janë të detyruar të shkruajnë veprat e mira dhe të këqija të njerëzve (Zuhruf, 80; Infitar, 11), që ruajnë Xhehennemin (Zumer, 71, Ra'd; 24). Ne siç besojmë në ekzistencën e melaikeve, po ashtu besojmë edhe tek cilësitë e tyre që na tregon Kur'ani dhe Sunneti i saktë.

5. *Imam Ahmedi*
6. *6/En'am, 61*

Dobitë e besimit ndaj melaikeve

Për të ditur madhështinë e Allahut: Që njerëzit ta vlerësojnë siç duhet madhështinë e Allahut, që t'i besojnë siç duhet Atij, Allahu azze ue xhel-le në univers ka krijuar shumë shenja të dukshme dhe të padukshme. Edhe pse melaiket, krijimi i tyre, detyrat e tyre, numri i tyre janë aq shumë sa nuk dihen, kur njeriu mendon se si ata lëvizin në një mënyrë të sistemuar e të pagabuar, do të kuptojë madhështinë e Allahut dhe do t'i bëjë ibadet Atij edhe më mirë.

Për të kuptuar vlerën që Allahu na e ka dhënë neve: Njeriu kur shqyrton detyrat e melaikeve, sheh se shumica e tyre punojnë për lumturinë tonë në dynja dhe në ahiret. Kjo është shfaqja e vlerës që Allahu na e ka dhënë neve. Ai krijesat më besnike në univers i ka vënë në shërbim të njerëzve.

Na mundësojnë që të frikësohemi nga Allahu ashtu siç duhet: Kur njeriu e di se çdo fjalë që thotë, çdo vepër që bën shkruhet në krahun e djathtë ose në krahun e majtë, jeton sipas kësaj dhe i shtohet takvaja (devotshmëria).

Besimi i bashkësisë së shirkut ndaj melaikeve

Në bashkësinë xhahilije besohej se melaiket ishin vajzat e Allahut. Gjendja e atyre në ajet tregohet kështu: *"Ata i përshkruan Atij pjesë (fëmijë) nga robërit e Tij (një pjesë e çifutëve Uzejrin e quajtën biri i Allahut, kristianët Isain e quajtën biri i Allahut, ndërsa mushrikët melaiket i quajtën vajza të Allahut). Njeriu i tillë njëmend është mohues i hapët. A mos Ai nga ato që krijoi, për vete përcaktoi vajza, kurse juve ju dalloi me djem? E kur ndonjëri prej jush lajmërohet me (lindje të vajzës) atë që ia pat përshkruar Zotit shembull, fytyra e tij nxihet dhe i zihet fryma. A, atë që rritet me stoli e në dialog është i paqartë (ia përshkruajnë Zotit)? Edhe engjëjt që janë adhurues të Zotit i quajnë femra? A prezentuan ata në krijimin e tyre (melekëve)? Dëshmia e tyre do të regjistrohet dhe ata do të merren në pyetje".* [7]

Bashkësia xhahilije e sotme ka riformuar përsëri besimin e

7. *43/Zuhruf, 15-19*

bashkësisë xhahilije të vjetër. Nëpër filma kinemaje dhe filma vizatimorë, melaiket në përgjithësi tregohen në formën e vajzave dhe rrallëherë në formën e burrit, pra i kanë atribuar melaikeve gjini.

Kush janë më të lartë; melaiket apo mu'minët salih?

Në librat e itikadit në kapitullin e imanit kjo temë është folur nga dijetarët. Shkaku i kësaj është se nuk ka nass të drejtëpërdrejtë që pasqyron çështjen, por ka nasse që duken sikur janë në kundërshti me njëra-tjetrën.

Disa dijetarë kanë thënë se mu'mini salih është më i lartë se meleku. Si argument kanë sjellë sexhden e melaikeve ndaj Ademit (alejhis-selam), ngase njeriu bën ibadet duke pasur shejtanin dhe epshin, ndërsa melaiket me natyrën e krijimit të tyre nuk e kundërshtojnë Allahun.

Ndërsa disa dijetarë kanë thënë se melaiket janë më të lartë se mu'minët salih. Si argument përmendin ajetet që tregojnë se melaikët nuk e kundërshtojnë Allahun dhe se vazhdimisht i bëjnë ibadet Atij. Gjithashtu duke marrë edhe si argument këtë hadithin e mëposhtshëm kanë pranuar se melaiket janë më të lartë: *"Nëse robi Im më përmend Mua tek vetja e tij, edhe Unë e përmend atë tek Vetja Ime. Nëse robi Im më përmend Mua në një mexhlis, Unë e përmend atë në një mexhlis më të mirë (pra e përmend tek melaiket)".* [8]

Ndërsa një grup tjetër dijetarësh duke përmbledhur nasset kanë thënë kështu. *"Në gjykimin e dynjasë melaiket janë më të lartë se mu'minët salih, ngaqë melaiket nuk kundërshtojnë kurrë. Ndërsa në ahiret mu'minët salih, ngaqë nuk bëjnë gjynahe dhe ngaqë melaiket janë në shërbim të tyre, mu'minët salih do të jenë më të lartë".* Allahu a'lem (Allahu e di më së miri)...

8. *Buhari*

Besimi Në Lıbra

Imani në libra është nga bazat e imanit. Argumentet për këtë në Kur'an e Sunnet, janë aq shumë saqë nuk mund t'i përmendim dot. Ajeti 285 i sures Bakara që përmendëm për besimin në melaike dhe hadithi sahih që njihet si hadithi i Xhibrilit, janë argumente edhe për besimin në libra.

Çfarë do të thotë të besosh në libra?

Besimi në libra ndahet në dy pjesë: i përgjithshëm dhe i detajuar. Një musliman që ta sjellë në vend këtë kusht të imanit, më parë duhet të besojë në mënyrë të përgjithshme (pra, duhet të besojë çdo libër që ka zbritur Allahu edhe nëse nuk ia di emrin librit). Më pas me burime të sakta duhet të besojë të gjitha librat që ka zbritur Allahu. Dhe kësaj i thonë *"iman i detajuar"*.

Vërtetësia e imanit në libra është ta pohosh brendësinë e tij, t'i bindesh urdhërave dhe ndalesave të tij, t'i besosh ajetet muhkeme (të cilat janë të qarta dhe përmbajnë vetëm një kuptim, shënim i përkthyesit) e të veprosh me to, t'i dorëzohesh ajeteve muteshabihe (të cilat përmbajnë më tepër se një kuptim dhe të mos nxjerrësh dispozita duke u bazuar në ato, shënim i përkthyesit), t'i respektosh kufijt e tij, ti praktikosh ligjet e tij si një sistem dhe të luftosh për atë. Kjo është forma që duan nasset e Kur'anit ndaj besimit në libër. Përndryshe pretendimi i besimit në libër, nuk bëhet gjë tjetër vetëm se një mendim epshor.

Qëndrimi i muslimanëve ndaj librave të mëparshëm

Muslimanët i besojnë të gjithë librat që ka zbritur Allahu, pa bërë dallim ndërmjet tyre. Të mohosh një libër që e ka zbritur Allahu, është sikur të mohosh të gjithë librat e fesë, sepse librat që ka zbritur Allahu vërtetojnë librat e mëparshëm dhe përgëzojnë për librat që do të vijnë më pas.

"Ne vazhduam gjurmët e tyre (të pejgamberëve) me Isain,

birin e Merjemes, vërtetues i Tevratit që kishin më parë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin pranë". [1]

"Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: "O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut tek ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje". [2]

"Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur'anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre". [3]

Nga këto ajete kuptojmë se ai person që mohon cilindo libër që dihet se ka zbritur nga Allahu, në fakt ai ka përgënjeshtruar librin për të cilin është i detyruar ta besojë. Mohimi i asaj që libri i tij ka vërtetuar, pohuar, pranuar e përgëzuar, është në kundërshti me imanin ndaj librit të tij.

Ato gjëra që janë të prera në lidhje me librat e mëparshëm janë; Teurati që i është dhënë Musait (alejhis-selam), Inxhili që i është dhënë Isait (alejhis-selam), Zeburi që i është dhënë Davudit (alejhis-selam), broshurat që i janë dhënë Musait (alejhis-selam) dhe Ibrahimit (alejhis-selam). Dhe përveç këtyre, besojmë të gjitha lajmet që janë në Kur'an dhe në Sunnetin e saktë.

Ato që shpjeguam deri më këtu, janë gjykim i përgjithshëm. Kur'ani na lajmëron se shumica e librave të mëparshëm janë ndryshuar dhe janë larguar nga thelbi. Si duhet të jetë qëndrimi i muslimanëve ndaj Teuratit dhe Inxhilit që dihen se janë të ndryshuar? Këto libra nuk dalin jashtë këtyre tre gjendjeve:

Të pezulluar me ardhjen e Kur'anit: Këtyre u besohet, por nuk veprohet me to.

Të ndryshuarat nga vetë ata: Kurrsesi nuk i besohet pjesës së

1. *5/Maide, 46*
2. *61/Saff, 6*
3. *5/Maide, 48*

ndryshuar. Libri që ndodhet në dorën e ehli kitabit është plotësisht i ndryshuar. As nuk i besohet e as nuk veprohet me të.

Pjesët e pandryshuara që sheriati ynë nuk thekson në saktësinë dhe gabueshmërinë e tyre: Në hadith pejgamberi ynë ka thënë: *"Kur t'ju thotë diçka ehli kitabi juve, as mos e saktësoni e as mos e përgënjeshtroni, por thuani se ne i besojmë asaj që ju është zbritur juve dhe neve"*. [4]

Është e ndaluar nga ana e pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) që një musliman t'i marrë dhe t'i shqyrtojë këto libra. Pejgamberi ynë kur sheh disa faqe Teurati në dorën e Umerit (radijall-llahu anh) i ndryshon çehrja e fytyrës dhe thotë: *"Betohem në Allahun që në duart e Tij është shpirti im, nëse Musai do të ishte ndërmjet nesh, nuk do të kishte rrugë tjetër vetëm se të më bindej mua"*. [5]

Shënim: Për dijetarët që e kanë itikadin islam të fortë, nuk ka ndonjë të keqe nëse shqyrtojnë librat e ehli kitabit me qëllim që njerëzit të besojnë, e për t'ua larguar dyshimet njerëzve nga kokat e tyre etj.

Besimi në Kur'ani Kerimin

Fjala dhe kuptimi i Kur'anit i përket Allahut, Kur'ani neve na ka ardhur mutevatir, i është dhënë pejgamberit tonë me anë të shpalljes dhe është libri i fundit i cili është i dërguar për të gjithë njerëzimin. Një njeri për të hyrë në rrethin e imanit, është kusht që të besojë se që kur ka zbritur Kur'ani e deri në ditën e kijametit, vetëm ligji i tij është i vlefshëm.

Kur'ani është kelami (fjala) e Allahut

Allahu është muttasif (i cilësuar) me sifatin (cilësinë) e kelamit. Në ajet thuhet: *"Allahu i foli Musait me fjalë"*. [6]

Në shumë ajete të Kur'anit dhe në hadithe të sakta, kalon se Allahu do të flasë me banorët e Xhennetit dhe se nuk do të

4. *Buhari, Muslimi*
5. *Imam Ahmedi*
6. *4/Nisa, 164*

flasë në ditën e gjykimit me xhehennemlinjtë. Përsëri Allahu të folurën e ka quajtur si cilësi të plotë, viçin që beni israilët e morën për zot, e ka kritikuar për shkak se nuk fliste.

"A nuk e shihnin ata se ai nuk iu fliste as nuk i udhëzonte në ndonjë rrugë të drejtë?". [7]

Kështu që Kur'ani është fjala e Allahut. Pra, (të folurit) është cilësi e Allahut. Allahu ka folur me të në një mënyrë që i shkon madhështisë së Tij. Kur'ani nuk është i krijuar, sepse cilësitë e Allahut nuk janë të krijuara. Ky është mendimi i Ehli hadithit dhe Ehli Sunnetit. Grupet e ndryshme janë afruar ndryshe ndaj cilësisë së kelamit të Allahut.

▪ Disa kanë thënë: *"Kur'ani është kuptim që vjen në zemër për shkak të cilësisë dhe virtytit të lartë që ekziston tek njeriu".* (Filozofët)

▪ *Disa kanë thënë "Kur'ani është mahluk (i krijuar)".* (Mu'tezilitë)

▪ Disa duke thënë se *"Kur'ani nuk është mahluk, por është fjala e Allahut",* janë bashkuar me Ehli Sunnetin, por duke thënë se *"Allahu nuk ka folur me të, por është kuptimi që gjendet tek Vetja e Tij"* e kanë kundërshtuar Ehli Sunnetin. Ne jemi të bindur se ajo që kalon përbrenda njeriut nuk mund të quhet *"kelam".*

7. 7/A'raf, 148

Besimi Në Pejgamberë

Të besosh pejgamberët është nga bazat e imanit. Argumenti i kësaj është ajeti 285 i sures Bakara dhe hadithi i Xhibrilit.

Çfarë do të thotë të besosh në pejgamberë?

Besimi në pejgamberë do të thotë t'i pohosh ata në gjërat që lajmërojnë, t'i bindesh urdhërave të tyre, t'i përmbahesh ndalesave të tyre dhe ta adhurosh Allahun vetëm në mënyrën që ata tregojnë.

Ky përkufizim është i vlefshëm edhe për pejgamberin tonë edhe për pejgamberët e tjerë. Allahu të gjithë pejgamberët i dërgoi që njerëzit t'i bindeshin atyre. Allahu në këtë mënyrë e caktoi ndryshimin ndërmjet atyre që besojnë me ata që nuk besojnë ose që janë gënjeshtarë.

"Ne nuk dërguam asnjë të dërguar vetëm që me lejen e Allahut (njerëzit) t'i binden atij". [1]

"Thuaj: "Bindjuni Allahut dhe të dërguarit, e nëse ata refuzojnë, atëherë Allahu nuk i do qafirët". [2]

"Ata (hipokritët) thonë: "Ne i kemi besuar Allahut, të dërguarit të Tij, dhe u jemi bindur. Por pas asaj, një grup prej tyre zbrapsën. Të tillët nuk janë besimtarë". [3]

Në përkufizimin që dhamë më lart; pohimi ç'ka ata sjellin, bindja ndaj urdhrit, përmbajtja ndaj ndalesës, në përgjithësi janë çështje që i pranojnë të gjithë. Ndërsa *"praktikimi i kësaj në mënyrën që ata e kanë sjellë"* është shenja ndërmjet besimtarëve të vërtetë me ehli bidatin. Allahu siç i ka dhënë detyrën pejgamberëve që t'ia çojnë njerëzve urdhëresat dhe ndalesat, po ashtu i ka dhënë atyre edhe detyrën e shpjegimit, sqarimit të këtyre. Këtë e bëri që urdhëresat dhe ndalesat e Tij, të çohen në vend në formën që ata (pejgamberët) treguan dhe shpjeguan.

1. *4/Nisa, 64*
2. *3/Ali Imran, 32*
3. *24/Nur, 47*

"O Profet, kumto atë çka të shpallet nga Zoti yt!". [4]

"(I patëm dërguar pejgamberët) Me argumente dhe me libra të shenjtë. Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, mbase edhe ata do të mendojnë". [5]

Numri i pejgamberëve:

"Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të dërguar të tjerë për të cilët nuk të rrëfyem, e Musait i foli Allahu me fjalë". [6]

Ky ajet është argumenti se ndodhitë e disa pejgamberëve janë treguar e të disave jo. Ne pejgamberëve që kalojnë në Kur'an me emra si Ademi, Nuhu, Ibrahimi e të tjerët i besojmë detajisht, ndërsa pejgamberëve të tjerë që nuk kalojnë, i besojmë në përgjithësi duke mos bërë dallim mes tyre.

Shënim: Ai që mohon një pejgamber i ka mohuar të gjithë pejgamberët. Mohimi i një pejgamberi para pejgamberit të tij ose pas tij është mohimi i pejgamberit të tij.

"S'ka dyshim se ata që nuk besojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të dërguarve të Tij e thonë: "Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë" e mes këtij duam të marrin një rrugë. Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë, e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët". [7]

Ndryshimi ndërmjet Rrasulit dhe Nebiut

Disa dijetarë kanë thënë se Rrasuli me Nebiun janë të njëjtë, nuk ka ndonjë ndryshim ndërmjet tyre. Mendimi që parapëlqehet është mendimi i atyre dijetarëve që thonë se ndërmjet tyre ka ndryshim. Ndryshimet më të qarta janë këto:

Rrasulët dërgohen me sheriat të ri, ndërsa nebilerët praktikojnë sheriatin e mëparshëm.

4. *5/Maide, 67*
5. *16/Nahl, 44*
6. *4/Nisa, 164*
7. *4/Nisa, 150-151*

Rrasulët marrin shpallje dhe e kumtojnë shpalljen, ndërsa nebilerët edhe pse marrin shpallje, nuk janë përgjegjës për kumtimin e saj.

Si njihen pejgamberët

Saktësia tek pretendimi i një njeriu kur thotë se unë jam pejgamber:

Sipas disave ata njihen me cilësitë e virtyteve të tyre shumë të larta. Ky mendim është mendimi i filozofëve.

Sipas disave ata njihen vetëm me muxhize (mrekulli). Ky është mendimi i disa dijetarëve të Ehli Sunnetit. Dijetarët që e mbështesin këtë mendim nuk pranojnë se njerëzit bëjnë keramete (gjëra të jashtëzakonshme) përveç pejgamberëve. Ngaqë muxhizja dhe kerameti janë të ngjashme nga ana e të jashtëzakonshmes, kështu që nuk mbetet ndryshim ndërmjet njerëzve dhe pejgamberëve.

Mendimi që parapëlqehet është se pretendimi i pejgamberisë njihet me muxhize, me hapjen e davës, me ardhjen e gjërave që ata lajmërojnë dhe me shumë shkaqe të tjera.

Besimi në Muhammedin (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem):

Çdo gjë që shkruajtëm në përkufizimin e besimit ndaj pejgamberëve, është e vlefshme edhe për Rrasulullahun (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Ai ka disa veçori që e dallojnë nga të tjerët. Pejgamberët e tjerë janë dërguar vetëm për popullin e tyre, ndërsa ai është dërguar për të gjithë njerëzimin.

"Thuaj (Muhammed): "O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut tek të gjithë ju". [8]

"Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes". [9]

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në një hadith të saktë thotë: *"Unë nga pejgamberët e tjerë jam më i lartë në pesë*

8. *7/A'raf, 158*
9. *34/Sebe, 28*

gjëra. Ata janë dërguar vetëm për popullin e tyre, ndërsa unë jam dërguar për të gjithë njerëzimin...".

Është pejgamberi i fundit. Pas tij nuk ka as Rrasul e as Nebi.

"Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai është i dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve". [10]

Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) thotë: "Unë kam pesë emra: *"Unë jam Ahmedi, jam Muhammedi, jam Mahij'i, jam Akibi dhe jam pejgamberi i fundit që nuk ka më pejgamber pas meje".* [11]

Qenia e tij si pejgamber i fundit i pezullon të gjitha sheriatet e mëparshme dhe kush dëgjon për të, është i detyruar t'i besojë. Në hadith thuhet: *"Nga ky ummet kush dëgjon për mua, qoftë çifut, qoftë kristian, qoftë zjarrputist e nuk më beson, do të hyjë në zjarr".* [12]

Përsëri qenia e tij si pejgamber i fundit do të thotë që shpallja pas tij u ndërpre. Ai që pretendon se mua më është shpallur ose edhe pse nuk pretendon hapur, por duke thënë në një mënyrë të mbyllur se *"Zemra më dha lajme nga Zoti, pashë në ëndërr, ose Zoti më tha këtë e këtë"* ka rënë në kufër. *"E kush është më gabimtar i madh se sa ai që trillon rrenë ndaj Zotit, ose thotë: "Mua po më shpallet e nuk i është shpallur asgjë, ose se sa ai që thotë: "Do të thur diçka të ngjashme me atë që e ka zbritur Allahu".* [13]

Pejgamberi ynë në hadithe ka tërhequr vëmendjen në këtë pikë dhe ka thënë: *"Pas meje do të dalin 30 pejgamberë të rrejshëm. Bëni kujdes, se pas meje nuk ka më pejgamber".* [14]

Ai është njeriu më i lartë tek Allahu. Në hadith thuhet: *"Në ditën e kijametit unë jam sejjidi (zotëriu) i bijve të Ademit".* [15]

10. *33/Ahzab, 40*
11. *Buhari, Muslimi*
12. *Muslimi*
13. *6/En'am, 93*
14. *Buhari, Muslimi*
15. *Buhari, Muslimi*

Shënim: Në hadithe të sakta pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar që njerëzit ta ngrenë lart nga pejgamberët e tjerë. Shkaku i kësaj ose është nga ndonjë ndodhi e veçantë, ose për të ndaluar diskutimet e pavlefshme.

Ai ka muxhize të posaçme. Mrekullia e Kur'anit duke qenë në krye, ka Isranë dhe Miraxhin, ndarja e hënës në dysh, Selami që i dhanë gurët atij, bereqeti i gjërave që ai prekte etj...

Dobia më e madhe ndaj pejgamberëve është të dimë se Allahu neve na mëshiroi, nuk na la kokëbosh dhe të kuptojmë më mirë urdhërat dhe ndalesat duke parë shembull të gjallë dhe që ta falënderojmë për këto nimete (mirësi).

Besımı Në Dıtën E Ahıretıt (Botës Tjetër)

Besimi në ditën e ahiretit është nga bazat e imanit. Njëra nga bazat e imanit që theksohet më së shumti në Kur'an, është besimi në ahiret.

"Janë të bindur plotësisht për (jetën e ardhshme në) botën tjetër ahiretin". [1]

"Për Allahun, që s'ka tjetër pos Tij, patjetër Ai do t'ju tubojë në ditën e gjykimit për të cilën gjë nuk ka dyshim". [2]

Tek hadithi i Xhibrilit që e transmeton Buhariu me Muslimin, pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) besiminin në ditën e ahiretit, e ka quajtur nga bazat e imanit.

Çfarë do të thotë të besosh në ditën e ahiretit?

Do të thotë të besosh se bota do të shkatërrohet me ndodhinë e kijametit, se njerëzit do të ringjallen përsëri për të dhënë llogarinë e jetës që jetuan dhe se të gjithë do ta gjejnë atë që vepruan. Veçanërisht, të besosh pyetjet e varrit, skenat e kijametit (prezentimin para Zotit, llogarinë, urën e siratit etj.) të cilat kalojnë në Kur'an dhe Sunnetin e saktë.

Kur'ani kur e vërteton ahiretin dhe meselet në lidhje me ahiretin, ka përdorur metoda të ndryshme. Disa herë e vërteton në formën e refuzimit ndaj mushrikëve, disa herë duke krahasuar përmendjen e disa ngjarjeve që janë në univers dhe disa herë duke e paraqitur përpara muslimanëve si një shtyllë që duhet besuar.

"Dhe nuk ka dyshim se kijameti do të vijë patjetër dhe se Allahu me siguri do t'i ngjallë ata të varrezave (të vdekurit)". [3]

"E ata po thonë: "Kur do të jetë ky premtim (kijameti), po qe se jeni të vërtetë?" Thuaj: "Atë e di vetëm Allahu, e unë jam vetëm një qortues që ju bëj me dije!". [4]

1. *2/Bakara, 4*
2. *4/Nisa, 87*
3. *22/Haxh, 7*
4. *67/Mulk, 25-26*

"Ata thanë: "A pasi të bëhemi eshtra të kalbur, dhé e pluhur, a mos do të bëhemi krijesë e re e ringjallur?" Thuaj: "Edhe nëse të jeni gurë a hekur!" Ose ndonjë krijesë që ju duket e madhe! Ata do të thonë: "Kush do të na rikthejë neve në jetë?" Thuaj: "Ai që ju krijoi për të parën herë!". [5]

"Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë". [6]

Besimi në vdekje:

Dhe njëra nga meselet që ka lidhje me besimin ndaj ditës së ahiretit, është të besosh vdekjen dhe se të gjithë do ta shijojnë atë. Bashkë me këtë të besosh se të gjithë e kanë një exhel (afat) të kufizuar dhe se kur vjen exheli do të vdesin të gjithë pa bërë dallim.

"Secili njeri do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen ditën e kijametit". [7]

"S'ka dyshim se ti do të vdesësh, e edhe ata do të vdesin". [8]

"Çdo popull ka exhelin e vet, e kur t'u vijë exheli tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përngutet më parë". [9]

Pyetjet e varrit:

Dhe njëra nga meselet që ka lidhje me besimin ndaj ditës së ahiretit, është të besosh pyetjet që do të bëhen në varr dhe se personit sipas gjendjes së tij, do t'i zgjerohet varri ose do të dënohet. Në hadith thuhet se: *"Kur i vdekuri vendoset në varr, pasi të afërmit e tij ikin, ai dëgjon zërin e këmbëve të tyre. Pastaj atij i vijnë dy melekë. I thonë se "Çfarë thua rreth këtij njeriu (duke pasur për qëllim Rrasulullahun)?" Besimtari dëshmon se ai është i dërguari i Allahut. Ndërsa qafiri dhe munafiku thonë se "Nuk e di, unë thosha çfarë thoshin njerëzit". Pastaj goditet me çekiç prej hekuri. Dhe zërin e tij e dëgjojnë të gjithë krijesat përveç njerëzve dhe xhindëve".* [10]

5. *17/Isra, 49-51*
6. *36/Jasin, 79*
7. *3/Ali-Imran, 185*
8. *39/Zumer, 30*
9. *7/A'raf, 34*
10. *Buhari dhe Muslimi*

"Mua m'u shpall se ju do të pyeteni në varret tuaja". [11]

Kësaj pyetje të gjithë do t'i përgjigjen sipas jetesës në dynja dhe pas kësaj pyetje, varri ose do të bëhet një bahçe nga bahçet e Xhennetit, ose do të bëhet një gropë nga gropat e Xhehennemit.

Dënimi i varrit:

"E, sikur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): "Shpëtojeni pra vetveten (nëse mundeni)". "Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për Allahun, dhe ndaj argumenteve të Tij ishit kryeneç". [12]

Ne e dimë se dita që melaiket marrin shpirtra nuk është kijameti. Nga fjala *"Tash përjetoni dënimin"* kuptohet se do të përjetojnë dënim në varrin që do të hyjnë.

"Dhe Allahu e shpëtoi atë (besimtarin) prej të këqijave që i kurdisën, ndërsa ithtarët e faraonit i përfshiu dënimi më i keq. Atyre u ekspozohet zjarri mëngjes e mbrëmje, e ditën e kijametit (u thuhet engjëjve): "Ithtarët e faraonit futini në dënimin më të rëndë!". [13]

Para se të bëhet kijameti, ithtarëve të faraonit u ekspozohet zjarri mëngjes e mbrëmje. Nga ky ajet kuptohet qartë se ata dënohen dhe ky është dënimi i varrit, sepse nuk ka fazë tjetër.

Pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në hadithe që arrijnë gradën mutevatir, na lajmëron për pyetjet e varrit, dënimin dhe mirësinë. Pas namazit kërkonte mbrojtje nga katër gjëra dhe i urdhëronte njerëzit që të kërkonin edhe ata mbrojtje dhe njëra nga këto është dënimi i varrit. [14]

Në çdo xhenaze tërhiqte vëmendjen për dënimin e varrit dhe i thoshte njerëzve që të kërkonin mbrojtje nga ai. Në një

11. *Buhari dhe Muslimi*
12. *6/En'am, 93*
13. *40/Gafir, 45-46*
14. *Buhari dhe Muslimi*

hadith thotë: *"Kërkoni falje për vëllain tuaj. Sepse ai po pyetet në varr"*. Përmendte disa vepra të cilat janë shkak për dënimin e varrit (mbartja e llafeve, zinaja, moskujdesi ndaj urinës etj.). Përmendte disa vepra të cilat janë shkak për mbrojtjen nga dënimi i varrit. Shpesh herë, duke shpjeguar detajet e varrit, lajmëronte detajisht format e dënimit dhe mirësisë. Qindra hadithe të sakta në lidhje me varrin tregojnë se çështja arrin deri në gradën e muteuatirit manevi (kuptimor). Megjithë këtë është shumë interesant pretendimi i disave që nuk e pranojnë dënimin e varrit, duke thënë se dënimi i varrit vjen me hadithe ehade, kështu që hadithi ehad është i dyshimtë në itikad. Ajetet e Kur'anit e kanë cekur dënimin e varrit edhe pse nuk është në një mënyrë të qartë, ndërsa Sunneti e ka vërtetuar me mënyrë mutevatir dënimin e varrit dhe e ka nxjerrë këtë në gradë të bindshme.

Mirësia e varrit:

Në hadith thuhet: *"...Kur besimtari i përgjigjet pyetjes për të cilën pyetet, nga qielli vjen një zë i tillë: "S'ka dyshim që robi Im tha të vërtetën. Atë visheni me veshje nga Xhenneti, hapini atij një derë nga Xhenneti"*.[15] Ky hadith dhe hadithe të ngjashme me këtë, janë argument se sipas rezultatit të pyetjeve në varr, besimtarëve u jipen mirësi.

15. *Ahmedi, Ebu Davudi*

Shenjat e Kijametit

Para fillimit të jetës së ahiretit do të bëhet kijameti i dynjasë. Jeta e dynjasë do të përfundojë plotësisht dhe do të fillojë një botë e re e përgjithmonshme. Në Islam koha e kijametit është përcaktuar.

"Të pyesin ty (Muhammed) për çastin (e kijametit) se kur do të ndodhë ai. Thuaj: "Atë e di vetëm Zoti im, kohën e tij nuk mund ta zbulojë kush pos Tij (e sjell kijametin pa e hetuar asnjë nga krijesat). Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë. Ai (kijameti) nuk ju vjen ndryshe, vetëm befas". [1]

Ky ajet thotë se kohën e kijametit nuk mund ta dijë kush përveç Allahut. Tregon se edhe pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) nuk është i përjashtuar që të mos i përgjigjet pyetjeve që pyeten në këtë temë në lidhje me kohën e kijametit. Bashkë me këtë, Allahu për atë (ditë) ka bërë disa shenja. Me ndodhjen e këtyre shenjave, kuptohet se do të bëhet kijameti.

"Po ata a presin tjetër, pos kijametit, i cili do t'u vijë befas, e parashenjat e tij tashmë kanë ardhur." [2]

Në hadithin mesh'hur (të njohur) të Xhibrilit, kur Xhibrili e pyet pejgamberin (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) se; *"kur do të ndodhë kijameti"*, ai i thotë se *"ai që pyetet nuk është më i ditur nga ai që pyet"*. Pastaj ai i thotë se *"Atëherë më lajmëro për shenjat e tij"*. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i thotë; *"kur robëresha të lindë zotëriun e vet, kur të shihen barinjtë këmbë zbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e godinave të mëdha..."*.

Ky ajet dhe hadith, është argument se kijameti ka shenjat e tij edhe pse nuk i dihet koha se kur do të ndodhë.

1. *7/A'raf, 187*
2. *47/Muhammed, 18*

Shenjat e vogla:

Shenjat e vogla janë lajmëruese për shenjat e mëdha që do të ndodhin menjëherë para se të bëhet kijameti. Kur shtohen shenjat e vogla që Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) ka lajmëruar, afrohet ndodhia e shenjave të mëdha. Disa prej shenjave të vogla janë:

Siç kalon edhe në hadithin e Xhibrilit që; kur robëresha të lindë zotëriun e vet, kur të shihen barinjtë këmbë zbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e godinave të mëdha.

Kur të keqpërdoret amaneti, prite kijametin! *"Beduini vazhdoi: "Si keqpërdoret amaneti?" Ka thënë: "Kur çështjet me rëndësi t'u besohen atyre që nuk janë kompetentë."* [3]

Nuk bëhet kijameti pa luftuar dy grupe duke dhënë shumë humbje me njëra-tjetrën, të cilët e kanë davën e njëjtë, pa dalë tridhjetë dexhxhalë që pretendojnë se janë pejgamberë, pa u shtuar vdekjet, pa ardhur koha që sadakadhënësi nuk do ta gjejë nevojtarin e sadakasë, pa ardhur koha që nevojtarët do të garojnë nëpër ndërtesa të larta dhe kur njerëzit të kalojnë pranë varrezave të thonë ah sikur të isha unë këtu (pra, në varr). [4]

Nuk do të bëhet kijameti pa luftuar ju me çifutët. Në një transmetim tjetër thuhet që; pa luftuar me turqit nuk do të bëhet kijameti. [5]

Shenjat e mëdha:

Në ajet thuhet: *"Momenti (kijameti) është afruar, e hëna është çarë (në dysh)"*. [6] Në transmetime të sakta kalon se hëna është çarë në kohën e pejgamberit tonë.

- Allahu Teala në suren Kehf na lajmëron se Dhulkarnejni i

3. *Buhari*
4. *Buhari*
5. *Buhari*
6. *54/Kamer, 1*

pengoi Jexhuxhët dhe Mexhuxhët me një pendë. Nëna jonë, Zejnebja transmeton kështu: *"Një ditë pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) zgjohet nga gjumi dhe thotë kështu: "Mjerë për arabët për shkak të sherrit që po afrohet. Sot në pendën e Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve u hap një vrimë. Nëna jonë, Zejnebja e pyet se "A do të shkatërrohemi edhe kur brenda nesh ka njerëz vepërmirë?"*. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i thotë: *"Po, kur të shtohet pisllëku (sidomos zinaja)"*. Siç kalon edhe në transmetime të sakta që Jexhuxhët dhe Mexhuxhët janë shumë në numër, saqë kur të pinë ujë te lumi do ta mbarojnë atë. Dhe së fundi ata do të rrethojnë Isain (alejhis-selam) dhe besimtarët dhe Allahu do t'i shkatërrojë ata (Jexhuxhët dhe Mexhuxhët). Saqë në rruzullin tokësor nuk do të mbesë vend që të mos ketë trupin e tyre. Pastaj Allahu do ta pastrojë rruzullin tokësor dhe do ta begatojë.

▪ Në transmetime të sakta lajmërohet se dexhxhali do të dalë para kijametit. Është me një sy qorr, që e ka syrin të dalë si një kokërr rrushi, flokët të dredhura, që e shëtit rruzullin tokësor në një kohë shumë të shkurtër, që sjell shi, që i nxjerr thesaret nga toka dhe që pretendon se është zot duke i treguar njerëzve Xhennetin dhe Xhehennemin e rrejshëm. Isai (alejhis-selam) do të luftojë me atë dhe do ta vrasë.

Ardhja e Mehdiut që do të bëhet emiri i muslimanëve i cili është me perjardhje nga pejgamberi ynë dhe zbritja e Isait (alejhis-selam).

Dalja e kafshës nga toka të cilës i thuhet Dabbe.

Lindja e diellit nga perëndimi.

Marja e shpirtrave të muslimanëve nga një erë që do të jetë në një kohë shumë të shkurtër para kijametit dhe plasja e kijametit mbi njerëzit e këqinj.

Disa pika në lidhje me shenjat e kijametit

Shenjat e mëdha do të ndodhin njëra pas tjetrës pa kaluar

shumë kohë. Në hadith thuhet se *"Shenjat e mëdha janë si rruazat e renditura njëra pas tjetrës. Sapo këputet fija, rruazat dalin menjëherë njëra pas tjetrës"*.[7]

Nëse shenjat e mëdha janë vërtetuar në transmetime të sakta, duhet t'i pranosh këto pa bërë komente logjike. Sepse njerëzit e çdo periudhe i kanë komentuar në periudhën e vet dhe në drejtim të perceptimeve të tyre, por asnjëri nuk ia ka qëlluar.

Qëllimi tek transmetimet në lidhje me kijametin dhe me shenjat e tij, nuk është një ndodhi dëfrimore ose të formojë një ndodhi kulturore, por është që t'i shpëtojë njerëzit nga gafleti (pakujdesshmëria) dhe t'i nxisë në vepra të mira. Allahu ajetet e kijametit i ka zbritur që të të tërheqë vëmendjen ndaj gafletit të mushrikëve dhe t'i nxisë besimtarët më shumë në vepra të mira. Kur një sahabi e pyet pejgamberin (sal-lAlllahu alejhi ue sel-lem) për kijametin, ai duke e theksuar këtë pikë i thotë se *"Çfarë ke përgatitur për atë?"*. Çdo person duhet të interesohet për vdekjen e tij e cila mund t'i vijë nga momenti në moment dhe më e dobishme është që të përgatitet për atë se sa të interesohet për kijametin.

7. *Imam Ahmedi*

Kijameti, fryerja e Surit, Ringjallja dhe Tubimi

Kur të mbarojë exheli i dynjasë i fryhet Surit dhe bëhet kijameti. *"Dhe i fryhet Surit..."*. [1] Fryerja e Surit përsëritet në shumë vende në Kur'an. Në Kur'an, plasja e kijametit dhe ndodhitë që do të ndodhin, shpjegohen me skena të ndryshme. Në hadith thuhet se *"Kush dëshiron ta dijë kijametin sikur e ka parë me sy, le të lexojë suren Tekvir, Inshikak dhe Infitar"*. [2]

Pas kësaj i fryhet Surit përsëri dhe njerëzit nxirren nga varret e tyre siç mbijnë bishtajorët nga toka. *"Përveç një kocke toka e tret njeriun. Pastaj njeriu bëhet përsëri nga ajo kockë"*. [3] *"E thonë: "Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej ku ishim të shtrirë në varre?" E, kjo është ajo që premtoi Zoti dhe vërtetuan të dërguarit"*. [4] Dhe kjo është Ringjallja.

Pastaj njerëzit mblidhen në fushën e mahsherit. Ndërsa ngjarjes në të cilën njerëzit mblidhen në një vend për të dhënë llogarinë e për të marrë hakun, i thuhet Tubim. Në hadith thuhet se *"O njerëz, ju vërtet do të tuboheni tek Allahu i Madhërishëm të zbathur, të zhveshur dhe të pa bërë synet". Nëna jonë Aishja e pyet se "A nuk do ta shikojnë njëri-tjetrin ata o i dërguari i Allahut?" Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) i thotë "Oj Aishe, atë ditë secili është në hall për veten e vet"*. [5]

Kjo gjë është përmendur në vende të ndryshme të Kur'anit. Njeriu do të ringjallet siç u krijua në ditën e parë. *"Na erdhët ashtu, siç ju krijuam juve herën e parë"*. [6]

Atë ditë njerëzve do t'u afrohet dielli shumë afër. Dhe njerëzit do të jenë të zhytur në djersë sipas gjynaheve që kanë. Dikush do të zhytet në djersë deri tek gjunjtë, dikush deri në

1. *18/Kehf, 99*
2. *Ahmedi, Tirmidhiu*
3. *Muslimi*
4. *36/Jasin, 52*
5. *Buhari, Muslimi*
6. *18/Kehf, 48*

brez e dikush deri në gojë. Kjo gjendje duke vazhduar e tillë, njerëzit nga një anë do të presin të shastisur se çfarë do të ndodhë, nga një anë do të kërkojnë dikë që t'i shpëtojë nga kjo gjendje dhe nga një anë tjetër asnjëri duke mos e marrë përsipër përgjegjësinë e tjetrit, të gjithë do të mundohen t'ia hedhin përgjegjësinë tjetrit. Ata që kanë qenë në dynja të afërt me njëri-tjetrin do të kërkojnë vend për t'u larguar nga njëri-tjetri. *"Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet. Prej nënës dhe prej babait të vet. Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet".* [7]

"E kur i fryhet surit, atëherë, në atë ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyesë kush për njëri-tjetrin". [8]

Gjendjet e njerëzve do të reflektojnë në fytyrat e tyre. Disa fytyra do të shndrisin, do të rrinë nën hijen e arshit të Rrahmanit, ndërsa disa fytyra të tjera do t'i kaplojë poshtërimi. Ky ajet mjafton për të shpjeguar tmerrin e asaj dite:

"O ju njerëz, ruajuni dënimit nga Zoti juaj, sepse dridhja pranë katastrofës së kijametit është një llahtari e madhe. Atë ditë, kur ta përjetoni atë, secila gjidhënëse braktis atë që ka për gjiri dhe secila shtatëzënë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, por ata nuk janë të dehur, porse dënimi i Allahut është i ashpër". [9]

Ekspozimi dhe Llogaria

Ekspozimi është dalja e njerëzve para Allahut Teala.

"Dhe ata do të ekspozohen para Zotit tënd të rreshtuar". [10]

"Atë ditë ju do të ekspozoheni (para Zotit), duke mos mbetur fshehtë asnjë sekret juaji". [11]

Pastaj fillon llogaria. Llogaria është pyetja e njerëzve një nga

7. *80/Abese, 34-37*
8. *23/Mu'minun, 101*
9. *22/Haxh, 1-2*
10. *18/Kehf, 48*
11. *69/Hakka, 18*

një për jetesën, mirësinë, për çdo gjë të madhe apo të vogël që i është dhënë atyre.

"Ne patjetër do t'i marrim në përgjegjësi ata, të cilëve u është dërguar (pejgamber), e do t'i marrim në pyetje edhe të dërguarit". [12]

"Pasha Zotin tënd, të gjithë ata do t'i marrim në përgjegjësi". [13]

Njerëzit si fillim do të pyeten për të drejtën e Allahut që është namazi, ndërsa për të drejtën e njerëzve do të pyeten për gjakun. Në hadith thuhet se; *"Njeriu nuk do të hedhë hap përpara nga vendi i llogarisë pa u pyetur për pesë gjëra; se ku dhe si e kaloi jetën e tij, si e përdori dijen e tij, si e fitoi pasurinë e tij, si e harxhoi atë (pasurinë) dhe se si e kaloi rininë e tij".* [14]

Njerëzit janë shtresa shtresa kur të merren në llogari. Ata të cilët e kanë kontrolluar veten duke i kërkuar llogari vetes në dynja, llogaria e tyre do të jetë e lehtë. Ndërsa ata të cilët kanë jetuar, kanë lëvizur pa kontroll në dynja, llogaria e tyre do të jetë shumë e vështirë. Sepse Allahu Teala nuk do t'ia presë llogarinë shkurt për shkak se janë xhehennemlinj, por do t'i pyesë një nga një dhe në mënyrë të detajuar për ato që kanë bërë, që ta përjetojnë mirë tmerrin e asaj dite. Atë ditë disa njerëz pohojnë fajet e tyre. *"Ku janë ata që pos Zotit i adhuronit?" Ata thonë: "Kanë humbur prej nesh" dhe ashtu dëshmojnë për vete se ishin qafirë".* [15]

Disa të tjerë as që nuk e dinë se në ç'gjendje kanë qenë në dynja. *"Përkujto ditën kur Ne i tubojmë të gjithë dhe u themi atyre që i shoqëruan: "Ku janë ata të shoqëruarit tuaj që i trillonit?". Atëherë (pas atij sprovimi) përgjigje tjetër s'u mbetet përveç të thonë: "Për Allahun, o Zoti ynë, ne nuk ishim mushrikë!"* [16]

Disa të tjerë do të mundohen t'i mohojnë fajet që kanë bërë.

12. *7/A'raf, 6*
13. *15/Hixhr, 92*
14. *Tirmidhiu*
15. *7/A'raf, 37*
16. *6/En'am, 22-23*

"Sot Ne ua mbyllim gojët atyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan". [17]

Disa të tjerë do të hyjnë në Xhennet pa u marrë në llogari. Ata janë njerëz që nuk kërkojnë t'u bëhet rukje, nuk i besojnë fatit të keq dhe i mbështeten vetëm Zotit të tyre. [18]

17. *36/Jasin 65*
18. *Buhari, Muslimi*

Dhënia e Librit

Njerëzit pasi të japin llogarinë e veprave që kanë bërë në dynja, të gjithë atyre i jepen fleushka në të cilat janë shkruajtur këto vepra. Njerëzit marrin librin e veprave sipas llojit të veprave që përmbajnë. *"E përsa i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta. Ai do të llogaritet me një llogari të lehtë. Do të kthehet tek familja e vet i gëzuar. E përsa i përket atij që libri i vet i jepet pas shpinës. Ai do t'i ndjellë vetes shkatërrim. Dhe do të hyjë në zjarr të ndezur fort".* [1]

"Secilit njeri ia kemi ngjeshur në qafë fluturaken (shënimin - për veprimin) e tij, e në ditën e gjykimit, Ne do t'ia prezentojmë atij libër të hapur. "Lexo librin tënd, mjafton të jesh sot vetë llogaritës i vetvetes". [2]

Vendosja e Mizanit (Peshores)

Mizani do të peshojë gjynahet dhe veprat e mira në ditën e gjykimit. Është një peshore që i përshtatet madhështisë së asaj dite.

"Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrre të melit Ne do ta sjellim atë". [3]

"Atë ditë peshimi është i drejtë. Atij që i rëndohen peshojat, ata janë të shpëtuar. Kujt i vijnë lehtë peshojat, ata e humbën vetveten, ngase i refuzuan argumentet Tona me të padrejtë". [4]

Është e qëndrueshme në Kur'an dhe Sunnet që në Mizan do të peshohet diçka, që njerëzit do të ndahen si të shpëtuar e të shkatërruar sipas peshës të lehtë e të rëndë të gjërave që do peshohen, ndërsa gjëja që do të peshohet në peshore është e diskutueshme. Disa dijetarë thonë se do të peshohet vetë vepra, disa thonë se do të peshohet sevapi dhe gjynahu, disa

1. *84/Inshikak, 7-12*
2. *17/Isra, 13-14*
3. *21/Enbija, 47*
4. *7/A'raf, 8-9*

thonë se do të peshohet libri i veprave dhe disa thonë se do të peshohen njerëzit bashkë me veprat e tyre. Çdo grup ka paraqitur disa nasse që e mbështesin mendimin e secilit. Ndërsa disa dijetarë të tjerë kanë mbledhur mesin e transmetimeve dhe thonë se të gjitha këto do të peshohen. Dhe ky është mendimi që parapëlqehet.

▪ Hadithi që merret si argument për peshimin e vetë veprës: *"Dy fjalë janë të lehta për gjuhën, të rënda në peshojë dhe të dashura tek i Gjithëmëshirshmi: Subhanallahi ue bi hamdihi, subhanallahi'l-Adhim"*. [5]

▪ Hadithi që merret si argument për peshimin e fletave dhe kartave: *"99 regjistrat me gjynahe të një personi nga ky ummet dhe karta mbi të cilën është shkruajtur shehadeti do të peshohen në peshore. Shehadeti do të peshojë më shumë se regjistrat"*. [6]

▪ Hadithet që merren si argument për peshimin e personit bashkë me veprat: *"Në ditën e gjykimit sillet një person i shëndoshë dhe trupmadh. Ai tek Allahu nuk rëndon as sa një krahë mize"*. [7] Ibn Mes'udi ishte një sahabi i dobët. Një ditë hipën në pemë dhe sahabët kur shohin se sa të holla i kishte kofshat, u habitën dhe qeshën. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) u thotë që: *"U habitët me kofshat e tij apo jo? Uall-llahi ai në peshore është më i rëndë se Uhudi"*. [8]

Ura e Siratit

Ura e siratit është hak. Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në shumë hadithe na ka lajmëruar për atë. Në Sahihajn [9] kalon se: *"Sirati është vendosur mbi Xhehennem. I pari që do kalojë mbi të, jam unë dhe ummeti im"*. Sahabiu Ebu Said ka thënë: *"Sipas asaj që më ka mbërritur mua, ajo (ura e Siratit) është më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata"*.

5. *Buhari, Muslimi*
6. *Ahmedi, Tirmidhiu*
7. *Buhari*
8. *Ahmedi*
9. *Sahihajn do të thotë dy sahihët (të saktët). Kur thuhet se hadithi kalon te Sahihajni, është për qëllim Buhari me Muslimin. (shënim i përkthyesit)*

Njerëzit kalojnë mbi të sipas gjendjes së punëve të tyre. Qafirët bien në Xhehennem pa e kaluar atë. Ndërsa besimtarët kalojnë mbi të sipas gradave të tyre dhe në hadithe kalon se disa do ta kalojnë urën e Siratit si rrufe, disa sa hap e mbyll sytë, disa si një kalorës i shpejtë, disa duke ecur, disa këmba dorës, disa duke u zvarritur, disa duke ngecur nëpër kanxha.

Shënim: Në suren Merjem thuhet kështu: *"Nuk ka asnjë prej jush që të mos kalojë mbi të (mbi Xhehenem); kjo është me Zotin tënd një Vendim i cili duhet të përmbushet. Pastaj, Ne do t'i shpëtojmë ata që e patën frikë Allahun dhe qenë të përkushtuar e të bindur ndaj Tij dhe do t'i lëmë Dhalimunët (keqbërësit, politeistët) atje (në Xhehenem) të poshtëruar në gjunjë".* [10]

Sipas dhahirit të këtij ajeti, besimtarët, qafirët të gjithë do të kalojnë në Xhehennem. Se çështë qëllimi nga ky kalim, ndërmjet selefëve dhe sahabëve ka pasur diskutim.

Sipas një tefsiri është kalimi mbi urën e Siratit, sepse ura e Siratit është e vendosur mbi Xhehennem. Dhe të gjithë do kalojnë mbi të. Kështu që ai që kalon mbi të, ka kaluar mbi Xhehennem. Dhe ky është mendimi që parapëlqehet.

Sipas një tefsiri tjetër të gjithë do të hyjnë aty, por zjarri për besimtarët do të bëhet i fohtë dhe shpëtim dhe do të dalin nga aty pa e ndjerë fare.

Sipas një tefsiri tjetër, ky është një ajet i përgjithshëm. Kur paraqesim ajetet e tjera përpara syve, nuk do të kalojnë aty.

Havuzi (Burimi)

Në ahiret ka një burim që është i veçantë për pejgamberin (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Hadithet në lidhje me këtë arrijnë gradën mutevatir. Në shumë hadithe që kalojnë tek Buhariu dhe Muslimi veçoria e tij (burimit) kalon kështu: *"Gjerësia është sa Jemeni me San'a. Numri i ibrikëve të tij është sa yjet në qiell. Uji i tij është më i ëmbël se mjalti, më i bardhë se qumështi, më me aromë të mirë se misku. Ai që pin një herë aty*

10. 19/Merjem, 71-72

nuk ka etje më kurrë. I pari që do të pijë nga ai është Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem). Njerëzit do t'i vijnë për vizitë Rrasulullahut aty. Në atë moment melaiket një grup njerëzish do t'i kthejnë nga rruga. Pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sellem) do të thotë: "O Zot, ata janë ummeti im". Allahu do t'i thotë se. *"Ti nuk e di se çfarë risish nxorrën ata pas teje".* Dhe pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) do të thotë: *"Turp u qoftë atyre që bënë ndryshime pas meje".*

Shefati (Ndërmjetësimi)

Tema e shefatit është siç kaloi në meselet në lidhje me teuhidin.

Xhenneti dhe Xhehennemi

Hyrja në Xhennet dhe Xhehennem është përfundimi i punëve të përgjithshme në lidhje me ahiretin, është pika e fundit ku të gjithë gjejnë vendimin e tyre. Besimi në Xhennet dhe Xhehennem është të besosh se ato janë hak, se ekzistojnë dhe se janë të përgjithmonshëm. *"Atëherë ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët. E, përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në Xhennete në të cilët rrjedhin lumenj".* [1]

Kur'ani dhe Sunneti mutevatir janë të mbushura me të vërtetën se Xhenneti dhe Xhehennemi janë hak, se të gjithë pejgamberët, popujve të tyre ia tërhiqnin vëmendjen me atë, se në Xhennet ka mirësi dhe se në Xhehennem ka dënim. Disa injorantë që nuk e njohin veten e tyre, thonë se Xhenneti dhe Xhehennemi janë imagjinata të Rrasulullahut (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), ai me këto kishte për qëllim që të edukonte njerëzit. Kjo gjë, nuk është gjë tjetër vetëm se tepricë në injorancë dhe në kufër ndaj Kur'anit dhe Sunnetit.

Sipas itikadit të Ehli Sunnetit, Xhenneti dhe Xhehennemi në këtë moment ekzistojnë dhe po presin banorët e tyre. Në shumë ajete është përdorur shprehja *"Është i përgatitur për muttakilerët (të devotshmit, të ruajturit)"* për Xhennetin dhe shprehja *"Është përgatitur për qafirët"* për Xhehennemin. Veçanërisht Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në ndodhinë e Miraxhit tregon se e ka parë Xhennetin dhe Xhehennemin.

Sipas Ehli Sunnetit Xhenneti dhe Xhehennemi janë ebedi (të përjetshëm). Dhe të dy banorët e tij pasi të futen aty, nuk do të zhduken, por do të vazhdojnë në pafundësi.

"Allahu i ka mallkuar jobesimtarët dhe për ta ka përgatitur zjarr të ndezur fort. Aty do të mbesin përgjithmonë". [2]

1. *2/Bakara, 24-25*
2. *33/Ahzab, 64-65*

"E ata, muttakilerët (të cilët iu ruajtën mosbesimit dhe punëve të këqija) janë në Xhennete e mes burimeve. Ata aty nuk i godet kurrfarë lodhje dhe nuk do të nxirren kurrë prej tij". [3]

Disa mesele në lidhje me ditën e ahiretit

Shtylla e imanit e cila theksohet më së shumti në Kur'an, është imani ndaj Allahut dhe ditës së Ahiretit. Duke u nisur nga kjo, mbështetësit e dialogut pretendojnë se një person që beson Allahun dhe ditën e ahiretit, edhe pse nuk i beson shtyllat e tjera do të hyjë në Xhennet. Dhe në lidhje me këtë përmendin nasse, se ata që besojnë Allahun dhe ditën e ahiretit do të hyjnë në Xhennet. *"Vërtet, ata që besuan, nga çifutët, krishterët, sabejët, kush besoi prej tyre (sinqerisht) Allahun dhe botën tjetër dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë as nuk kanë përse të pikëllohen".* [4] [5]

Si përgjigje themi që: Kur'ani, çifutët dhe kristianët atë ditë dhe sot për shkak të itikadit të tyre, i ka emërtuar qafirë në një mënyrë të hapur dhe ka theksuar se janë në Xhehennem përgjithmonë. Të gjitha argumentet e kësaj kaluan në mësimin *"Miqësia dhe Armiqësia"*. Kur mendohet nën dritën e këtyre ajeteve, del në pah se Islami ua quajti të pavlefshme çifutëve dhe kristianëve besimin e tyre në Allahun dhe botën tjetër. E vërteta është se ata nuk kishin besuar në Allahun dhe botën tjetër. Ata patën besuar një Allah që ka fëmijë, që është i treti i treve dhe besuan një Xhennet që i përket vetëm atyre. Është e qartë që Kur'ani nuk e pranon një besim të tillë.

Kur'ani në ajete të ndryshme ka theksuar se ata që nuk besojnë pejgamberët (Nisa 4/150-151), librat, kaderin, janë qafirë.

3. *15/Hixhr, 45,47*
4. *2/Bakara, 62*
5. *Tefsiri i këtij ajeti është kështu: "Ali ibn Ebi Talha transmeton prej ibn Abbasit që lexoi ajetin e përmendur dhe tha: Pas kësaj Allahu i Madhërishëm e zbriti ajetin: "E kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dështëruarit". Kjo që tha ibn Abbasi flet se pranohet vetëm rruga dhe vepra e cila është në përputhje me sheriatin e Muhammedit (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem), çdonjëri që e ka pasuar pejgamberin e kohës së vet, ka qenë në rrugën e drejtë dhe të shpëtimit. Kështu, çifutët kanë qenë pasuesit e Musait alejhis-selam që gjykonin sipas Teuratit në kohën e tyre. (Tefsiri i Ibn Kethirit V. 1, f: 224. (shënim i përkthyesit).*

Madje edhe sikur ta pranojmë se këta besojnë në Allahun dhe botën tjetër, këta nuk kanë iman si domosdoshmëri e ajeteve të tjera (p.sh; besimi në pejgamberë, libra etj.).

Besimi në botën tjetër nuk është vetëm një teori, por është një praktikë e vërtetë që realizon shumë qëllime të sheriatit.

Allahu, njerëzit që kanë qenë robër të epshit, që kanë jetuar në periudhat më të errëta të injorancës, me ngulitjen e imanit për botën tjetër i ka marrë nën kontroll ata dhe kështu ka mundësuar ndërgjegjshmërinë e takvasë (devotshmërisë). Shumica e ajeteve të para që zbritën, flasin për kijametin, Xhennetin-Xhehennemin, shpërblimin dhe dënimin. Kjo metodë, pra metoda e shpërblimit dhe dënimit edhe nga ana e shkencës, është pranuar si metoda më e mirë. Dhe kjo në Islam është tërheqja e vëmendjes dhe përgëzimi, pra është vetë Xhenneti dhe Xhehennemi.

Ata që besojnë, si domosdoshmëri e imanit të tyre, u bëhet zullum dhe tortura nga ehli shirku. Allahu, brezin e parë që ishte në këtë gjendje, e ngushëlloi me hakmarrjen në jetën e përjetshme dhe me të vërtetën se do të gjejnë shpërblimin e çdo gjëje. Allahu robërve të Tij, më tepër se dynjanë u ka premtuar Xhennetin. Për këtë shkak, brezi i parë, edhe në humbje të pasurisë edhe në tortura, nuk u treguan të plogët, përkundrazi u kapën më shumë ndaj fesë së tyre. Lëvizjet Islame, kur t'i shqyrtojnë meselet e itikadit, mos t'i shqyrtojnë si një teori larg ngjarjeve, por t'i shqyrtojnë të gjalla siç kalojnë në Kur'an për brezin e parë dhe si praktike. Dhe këtë fjalë duhet ta bëjnë menhexh: *"Siç u bë islah (u përmirësua) fillimi i këtij ummeti, po ashtu bëhet islah edhe fundi i tij"*. (Imam Maliku)

Dalja e muvahhidëve (njësuesve) nga Xhehennemi pasi të qëndrojnë një kohë në të për shkak të gjynahëve të tyre, është një mirësi e Allahut ndaj këtij ummeti dhe muvahhidëve. Është kusht që njeriu t'i besojë kësaj të vërtete. Që të reflektojë kjo e vërtetë, përsëri duhet të jetë në mënyrën që do sheriati. Sheriati me këtë të vërtetë, synon që njeriu mos të bëhet

i pashpresë kur bën gjynah dhe vazhdimisht t'i kërkojë falje Allahut. Kështu që robi falënderon vazhdimisht duke menduar rahmetin (mëshirën) e Allahut ndaj këtij ummeti. Por nëse kjo e vërtetë bëhet këllëf për gjynahet, pra nëse gjynahet bëhen në një mënyrë të rehatshme, atëherë devijohet nga qëllimi dhe gjallërohet mendimi i mallkuar i çifutëve: *"Ata edhe thanë: "Neve nuk do të na kapë zjarri vetëm për disa ditë të numëruara"*. [6]

"E atë (e bënin) ngase thonin: "Neve nuk do të na djegë zjarri vetëm për pak ditë të numëruara, e ajo që shpifën për fenë e tyre, i mashtroi keq". [7]

6. *2/Bakara, 80*
7. *3/Ali Imran, 24*

Besımı Në Kader

Të besosh në kada dhe kader është nga bazat e imanit. *"Ne çdo send e kemi krijuar me kader (masë të caktuar)".* [1]

"I cili krijoi dhe përsosi. Dhe i cili bëri takdir (përcaktoi) e orientoi". [2]

Përsëri në hadithin mesh'hur të Xhibrilit pejgamberi ynë (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) kur shpjegoi imanin tha: *"Të besosh se hajri dhe sherri janë nga Allahu"*. Besimi në kader është të besosh se Allahu di çdo gjë, që nga gjëja më e vogël, e deri tek gjëja më e madhe që ka ndodhur e që do të ndodhë në univers, se çdo gjë bëhet me dëshirën e Tij, se është e shkruajtur pranë Tij dhe se ndodh me anë të krijimit të Tij. Besimi në kader ka katër shkallë:

Dija e Allahut absolute dhe ezelije (parazanafillës): Kjo shkallë është të besosh se Allahu çdo gjë që ka ndodhur dhe që do të ndodhë, e ka përfshirë me dijen e Tij absolute dhe ezelije. *"Për ta ditur ju se Allahu ka fuqi për çdo send dhe që me të vërtetë Allahu ka përfshirë çdo send me dijen e vet".* [3]

"Allahu është i gjithëdijshëm për çdo send". [4]

Edhe një nga argumentet më të mira për dijen absolute të Allahut është ndodhia e Musait me Hidrin që kalon në suren Kehf. Tek Buhariu kalon se u pyet pejgamberi për fëmijët e mushrikëve që vdesin të vegjël dhe ai duke thënë se *"Allahu e dinte se si do të vepronin ata nëse do të jetonin"* ka theksuar për dijen absolute të Allahut.

Dyshimi tek dija absolute e Allahut është nga shkaqet e kufrit kat'i. Kjo është të përgënjeshtrosh qindra ajete të Kur'anit. Kur Ibn Umeri (radijAll-llahu anh) dëgjon se kanë dalë disa që thonë se çdo gjë ndodh papritur, pra ndodh jashtë dijes së

1. *49/Kamer, 54*
2. *87/A'la, 2-3*
3. *65/Talak, 12*
4. *2/Bakara, 231*

Allahut, i bën tekfirin atyre duke thënë: *"I thuani atyre se Ibn Umeri është larg tyre, dhe përderisa ata nuk i besojnë kësaj, edhe sikur të japin flori sa mali i Uhudit nuk u pranohet"*. Dhe më pas ka përmendur ndodhinë mesh'hure të Xhibrilit.

Shkrimi: Të besosh se Allahu të gjithë këtë dije dhe ato që do të ndodhin i ka shkruajtur në Levhi mahfudh, se dija e çdo gjëje ekziston në atë libër. *"Zotit tënd nuk mund t'i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, e të mos jetë në librin e sigurt"*. [5]

Imam Muslimi transmeton nga Abdullah ibn Amr ibn el-Asi se *"Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka thënë kështu: "Allahu e shkruajti kaderin e çdo gjëje 50 mijë vjet para se të krijonte tokën dhe qiejt dhe arshi i Tij ishte mbi ujë"*.

Ebu Davudi transmeton nga Ubade ibn Samiti se pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) ka thënë kështu: "Kur Allahu krijoi kalemin për herë të parë i tha atij: *"Shkruaj". Ai i tha çfarë të shkruaj, o Zot?". Allahu i thotë se: "Shkruaj çdo gjë që do të ndodhë deri në kijamet"*.

Shënim: Këtij hadithi nga ana gjuhësore mund t'i jepet kuptim në dy mënyra:

I pari: Kur Allahu krijoi kalemin, për herë të parë i tha atij: *"Shkruaj"*.

I dyti: Allahu (gjënë) e parë krijoi kalemin dhe i tha që... [6]

Pyetje: Besimi në shkrim është të besosh se çdo gjë do të ndodhë siç është e shkruajtur në libër, që nuk mund të vonohet e as të ngutet; Siç është exheli dhe rrisku. *"Çdo popull ka afatin/exhelin (e caktuar), e kur të vijë afati i tyre, ata nuk mund ta vonojnë as për një moment e as ta ngutin"*. [7]

Bashkë me këtë, në disa hadithe është transmetuar se bërja

5. *10/Junus, 61*
6. *Tek kuptimi i parë; ka kuptimin se kalemi nuk është krijesa e parë, ndërsa tek kuptimi i dytë ka kuptimin se kalemi është krijesa e parë që është krijuar. (shënim i përkthyesit).*
7. *10/Junus, 49*

e disa veprave zgjasin jetën, zgjerojnë rriskun. Tek Buhariu dhe Muslimi kalon se: *"Kush dëshiron që t'i zgjerohet rrisku, që t'i zgjatet exheli le të ruajë farefisin"*. Si duhet t'i kuptojmë këto të dyja?

Si përgjigje themi që: Kur shqyrtohet Kur'ani dhe Sunneti kuptohet se nuk është shkrimi i vetëm Levhi Mahfudhi, porse gjenden edhe shkrime të ndryshme. Nëse do të japim shembull në lidhje me këtë:

Shkrimi që është shkruajtur për njerëzit që janë xhennetlinj ose xhehennemlinj, kur ishin në shpinën e Ademit (alejhis-selam): Në përgjithësi në hadithet e sakta që transmeton Imam Ahmedi dhe të tjerët se Allahu Teala e fërkoi shpinën e Ademit dhe nxorri pasardhësit e tij, dhe tha që *"Këta i krijova për Xhennet dhe bëjnë vepra për Xhennet"*. Pastaj e fërkoi edhe një herë dhe tha *"Këta i krijova për Xhehennem dhe bëjnë vepra për Xhehennem"*. Në disa transmetime kalon se këto janë shkruajtur.

Shkrimi që është shkruajtur për njeriun kur ishte në barkun e nënës: Në një hadith që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Mes'udi (radijAll-llahu anh) dhe ai nga Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) se ka thënë: *"Çdonjëri prej jush pret në barkun e nënës 40 ditë si nutfe (pikë uji) më pas po brenda kësaj kohe (mund t'i jepen dy kuptime të ndryshme si brenda 40 ditëve të njëjta ose brenda 40 ditëve të reja) bëhet gjak i ngjizur, pastaj përsëri brenda një kohe të tillë kthehet në copë mishi. Pastaj Allahu i dërgon atij një melek dhe i fryhet shpirti. Pastaj urdhërohet (meleku) që t'i shkruajë atij katër gjëra: Rriskun, exhelin, amelin (veprën) dhe se në ditën e kijametit do të jetë shaki (i dëshpëruar) apo said (i lumtur)"*.

Kaderi një vjeçar i njerëzve që i jepet melaikeve në çdo vit në natën e kadrit: *"Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar (në natën e begatshme të kadrit). Ne dëshiruam t'u tërheqim vërejtjen,*

e njerëzit të jenë të gatshëm. Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë. Urdhër i përcaktuar nga Vetë Ne". [8]

Shumë nga selefët ajetin e kanë komentuar në këtë mënyrë: *"Melaikeve të cilët janë të ngarkuar me detyrën e punëve të njerëzve, në natën e kadrit i jepet në formë shkrimi për çdo gjë që do të ndodhë në lidhje me ata (njerëzit) deri në vitin tjetër".*

Ndryshimet që bëhen, bëhen në shkrime që janë jashtë Levhi Mahfudhit, në fakt këto ndryshime që do të bëhen, janë të shkruajtura në Levhi Mahfudh. Kështu që të gjitha ndryshimet që bëhen nuk dalin jashtë bazës së Levhi Mahfudhit. Dhe ky ajet është argument i kësaj: *"Për secilin afat ekziston evidencë e caktuar. Allahu shlyen (nga ajo evidencë) çka të dojë, edhe forcon (çka të dojë). Vetëm tek Ai është baza e librit (Levhi Mahfudhi)".* [9] Edhe pse i bëhen edhe komente të tjera këtij ajeti, në temën tonë nga ky drejtim është argument: Allahu atë që dëshiron e ndryshon si të dojë. Gjëja e vetme që nuk ndryshon është libri bazë që është tek Allahu i cili i përfshin të gjitha ndryshimet: Levhi Mahfudhi.

Ndërsa disa dijetarë, kësaj i kanë dhënë përgjigje në forma të ndryshme. Thonë se dispozita e ajeteve qëndron siç është, ndërsa ajo që shpjegohet nëpër hadithe ka përmasë të ndryshme. Exheli dhe rrisku i njeriut, është ashtu siç është caktuar, as nuk zgjatet e as nuk zgjerohet. Zgjatja dhe zgjerimi që përmendet në hadithe, është në kuptimin e bereqetit. Pra, njeriu e kalon jetën e tij në mënyrë që kënaq Allahun dhe në ahiret përfiton tepër prej saj. Të mendojmë dy njerëz që jetojnë nga 60 vjet; ai të cilit Allahu i ka dhënë bereqet, përfiton sikur ka jetuar gjatë dhe ka fituar prej saj, ndërsa qafiri ose gjynahqari të cilit Allahu nuk i ka dhënë bereqet, është sikur s'ka bërë asgjë.

Dëshira e Allahut azze ue xhel-le:

Çdo gjë që ndodh në univers është e lidhur me dëshirën

8. *44/Duhan, 3-5*
9. *13/Rrad, 39-40*

e Allahut. Bëhet ajo që Ai dëshiron të bëhet, dhe ajo që Ai nuk dëshiron të bëhet, nuk bëhet. Asgjë, ama asgjë nuk bëhet jashtë dëshirës së Tij. Besimi se dëshira e Allahut është e përgjithshme në çdo gjë, është njëra nga pikat që e ndan Ehli Sunnetin nga grupet e tjera. Kur shqyrtohen ngjarjet që ndodhin në univers shihen se janë dy llojesh:

Ngjarjet e detyrueshme: Këto janë ngjarje që ndodhin duke mos qenë dora e njeriut, njeriu edhe sikur të dojë edhe sikur mos të dojë, këto ndodhin. P.sh; rrahja e zemrës, caktimi i exhelit etj. Në pikën se këto janë plotësisht të lidhura me dëshirën e Allahut, nuk ka asnjë njeri kundërshtim.

Ngjarjet jo të detyrueshme: Këto janë ngjarjet që njerëzit kanë të drejtë zgjedhjeje. Nëse do t'i shqyrtonim këto ngjarje;

- Ngjarjet që Allahu i ka urdhëruar, i do dhe është i kënaqur nga ato: P.sh; fitimi i rriskut në rrugë hallall, të qenurit i drejtë, një martesë të ndershme, iman etj...

- Ngjarjet që Allahu nuk i do, nuk është i kënaqur dhe që i ka ndaluar ato: P.sh; zgjedhja e kufrit, zinaja, jetesë imorale, fitim haram etj...

Sipas Ehli Sunnetit, që të dyja llojet janë të lidhura me dëshirën e Allahut. Pa dëshiruar Allahu siç nuk mund të besojë mu'mini, po ashtu edhe qafiri nuk mund ta zgjedhë kufrin. Kur'ani e ka theksuar shumë të përgjithshme dëshirën e Allahut. Shembulli më i qartë i kësaj, janë ajetet e udhëzimit dhe humbjes. Udhëzimi është gjëja që Allahu e do, është i kënaqur me të dhe e urdhëron, ndërsa humbja është gjëja që Allahu nuk e do, nuk është i kënaqur me të dhe e ndalon. Kur'ani, nga fillimi deri në fund, thekson se udhëzimi dhe humbja janë nga Allahu, nëse do Allahu të gjithë çfarë janë në rruzullin tokësor udhëzohen, mirëpo Ai disa i humb. Edhe këto dy lloje ngjarjesh që nuk janë të detyrueshme, tregojnë se nuk dalin jashtë dëshirës së Allahut. Po kështu, në Kur'an theksohet se veprat që ka urdhëruar Allahu të cilat janë nga lloji i bindjes,

siç janë me dëshirën e Tij, po ashtu edhe veprat që Ai ndalon dhe nuk është i kënaqur me ato, theksohet shumë qartë që janë po me dëshirën e Tij. Nëse do të japim shembull në lidhje me këtë:

"Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë, atyre nuk u takon zgjedhja". [10]

"Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë". [11]

"Largohu prej idhujtarëve. E sikur të donte Allahu, ata nuk do të ishin idhujtarë". [12]

"Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell". [13]

"E sikur të donte Allahu, nuk do të mbyteshin ndërmjet vete ata (populli) që ishin pas tyre, pasi që atyre u patën zbritur argumentet, por ata megjithatë u përçanë. E pati prej tyre që besuan dhe pati të tillë që nuk besuan, e sikur të dëshironte Alllahu ata nuk do të mbyteshin, por Alllahu punon çka dëshiron". [14]

"Ajo që ju goditi juve ditën e ballafaqimit të dy grupeve (besimtarë dhe idhujtarë), ishte me lejen e Allahut". [15]

Dijetarët duke u bazuar në këto nasse, iraden (dëshirën) e Allahut e kanë ndarë në dy pjesë.

▪ **Iradetu'l-Kevnijje (Dëshira Universale):** Kjo është dëshira e përgjithshme e Allahut. Të gjitha ngjarjet që ndodhin në univers, ato ngjarje që Ai i do dhe që nuk i do, janë të përfshira në këtë.

▪ **Iradetu'sh-Sher'ijje (Dëshira Sheriatike):** Ngjarjet të cilat Allahu i do dhe është i kënaqur me ato, janë të përfshira në

10. *28/Kasas, 68*
11. *10/Junus, 99*
12. *6/En'am, 106-107*
13. *6/En'am, 125*
14. *2/Bakara, 253*
15. *3/Ali Imran, 166*

këtë dëshirë. Allahu, nganjëherë do që një gjë të bëhet sheriatikisht. P.sh; siç dëshiron që të besojnë të gjithë. E urdhëron këtë, e do dhe kënaqet nga kjo. Mirëpo mundëson që disa njerëz të qëndrojnë në humbje. Me dëshirën e Tij Universale i nxjerr njeriut një pengesë që ai të mos besojë. Me patjetër që kjo e ka një hikmet (urtësi). Mund ta shpjegojmë këtë me disa pyetje-përgjigje:

Pyetje: Pse Allahu dëshiron që të ndodhin gjëra që Ai nuk i do dhe që nuk është i kënaqur me ato? A nuk është kjo në kundërshti me logjikën?

Përgjigje: Është e lidhur me njërën nga bazat e besimit Islam. Meseleja e kaderit nuk është e mundur që të kuptohet pa i shqyrtuar në tërësi të gjitha nasset që ka ai në brendinë e vet dhe me bazat e tjera të besimit.

▪ Ajo që është bazë tek ato që bën Allahu është t'i besosh ato dhe mos të pyesësh për to përse kështu e përse ashtu. *"Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë"*. [16]

"Allahu gjykon, e s'ka kush që mund t'i kundërvihet gjykimit të Tij". [17]

"Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit), pyeten". [18]

▪ Dija jonë është e ngushtë dhe e kufizuar. Ndërsa dija e Allahut është absolute dhe nuk ka asnjë kufi. Nuk është e mundur që mendja e njeriut të përfshijë dijen e Tij dhe të perceptojë ato që bën Ai sipas dijes së Tij. Me përjashtim të asaj që Ai njofton. Nasset në lidhje me këtë, kaluan në pjesën në lidhje me dijen e Allahut.

▪ Në çdo punë të Tij ka hikmet (urtësi) absolute. Në çdo gjë që dëshiron dhe krijon, patjetër që në të ka urtësi. Kur'ani në ngjarjet që nga ana e jashtme duken të këqija, por që kanë përfundim të mirë, ose që nga ana e jashtme duken të mira,

16. *28/Kasas, 68*
17. *13/Rrad, 41*
18. *21/Enbija, 23*

por që kanë përfundim të keq, tërheq vëmendjen gjithmonë tek cilësia e ilmit (dijes), e hikmetit (urtësisë) së Allahut.

Në Kur'an shumë herë kalon ajeti*: "Vërtet, Zoti yt është më i dijshmi, më i urti!"*. Ne nganjëherë e kuptojmë urtësinë e saj (punës), e nganjëherë nuk e kuptojmë. Në rastet që nuk e kuptojmë urtësinë themi që *"Patjetër e ka një urtësi"* dhe nuk i marrim në pyetje ato që bën Ai. Nëse do të japim shembull në lidhje me këtë: Personat që Allahu i do, (logjikisht) nuk duhet që ata të vuajnë e të torturohen, mirëpo sipas ndodhive, personat që i do Allahu janë njerëzit që vuajnë më së shumti dhe s'ka dyshim që kjo ndodh me dëshirën e Allahut. Shkaku i kësaj është nga urtësitë e përsosura që Allahu ka caktuar. Nëse do t'i rradhisnim disa:

- Allahu i ndan besimtarët nga munafikët.

- Allahu duke i derdhur gjynahet e besimtarëve, ua shton atyre gradat.

- Allahu duke ia shtuar kufrin qafirave ia vështirëson më shumë dënimin.

Për shkak të kësaj dhe urtësive të ngjashme, gjendjet që Allahu nuk i do dhe nuk kënaqet nga ato, mund t'u bien besimtarëve në kokë. Lufta e Uhudit është nga shembujt më të bukur të kësaj. Muslimanët përjetuan vështirësi të mëdha. Duke qenë Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në krye, sahabët vuajtën shumë. Kur'ani ka tërhequr vëmendjen se si fillim ky musibet (fatkeqësi) do të realizohej me lejen e Allahut. (Ali Imran 3/166). Ndërsa realiteti i ngjarjes është shpjeguar kështu:

"Ne, këto ditë i ndërrojmë (u japim në përdorim) mes njerëzve për t'i dalluar Allahu ata që besuan dhe për t'i zgjedhur disa prej jush për dëshmorë (ose dëshmues). Allahu nuk i do zullumqarët.

Dhe që Allahu t'i pastrojë besimtarët, ndërsa gradualisht t'i shkatërrojë mosbesimtarët". [19]

Në vazhdimin e ajetit 166 të sures Ali Imran, urtësia është shpjeguar në një mënyrë të qartë kështu: *"Për t'u dalluar besimtarët e sinqert. Dhe, për t'u ditur ata që ishin munafikë".*

Ky është vetëm një shembull. Të gjitha ngjarjeve që kanë të bëjnë me pyetjen tonë, në këtë mënyrë i jepet përgjigje. Dhe ndodhia e Hidrit me Musain (alejhis-selam) që kalon në suren Kehf, është nga shembujt e bukur të kësaj.

Pyetje: Thamë se udhëzimi dhe humbja është prej Allahut. Nëse një person bëhet qafir me dëshirën e Allahut, a nuk është padrejtësi që Allahu ta dënojë këtë në Ditën e Gjykimit? Allahu në shumë ajete në Kur'an thotë se *"Allahu nuk i bën padrejtësi njerëzve".* Këto dy mesele (besimin në kader dhe meselenë e drejtësisë) si t'i kuptojmë?

Përgjigje: - Allahu ka dije absolute. (detajisht kaloi tek pyetja e sipërme)

- Në çdo gjë që bën Allahu me patjetër që ka urtësi.

- Ne çdo gjë që e bën Allahu dhe që dëshiron, jemi të detyruar t'i besojmë dhe të nënshtrohemi. Edhe sikur ta dimë edhe sikur mos ta dimë urtësinë e gjërave që ndodhin sipas dëshirës së Allahut, i besojmë si domosdoshmëri e ajetit *"Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit), pyeten".*

- Allahu nuk i bën padrejtësi askujt. Kjo është nga bazat e Islamit. Për të thënë se kjo është padrejtësi e kjo është drejtësi për ato që bën Allahu, njeriu duhet të ketë dije absolute që të shohë fundin e ngjarjeve. Kur'ani na ka tërhequr vëmendjen e dobësisë sonë në këtë pikë duke thënë se *"ju mund ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju dhe mund ta doni një send, e ai është dëm për ju".* Nëse Allahu ka dëshiruar që një person të bëhet qafir, me patjetër që ka një urtësi në të. Ai nuk

19. *3/Ali Imran, 140-141*

e shkruan asnjë person si qafir përderisa ai nuk e meriton. Dhe madje kur njeriu i kupton urtësitë e mëdha në bërjen e një personi qafir, nuk e mban dot veten ndaj leximit të këtij ajeti *"Vërtet, Zoti yt është më i dijshmi, më i urti!"*. Që të kuptohet më mirë kjo temë, të japim një shembull nga Kur'ani:

"E sikur të kishin dëshiruar ata të dalin, do të bënin për të (për luftë) ndonjë përgatitje, por Allahu nuk e pëlqeu ngritjen e tyre, andaj i zbrapsi, dhe u është thënë: "Rrini me të paaftit (fëmijët, gratë e pleqtë)". [20]

Ai që e shqyrton këtë ajet, pyetjen e sipërme mund ta pyesë në këtë mënyrë: Allahu i zbrapsi ata nga xhihadi dhe i tha atyre që të rrinë e të mos dalin në luftë. Në ajetet në vijim i quajti këta munafikë dhe ka sqaruar në përgjithësinë e sures se munafikët kanë një dënim të dhembshëm.

Kur shqyrtohet pjesa e hyrjes së këtij ajeti, del në plan të parë cilësia e dijes së Allahut. Ai e ka ditur ndjenjën e tyre të brendshme, që ata nuk ishin besnikë, që nuk donin të dilnin në xhihad dhe që ata thoshin vetëm gënjeshtra me gojët e tyre. Dhe për shkak të qëllimeve të tyre të rrejshme, i zbrapsi ata. Ndërsa në ajetin në vijim thuhet kështu:

"Edhe sikur të dilnin me ju, ata nuk do t'ju shtonin tjetër pos ngatërresës dhe shumë shpejtë do ta përçanin mesin tuaj, duke kërkuar t'ju turbullojnë. E ndër ju ka të tillë që i dëgjojnë ata. Allahu i di shumë mirë hipokritët". [21]

Në pjesën e këtij ajeti, është tërhequr vëmendja edhe njëherë në dijen absolute të Allahut, sepse Allahu e dinte se ata do t'i përçanin muslimanët nëse do të dilnin me ta në xhihad dhe i mbrojti muslimanët nga sherret e tyre.

Kjo ngjarje që Allahu i shkruajti atyre humbjen, është vetëm një shembull. Të gjitha ngjarjet e ngjashme me këtë, përsëri duhen kuptuar në përfshirjen e cilësisë së dijes dhe urtësisë

20. *9/Teube, 46*
21. *9/Teube, 47*

së Allahut. Nëse Allahu nuk do të na njoftonte se dëshironte nifakun e këtyre njerëzve, ne nuk do ta dinim.

Po kështu është edhe gjendja e njerëzve të cilëve u janë vulosur zemrat, të cilët theksohen se nuk do të besojnë. Për shkak të veçorive që gjenden tek ata dhe që ne nuk i perceptojmë në të shumtën e rasteve, Allahu i ka shkruajtur atyre humbjen. *"Dhe për shkak të thyerjes së besës së dhënë, të mohimit të ajeteve (shpalljes) të Allahut, të mbytjes së pejgamberëve pa kurrfarë të drejtë dhe thënies së tyre: "Zemrat tona janë të mbuluara" (me perde). Jo, por për shkak të mohimit të tyre Allahu ua vulosi ato (zemrat), e nuk besojnë prej tyre vetëm pakkush"*. [22]

▪ Njeriu ka dëshirë e vullnet, mirëpo kjo dëshirë është e përfshirë në dëshirën e Allahut. Njeriu nuk mund të dëshirojë asgjë pa e dëshiruar Allahu. *"Ai (Kur'ani) s'është tjetër pos këshillë për njerëzit! Për atë nga mesi që dëshiron të gjendet në të vërtetën"*. [23] Ky ajet argumenton dëshirën e njerëzve.

Në ajet, duke u thënë se "*Po ju nuk mund të dëshironi, por vetëm nëse dëshiron Allahu, Zoti i botëve!"* [24] është sqaruar se dëshira e njeriut është e lidhur me dëshirën e Allahut. Nëse mirësia që dëshiron një njeri pengohet me dëshirën absolute të Allahut, pa dyshim që këtu ka një urtësi. (Siç e shpjeguam në pikën e mëparshme).

Bashkë me këtë, disa që e dëmtojnë imanin e tyre për t'ia mbushur mendjen disa njerëzve thonë kështu: *"Qafiri e zgjedh kufrin plotësisht me dëshirën dhe vullnetin e tij, dëshira e Allahut s'ka të bëjë fare"*. Kjo fjalë siç është në kundërshti me ato që rradhitëm më lart dhe me ajetet që përsëriten me qindra herë në Kur'an, po ashtu është në kundërshti edhe me përmasat e logjikës për atë që do të bindet. Atëherë dëshira e qafirit e ka mundur dëshirën e Allahut, sepse Allahu ka dashur që ai të bëhet besimtar, ndërsa ai plotësisht me dëshirën e tij ka zgjedhur kufrin.

22. *4/Nisa, 155*
23. *81/Tekvir, 27-28*
24. *81/Tekvir, 29*

▪ Drejtësia dhe padrejtësia nuk është ajo që përcaktojmë ne dhe termat që ne themi. Por çdo vepër që e bën Allahu është drejtësi dhe është larg nga padrejtësia.

Pyetje: Allahu është Ai që ia shkruan dhe dëshiron mirësinë dhe sherrin e njerëzve. Nëse një person thotë se *"Unë pranoj se Allahu e ka shkruajtur dhe e dëshiron sherrin, dhe unë i besoj kësaj se është drejtësi"* dhe vazhdon rrugën e tij duke ia bërë këllëf këtë sherrit në të cilin ai gjendet. Atëherë si është gjendja e këtij personi?

Përgjigje: Pyetjet e mëparshme, në përgjithësi janë pyetjet e komenteve të mu'tezileve që ne i quajmë Kaderijje.

▪ Ndërsa kjo pyetje është mendimi i medh'hebit Xhebrije, i cili është grupi i dytë i humbur në besimin e kaderit.

Si fillim, ky pretendim është një gënjeshtër historike. Duke qenë mushrikët në krye, këto fjalë i përdorin për këllëfat e gjynaheve. Në ajet për mushrikët kalon kështu: *"Sikur të donte Allahu nuk do t'i bënim shok (nuk do të ishim idhujtarë) as ne, as prindërit tanë... Ju i mbështeteni vetëm hamendjes, në të vërtetë, vetëm gënjeni"*. [25]

▪ Një njeri që i beson kësaj, kur t'i dhunohet malli i tij, jeta e tij, nderi i tij duhet që të tregojë po të njëjtën ndjenjë dhe të qëndrojë i qetë. Por kjo nuk është e mundur.

▪ Përsëri një njeri që i beson kësaj, s'duhet të hajë bukë, s'duhet të martohet për fëmijë, sepse sipas kësaj logjike, nëse Allahu dëshiron e ngop atë dhe e bën me fëmijë. Dhe kjo gjithashtu nuk është e mundur.

Allahu e ka urdhëruar robin që të bëjë përpjekje dhe ka dashur që njeriu të shtie në dorë gjërat e dobishme dhe të largohet nga gjërat e dëmshme. Në rast të mos realizimit në mënyrën që donte njeriu, Allahu ka dashur që ai të besojë se *"Kështu ka dashur Allahu"*.

25. 6/En'am, 148

Krijimi

Të gjitha veprat e njerëzve i ka krijuar Allahu. Asgjë nuk është jashtë krijimit të Tij. *"Allahu është krijues i çdo sendi dhe Ai është mbikqyrës ndaj çdo gjëje"*. [26]

"Ky është Allahu, Zoti juaj, nuk ka të adhuruar përveç Tij, Krijues i çdo sendi". [27]

"E Allahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni". [28]

Këto ajete tregojnë se Allahu ka krijuar çdo gjë duke përfshirë edhe veprat e njeriut. Ata të cilët bëjnë komente me mendje të mangëta për t'i bindur disa në çështjen e kaderit, kanë thënë se Allahu është Krijues i të mirës, ndërsa e keqja është nga njeriu ose njeriu është krijues i veprës së vet. Thonë që: *"Nëse themi që Krijuesi i veprave të këqija që bën njeriu është Allahu, pastaj nëse pranojmë se me këtë i dënon njerëzit në Ditën e Gjykimit, atëherë i kemi mveshur Allahut të keqen dhe e kemi cilësuar me padrejtësi"*. Kjo është hamendja e tyre. Përgjigja e kësaj kaloi në mësimin e mëparshëm.

Mveshja e së keqes Allahut

Edhe e mira, edhe e keqja është nga Allahu. Ndërsa krijuesi është Allahu. Mirëpo Rrasulullahu (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) në një hadith ka bërë dua kështu: *"E gjithë e mira të përket Ty, ndërsa e keqja nuk të përket Ty"*. Shkaku i kësaj është morali që duhet treguar ndaj Allahut. Si fillim, edhe e mira edhe e keqja janë nga Allahu. Mirëpo mveshja e të keqes Allahut, nuk është e përshtatshme, edhe për shkak të moralit edhe për shkak të disa shkaqeve që do të numërojmë:

▪ Asnjë vepër që bën Allahu nuk është e keqe absolute. Disa gjëra për disa njerëz edhe pse duken sikur janë të këqija, për të tjerët po të njëjtat gjëra duken të mira. Prandaj e keqja nuk i mvishet Allahut. Përshembull të mendojmë një shi të fort. Një njeri që e ka shtëpinë me qerpiç e humbet shtëpinë, mirëpo

26. *39/Zumer, 62*
27. *6/En'am, 102*
28. *37/Saffat, 96*

një vend që është tharë, me këtë shi gjallërohet. Nëse shihet me vëmendje, një vepër e Allahut për dy njerëz të ndryshëm mund të jetë edhe e mirë edhe e keqe.

▪ Allahu e krijon të mirën për njerëzit nga mirësia e Tij absolute. Nëse Allahu do t'i pyeste njerëzit përkundrejt mirësive të panumërta, nuk është e mundur që njerëzit të shohin hajër në dynja dhe në ahiret. Ndërsa e keqja i kap njerëzit për shkak të veprave të tyre. Prandaj e keqja nuk i mvishet Allahut, por njeriut. Kjo përkatësi është figurative. Në ajet, duke u thënë se: *"Ajo që ju goditi juve ditën e ballafaqimit të dy grupeve (besimtarë dhe idhujtarë), ishte me lejen e Allahut",* [29] musibeti është nga Allahu; ndërsa në një ajet tjetër duke u thënë se: *"Çfarëdo e mire që të vjen është nga Allahu, e çka të ndodhë nga ndonjë e keqe është nga vetë ti (nga gjynahet e tua)",* [30] tërhiqet vëmendja se shkaku i të keqes është njeriu.

Pra, Krijuesi i të mirës dhe i të keqes është Allahu. Mirëpo ngaqë Allahu është edhe Krijues i të mirës edhe shkaku absolut (sepse njerëzit nuk e meritojnë të mirën, por Allahu cakton nga mirësia e Tij), mirësia i atribuohet Allahut. Ndërsa Krijuesi i të keqes është Allahu dhe shkaktari i saj është njeriu (siç është në ajetin 79 të sures Nisa) dhe nga morali, e keqja i mvishet njeriut.

Besimi në Kader nuk është pengesë për të punuar

Ata që e kanë besimin më të fortë në kader janë pejgamberët dhe ndihmësit e tyre, të cilët punojnë më së shumti, të cilët përpiqen një jetë të tërë që t'i përmirësojnë edhe vetet e tyre edhe mjediset e tyre. Dhe kjo tregon se besimi në kader kurrsesi nuk përbën pengesa për të mos punuar. Madje, besimi në kader e shtyn më shumë njeriun që të punojë. Njeriu jeton nën rrethimin e tre kohërave: E kaluara, momenti në të cilin jeton dhe e ardhmja për të cilën nuk ka asnjë dije dhe garanci. Një person që beson në kader, për të kaluarën e tij thotë se

29. *3/Ali Imran, 166*
30. *4/Nisa, 79*

"Ishte caktimi i Allahut" dhe shpëton nga mërzitja e pikëllimi. Ndërsa për ato që do të ndodhin në të ardhmen, thotë se *"Këto janë të përfshira në dijen dhe dëshirën e Tij"* dhe shpëton nga paniku dhe shqetësimi. Dhe thotë që *"Ajo që më interson mua është momenti në të cilin ndodhem",* pastaj i mbështetet Allahut dhe punon për të vlerësuar momentin me të gjitha veçoritë që e bëjnë njeriun njeri. Nëse nuk del me sukses, nuk e kalon jetën e tij -siç kalon edhe në hadith- me *"ah, sikur"* (pra, duke thënë ah sikur të kisha vepruar kështu e ashtu, shënim i përkthyesit). Nëse del me sukses, e di që kjo nuk është nga vetvetja e tij, por nga Allahu dhe në këtë mënyrë nuk çoroditet, por vazhdon e punon.

Nëse do ta përkufizonim kaderin në një mënyrë më të ndryshme, nuk do të ishte gabim nëse do të thoshim kështu: Njeriu le të kapet pas të gjitha shkaqeve dhahirije që ka krijuar Allahu, të çojë në vend barrën që i është ngarkuar dhe të kërkojë hajrin, ndërsa rezultatet që do të lindin, t'ia lerë Allahut.

Ndalesa e futjes në çështjet e kaderit

Në hadith kalon kështu: Pejgamberi (sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem) shkon pranë sahabëve në një moment që ata po flisnin rreth çështjeve të kaderit dhe kur i sheh ata se po debatonin rreth kësaj çështje nxehet aq shumë, saqë nxehja e tij dukej në fytyrë. Pastaj thotë: *"Çfarë keni ju që e përplasni një pjesë të Librit të Allahut me një pjesë tjetër. Edhe ata para jush kështu u shkatërruan"*.[31] Ky hadith është një argument i qartë i titullit tonë. Shkaku i kësaj, siç e përmendëm edhe më parë se pa i shqyrtuar edhe nasset brenda kaderit edhe nasset në lidhje me bazat e tjera të besimit Islam, veçanërisht e folura pa u menduar në emrat dhe cilësitë e Allahut, përzierja e njerëzve në këtë temë është e pashmangshme që të mos bien në kundërshti. Tema dhe përfundimi i përgjithshëm i debateve të kaderit, është marrja në pyetje veprat dhe dëshirën e Allahut mbi të cilat është bazuar dënimi dhe shpërblimi. Dhe

31. *Ahmedi, Ibn Maxhe*

në mësimin e kaluar e përmendëm se me ndjenjat e kufizuara ekzistuese, nuk është e mundur që të sqarohet nga njeriu.

Dhe lutja e fundit, falënderimi i takon Allahut, Zotit të botërave.

Ebu Hanzala

Tetor 2008/Shevval 1429

Burgu nr: 2, tip: F

Kandëra/Koxhaeli

MËSIME AKAIDI

Sot gjenden shumë libra në lidhje me temat e akides (Allahu ia pranoftë veprën vepërmirësve). Megjithatë, gjenden shumë shkaqe që ne po e botojmë këtë libër që keni në duar. Një pjesë prej këtyre shkaqeve mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë:

- *Sepse një pjesë e librave që gjenden në treg, nuk janë përmbledhës (në vend që të përfshijnë shumë tema, qëndrojnë vetëm mbi disa tema të caktuara),*
- *Sepse një pjesë e tyre, përmbajnë njohuri devijuese kundër teuhidit,*
- *Sepse temat e disave prej tyre shpjegohen në imtësi, nuk janë aq të qarta sa të kuptohen nga të gjithë,*
- *Për shkak se një pjesë e dijetarëve të teuhidit që kanë shkruar në lidhje me këtë temë, nuk jetojnë në gjeografinë tonë dhe ngaqë nuk i dinë disa probleme të itikadit në lidhje me kushtet tona, japin fetva të gabuara,*
- *Në vitet e fundit, sidomos në gjeografinë tonë, gjendja që duket me përhapjen e xhemateve të teuhidit ndërmjet njerëzve është kështu: "Problemi i vetëm i neve muvahhidëve (njësuesëve) që jetojmë me bashkësinë xhahile, është meseleja e demokracisë/ligjvënies". Ndërkohë që ne –pranë rëndësisë që i japim kësaj meseleje- edhe shumë meseleve të tjera nga bashkësia xhahile, nga zakonet, adetet e tyre pikëpamja jonë është sipas kornizës së itikadit Islam, edhe ky është një tjetër shkak.*

Për këto dhe arsye të ngjashme, ka lindur nevoja për të shkruar librin në dorë.

ISBN 978-605-68965-5-2